

# BIG Të Përçarë DEAL

Mbikëqyrja civile e zbatimit të marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë

“Ndonjëherë e pyes veten nëse po ia vlen ky dialog me Serbinë, meqë po na kushton me kaq shumë ndasi përbrenda shoqërisë së Kosovës. Ky dialog është arsyeja pse në Kosovë është komplet i bllokuar normaliteti parlamentar. Si mund të jemi të gatshëm të dialogojmë me Serbinë nëse nuk jemi në gjendje që së pari të dialogojmë lokalisht, qeveri e opozitë?”

— **BESA LUZHA, FRIEDRICH EBERT STIFTUNG**

“Ndonjëherë frikësohem mos po gaboj e po bëj lapsuse kur flas për zyrtarët komunalë. Nuk di cilës komunë i përkasin, të Kosovës a të Serbisë.”

— **QYTETAR NGA LEPOSAVIQI**

“U mundova t’ia shpjegoj se ekziston marrëveshja mes dy palëve që qytetarët e Kosovës të hyjnë në Serbi me letërnjoftim, por kot. Ma kërkoi letërnjoftimin, dhe kur e pa se është letërnjoftim i Kosovës, tha “Më vjen keq por nuk mund të kalosh me këtë.”

— **SHPEND KURSANI, QYTETAR I KOSOVËS, DUKE STUDIUAR NË FIRENCË TË ITALISË.**

# BIG Të Përçarë DEAL

Katër vjet e gjysmë që nga fillimi i dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, dy palët mbesin shumë të ndara në qëndrime, ndërsa përçarja brenda Kosovës rreth dialogut vetëm sa po zgjerohet.

“[Duhet të] kem vetëm një numër telefoni e të mos kem nevojë të mbaj tri kartela të ndryshme (mobil të Kosovës, mobil të Serbisë, dhe fiksin)... [kështu me] tre telefona të ndryshëm, dy-tri palë targa regjistrimi, gjithçka është më komplikuar se që ka qenë më përpara. Nuk shoh ndonjë ndryshim pozitiv, por me bindje e them se sikur t’i kishin pyetur qytetarët, krejt këto do të ishin zgjidhur shumë më moti.”

— V.N., MITROVICË E JUGUT

Procesi i negociemeve vazhdon, por jeta nuk mund të rrijë në pritje të marrëveshjeve politike. Ligjet nuk hartohen që të ketë shtim të marrëveshjeve politike, por që të ketë implementim. Qytetarët kanë të drejtë gjykimi brenda një kohe të arsyeshme, secili ka interesat e veta ligjore dhe ajo që duan njerëzit është që kjo e drejtë t’u mbrohet nga gjyqet.”

—PUNONJËS I NJË GJYKATE SHTETËRORE TË SERBISË NË VERI TË KOSOVËS.

## Parafjalë

Për gati dy vjet, ne këtu në BIG DEAL kemi monitoruar nivelin e implementimit të marrëveshjeve të arritura mes Prishtinës dhe Beogradit në katër vjet e gjysmë të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Në raportin e parë, “Monotoni e Qytetëruar?” që publikuam në nëntor të vitit 2014, patëm hulumtuar perspektivat e integritit të vërtetë të veriut të Kosovës në strukturat e shtetit që ka kryeqytet Prishtinën, e jo Beogradin. Titulli në fjalë aludon tek një tregim i shkurtër të cilin e kishte shkruar humoristi britanik Saki, të cilin tregim e kishte bazuar në përvojat e tij gjatë shërbimit ushtarak në Luftërat Ballkanike të fillim-viteve 1900. Autori ishte i bindur se epoka e luftës,

e diplomatëve ngatërrimtarë, dhe e pasigurisë ishte pjesë e të shkuarës së rajonit, i cili herë do kur do të rehatohet në “monotoni të qytetëruar”, njëjtë sikurse që kishte ndodhur me shumicën e Europës perëndimore.

Pas më shumë se 100 vjetësh, fjalët e tij nuk dotën profetike. Por, marrëveshjet mes Kosovës dhe Serbisë kanë të bëjnë me procesin e prurjes së kësaj monotonie të qytetëruar në tërë Kosovën, dhe në Serbi, me një sistem të

vetëm funksional të shërbimeve publike, gjë që nuk ka ndodhur akoma.

Në raportin tonë të dytë, të cilin e publikuam në prill 2015 me titull “Të Humbur në Stagnim” paraqitëm detajisht mungesën e progresit. Brenda gjashtë muajve mes raportit të parë dhe të dytë, pati fare pak ndryshime në nivelin e implementimit të marrëveshjeve, për shkak të zgjedhjeve që zgjatën disa muaj në Kosovë, në Serbi, si dhe në Bashkimin Evropian.

Mirëpo, kësaj radhe, titulli është pakëz më fatzi. “Të Përçarë” i referohet plasaritjeve që dialogu ka shkaktuar brenda marrëdhënieve: ndarjes së brendshme të shoqërisë së Kosovës. Për disa muaj me radhe Kuvendi i Kosovës ka qenë i bllokuar për shkak të protestave të opozitës kundër marrëveshjes së 25 gushtit 2015 lidhur me elementet kryesore të Asociacionit të komunave me shumicë serbe si dhe marrëveshjes mbi demarkacionin e ri me Malin e Zi. Niveli i debatit të mirëfilltë brenda shoqërisë lidhur me Asociacionin është i kufizuar në thjeshtë “për a kundër”, ndërkohë që në parlament marrëveshja është prezantuar pa ndonjë dispozitë për debat të hapur.

Edhe marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës përjetuan dëmtim serioz pas dështimit të fushatës së Kosovës për anëtarësim në UNESCO, me ç’rast u lëshuan fjalë të këqija në të gjitha anët. Në muajin pasues, vendimi i Presidentes së Kosovës që t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese masa të përkohshme për të suspenduar përkohësisht implementimin e marrëveshjeve lidhur me Asociacionin, hasën në frustrim në anën e Beogradit.

Marrëveshjet e arritura gjatë këtyre katër vjet e gjysmë, mbajnë në supë premtimin për ta bërë rajonin t’i përngjajë më shumë një monotonie të qytetëruar si ajo e tregimit të shkurtër nga Saki. Me të vërtetë ka pasur progres të jashtëzakonshëm deri tash, qoftë nëse kanë mbetur shumë çështje të dukshme. Megjithatë, asnjë pjesë e progresit nuk është akoma e pakthyeshme.

“Pse s’flasim për mbrojtjen e të drejtave njerëzore? Nëse gjithmonë flasim për komunitetet shumicë e pakicë, atëherë shqiptarët e serbët gjithmonë do të kenë probleme.”

**-MILORAD RADIVOJEVIC, ZVEÇAN**

## PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| Mirënjohje  | 7  |
| Përmbledhje Ekzekutive                            | 8  |
| Rekomandimet                                      | 11 |
| Hyrje   | 15 |
| Marrëveshjet                                      | 20 |
| Liria e Lëvizjes për Njerëz dhe Mallra            | 26 |
| Sigurimi i Automjeteve                            | 28 |
| Targa dhe Kërcënimi me Masa Reciproke             | 29 |
| Udhëtimi Tranzit dhe ai Ajror                     | 30 |
| Udhëtimi Hekurudhor                               | 31 |
| Ura e Mitrovicës                                  | 31 |
| Suhadolli dhe Kroji i Vitakut                     | 32 |
| Dogana dhe Tregtia e lirë                         | 33 |
| Ndryshimet që Ndikojnë tek Serbët e Kosovës       | 34 |
| Strukturat Paralele                               | 35 |
| Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe | 37 |
| Siguria   | 45 |
| Policia   | 46 |
| Trupa e Mbrojtjes Civile                          | 46 |
| Gjyqësori   | 48 |
| Shkresat: Diplomat, Kadastrë, Regjistri Civil     | 51 |
| Diplomat  | 51 |
| Universiteti i Prishtinës i Rilokuar në Mitrovicë | 53 |
| Kadastrë  | 53 |
| Regjistrat Civilë                                 | 55 |
| Kosova dhe Bota                                   | 55 |
| Oficerët për Ndërlidhje                           | 59 |
| Telekomi  | 59 |
| Energjia  | 61 |
| Përfundim   | 62 |

## Mirënjohje

Në vitin 2014, BIRN Kosova dhe Internews Kosova filluan iniciativën BIG DEAL: Mbikëqyrja Qytetare e implementimit të Marrëveshjeve Kosovë-Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian që nga viti 2011.

Për këtë raport hulumtuan Valerie Hopkins, Paulina Nushi, Una Hajdari, Jeta Xharra, Faik Ispahiu dhe Lura Limani nga BIRN Kosova dhe Internews Kosova dhe gazetaret Sanja Sovrllic dhe Jelena Markovic nga Qendra për Avokim për Kulturë Demokratike (Advocacy Center for Democratic Culture ACDC) në Mitrovicë.

Raporti u shkrua nga Valerie Hopkins.

Ky raport paraqet të tretin “raport progresi” me radhë, i cili përqendrohet në implementimin e marrëveshjeve Kosovë-Serbi. Hulumtimi mbështetet në intervista me mbi 100 burime. Të intervistuarit përfshijnë persona që nga radhët vendimmarrëse qeveritare e deri te qytetarët e thjeshtë të cilët përballen me ndryshimet në jetët e tyre. Burimet e intervistuar përfshijnë zyrtarë nga qeveritë si të Kosovës ashtu edhe të Serbisë, përfaqësues të Bashkimit Evropian, si dhe burime tjera primare e sekondare.

BIRN Kosova dhe Internews Kosova bashkëpunojnë për të krijuar debate televizive dhe programe hulumtuese në Kosovë. Në shtator të vitit 2012, Internews Kosova dhe BIRN Kosova lansuan platformën e re televizive, “Tema”. Episodi i parë uli së bashku në tavolinë akterë nga të dy shtetet rreth një debati të paprecedent ku u diskutuan shqetësimet e qytetarëve lidhur me standardet e jetesës dhe progresin, rëndësinë dhe interpretimin e një numri të marrëveshjeve të arritura deri atëherë. Dhjetë debate mbi tema prej lirisë së lëvizjes e deri te bashkëpunimi kulturor janë transmetuar në kanalet kryesore televizive në Kosovë dhe në Serbi.

Ky raport u bë i mundur përmes mbështetjes nga British Foreign and Commonwealth Office dhe Rockefeller Brothers Fund.

Në këtë moment kohor, duhet përmendur se BIG DEAL nuk e miraton akëcilën marrëveshje të arritur mes Serbisë dhe Kosovës. Megjithatë, ne besojmë se procesi duhet të monitorohet dhe raportohet në baza të rregullta, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në procesin e dialogut nga institucionet e Kosovës dhe të Serbisë, si dhe Bashkimi Evropian si facilitator dhe garantues i implementimit.

## Përmbledhje Ekzekutive

Nën sponsorim të Bashkimit Evropian, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë filloi para më shumë se katër vjet e gjysmë, dhe ai vazhdoi përgjatë tri qeverish në Serbi e dy sosh në Kosovë. Janë zhvilluar rreth 40 raunde dialogu të nivelit të lartë, pa përmendur fare raunde të panumërta negociimesh teknike. Shumëç-ka prej krejt kësaj është duke shkuar drejt përmbushjes, por ky progres s'është se ka ndonjë pjesë të pakthyeshme. Me kalimin e kohës, implementimi i shtohet rëndësia, ndërsa e largët duket ardhja e ndryshimeve të vërteta. Këtë vit, në muajt shkurt, mars dhe gusht, është dakorduar për hapa konkretë të cilët mund të përgatisin terrenin për implementimin e pjesëve të marrëveshjes së 19 prillit 2013, e cila kishte qenë e mangët dhe e pa definuar. Tash më nuk mund të ketë arsye të mos-implementim, dhe periudha që po afrohet do të jetë testi i vërtetë se a do të bëhet a do të dështojë dialogu.

Njëra nga marrëveshjet kryesore – konkretisht thelbi i marrëveshjes së 19 prillit 2013 – Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe, mbetet në vonesë.

Ndonjëherë duket sikur të dyja palët nuk kanë zotim të plotë ndaj procesit dhe më shumë e përdorin atë për të përfituar poena politike si në arenën politike evropiane ashtu edhe lokale. Ata janë zotuar të kryejnë atë që është e domosdoshme, por dikur në të ardhmen, ndoshta vitin tjetër, apo vitin pas tij, apo kurdo që është e favorshme. Në ndërkohë, qytetarëve gjithandej Kosovës po u rritet mosdurimi, dhe në disa raste, edhe niveli i shqetësimit.

“Kurrfarë e mire nuk ka ardhur nga marrëveshjet e Brukselit apo nga ato që ka miratuar pala serbe”, thotë Milorad Radivojeviq nga Zveçani. “Nuk shoh se i kanë sjellë diçka konkrete serbëve, qoftë në veri apo jug të Ibrit”.

Në anën tjetër, Hana Marku nga Prishtina, është e shqetësuar se ndoshta marrëveshjet po i japin Beogradit shumë pushtet brenda Kosovës.

“Nuk jam kundër një asociacioni komunash serbe, por jam kundër asaj që një entitet brenda shtetit të financohet dhe drejtohet nga Beogradi. Kjo aspak nuk i duhet Kosovës”.

Nuk mund të mohohet se ka pasur ca progres të mirë: Kosova më në fund ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim- Asocim (MSA) dhe Serbia tani pret të fillojë tre nenet/kapitujt e parë të negociimeve për pranim me BE deri në fund të vitit 2015. Progresi drejt pranimit të dy shteteve do të varet, natyrisht, nga çuarja përpara e implementimit të marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Megjithatë, nga mesi i kapitujve të parë, Serbia do të hapë kapitullin 35, i cili trajton marrëdhëniet fqinjësore me Kosovën. Nëse gjykojmë sipas reagimit të ashpër të bërë nga ana e kabinetit të kryeministrit të Serbisë ndaj pikë-referimit fillestar të raportit shqyrtues për Kapitullin 35 të dërguar Brukselit, procesi duket se do të shkojë gjatë dhe zvarrë.<sup>1</sup>

Megjithatë, dialogu tashmë ka krijuar aq ndarje të madhe përbrenda

<sup>1</sup> Shih këtu kundërshtimet e kryeministrit serb Vuçiq lidhur me konstatimet e raportit shqyrtues: <http://europeanwesternbalkans.com/2015/10/15/ten-contentious-points-of-eus-draft-resolution/>



Kosovës sa që shumë njerëz janë të shqetësuar se mos ai nuk ia vlen fare, duke u brengosur se mos po krijohen ndarje brenda Kosovës si ‘dëme anësore’ të dialogut.

“Ndonjëherë po e pyes veten nëse ia vlen fare ky dialog me Serbinë, kur po na kushton me kaq shumë ndasi përbrenda shoqërisë së Kosovës”, thotë Besa Luzha nga Friedrich Ebert Stiftung. “Ky dialog është arsyeja pse në Kosovë është komplet i bllokuar normaliteti parlamentar. Si mund të jemi të gatshëm të dialogojmë me Serbinë nëse nuk jemi në gjendje që së pari të dialogojmë lokalisht, qeveri e opozitë?”

Deri më tash, vetëm katër nga 17 marrëveshje janë implementuar plotësisht, ndërsa dy tjera janë afërsisht gati.

Komponenta kryesore e marrëveshjes së 19 prillit 2013 – si dhe, më e mirëpritura nga serbët e Kosovës – është ajo e statutit të Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe (AKS). Progresi u duk se do të jetë i pashmangshëm pasi që një marrëveshje e datës 25 gusht 2015 rreth elementeve kryesore të këtij organi deklaroi që statuti do të bëhet gati para fundit të vitit. Vendimi rishtazi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për të pezulluar implementimin deri në mesin e janarit, derisa të shqyrtohet kushtetutshmëria e parimeve të dakorduara në Bruksel, e ka pauzuar si progresin e Asociacionit, si atë të marrëveshjeve tjera.<sup>2</sup>

Nuk ka ndonjë ndryshim që nga raportimi i fundit para gjashtë muajsh lidhur me katër marrëveshjet që janë vlerësuar si të implementuara plotësisht: kthimi i regjistrave civilë, përdorimi i vulës doganore, zgjedhjet e nëntorit 2013 në katër komunitat veriore, që u mbajtën për herë të parë nën sistemin e Kosovës për udhëheqës komunalë dhe nën qeverinë e shtetit të Kosovës, si dhe miratimi i planit të implementimit.

Dy marrëveshje janë në stad final implementimi: integrimi në Policinë e Kosovës i ish-punonjësve të MPB-së së Serbisë nga veriu i Kosovës, dhe integrimi i anëtarëve të Mbrojtjes Civile në institucione përkatëse të Kosovës. Marrëveshja mbi Lirinë e Lëvizjes pak a shumë është implementuar, por lëvizja nuk është aq e lirë apo e lehtë sa do të mund të ishte, dhe shfrytëzimi ilegal i pikë-kalimeve kufitare në veri të Kosovës është akoma gjë e zakonshme.<sup>3</sup> Ndërkohë që transferimi i librave kadastralë nga Serbia në Kosovë është në rrugë të mbarë, ligji përkatës mbetet në ngecje në Kuvendin e Kosovës tashmë dy vjet, dhe ekspertët e drejtave të njeriut kanë ngritur disa shqetësime lidhur me dispozitat e tij.

Ndërkohë vazhdojnë përpjekjet për përfaqësim e bashkëpunim rajonal, dhe Kosova është bashkuar si anëtar i përhershëm në RACVIAC (Qendra për Siguri dhe Bashkëpunim), dhe në iniciativën MARRI (Iniciative Regjionale për Migrimin, Azilin, Refugjatët). Megjithatë, siç edhe ka përmendur BE në raportin e progresit për të dy vendet, Serbia “duhet të qëndrojë e përkushtuar për vazhdimin e

<sup>2</sup> Vendimi i 10 Nëntorit ndodhet këtu: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_ang.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_ang.pdf)

<sup>3</sup> Kjo përmendet në progres-raportin 2015 të BE për Kosovën dhe Serbinë.

implementimit të marrëveshjes mbi përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në forume rajonale”. Edhe Kosova shpenzoi resurse të shumta të përfshirjes regjionale në konkurrimin e saj në UNESCO.

Plane të reja të dakorduara në muajin gusht shtruan terrenin për implementimin e marrëveshjeve të telekomit dhe energjisë, por në të dy anët veçse janë shfaqur lemza.

Sipas një plani të dakorduar në Bruksel në muajin shkurt, u duk që integrimi i gjyqësorit do të kompletohej deri në fund të vitit, por kjo gjë ka ngecur qe disa muaj për shkak të mosmarrëveshjes rreth lokacioneve fizike të gjykatave dhe stafit mbështetës.

Marrëveshja mbi njohjen e diplomave ka ngecur plotësisht që nga vera e vitit 2014, gjë që paraqet problem që vërehet shpejt dhe të cilin të dy palët do të duhej ta rregullonin menjëherë. Përkundër dy marrëveshjeve në vitin 2011, në Bruksel diskutimet vazhdojnë.

Transparenca është përmirësuar paksa, posaçërisht me Shërbimin e Bashkimit European për Veprim të Jashtëm (European Union External Action Service), të cilët edhe publikuan rezultatet e negociemeve të gushtit 2015. Zyra e Kryeministrit ka publikuar të gjitha marrëveshjet në uebfaqen e vet, përveç marrëveshjes së muajit shkurt mbi drejtësinë, e cila marrëveshje nuk ndodhet as në uebfaqen e Ministrisë së Drejtësisë.<sup>4</sup> Kësaj vere, edhe Zyra e Serbisë për Kosovë ka publikuar tekstin e marrëveshjeve.<sup>5</sup> Për dallim prej uebfaqeve qeveritare të Kosovës, Serbia ka publikuar vetëm tekstet e marrëveshjeve, dhe jo marrëveshjet konkrete të skanuara, me nënshkrime dhe datë.

Koha që kalon mes arritjes së marrëveshjeve dhe implementimit të tyre nënkupton se marrëveshjet janë të prira të vonohen për shkak të faktorëve të jashtëm politikë. Gjatë fushatës së dështuar të Kosovës për anëtarësim në UNESCO, në nëntor, retorika e nxehtë që doli nga Prishtina dhe Beogradi dëmtoi thellësisht atë shtytje të sado paktë që ishte formuar për katër vjet e gjysmë. Ky dështim paraqet goditjen e parë të vërtetë sa i përket njohjeve ndërkombe-tare të Kosovës që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, dhe kjo gjë tregon se, ndërkohë që palët mund të jenë në gjendje të pajtohen në disa gjëra, dialogu e besimi real është shumë shumë larg.

Më 8 tetor, anëtarët e bllokut opozitar lëshuan gaz lotsjellës në Kuvendin e Kosovës, duke protestuar me këtë kundër Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe dhe kundër marrëveshjes së kohëve të fundit për demarkacion kufitar me Malin e Zi. Që nga ajo datë, Kuvendi ka qenë skenë bombash gazi lotsjellës, sprejt, sharjeve, dhe parullave protestuese. Bllokada politike një-muajshe ka frustruar serbët. Kjo tregon se situata qëndron dobët dhe se dialogu po humb popullaritetin.

E gjithë kjo ndodh në vazhde të shpërnguljes masive nga Kosova. Mes mua-

4 Të gjitha marrëveshjet mund t'i gjeni tek faqja e zyrës së kryeministrit të Kosovës: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,253>

5 Marrëveshjet mund t'i gjeni në faqen e Zyrës së Serbisë për Kosovë e Metohi: <http://www.kim.gov.rs/eng/pregovaracki-proces.php>

jit nëntor 2014 dhe mars 2015, rreth 70,000 kosovarë, të ngopur me situatën në shtëpi, përmes mjeteve ilegale dolën në Evropën perëndimore dhe kërkuan azil.<sup>6</sup>

Derisa shumica gradualisht po kthehen në Kosovë, shumë prej tyre mbesin në qendra të azilit, duke mos ditur se çka i pret kur të kthehen në shtëpi. Shumica e këtyre familjeve u kanë dhënë para të majme trafikuesve për të kaluar përmes Serbisë në Evropën perëndimore. Në atë kohë, kishte shumë pak bashkëpunim mes forcave policore të Serbisë dhe të Kosovës. Ky eksod paraqiti një nga arsyet e shumta pse Kosova meriton të jetë anëtare e Interpolit, në mënyrë që të mund të çante rrjetet trafikuese dhe veprimtaritë e kundërligjshme. Megjithatë, pas dështimit të konkurrimit në UNESCO, do të jetë vështirë të arrihet anëtarësimi në këtë autoritet, i cili është jashtëzakonisht me rëndësi jo vetëm për sigurinë e Kosovës por për stabilitetin e rajonit.

Në këtë moment, të gjitha palët e kanë vlerësuar periudhën që po vjen si periudhë për implementim, përfshirë edhe lehtësuesit e BE-së.<sup>7</sup> Në tryezë nuk ka më marrëveshje të reja të parashtruara, ndonëse nga të dyja palët kanë pluskuar tema të ndryshme. (Mes tjerash, Kosova dëshiron të diskutojë personat e zhdukur, Serbia dëshiron të diskutojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare). Normalizimi do të varet nga implementimi i këtyre marrëveshjeve, gjë e cila me gjasë do ta konsumojë edhe vitin që po vjen.

## Rekomandimet

### **Për qeveritë e Kosovës, Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht BE-së:**

Të gjindet zgjidhje urgjente për problemin e njohjes reciproke të diplomave, gjë që do të mundësojë të gjithë qytetarët të kenë qasje të barabartë në punësim. Institucionet e Kosovës duhet të trajtojnë çështjen e arsimimit cilësor për serbët, dhe Beogradi duhet të mbledhë vullnetin politik që t'i lejojë serbët e Kosovës të integrohen plotësisht në sistemin arsimor të Kosovës.

- Marrëveshja e kohëve të fundit mbi elementet kryesore të Asociacionit/Bashkësisë e përshkruan këtë organ si organ që promovon "interesat e komunitetit serb të Kosovës në marrëdhëniet e veta me autoritetet qendrore" duke siguruar që ky organ ka rol të ligjshëm që të kujdeset për komunitetet tjera që jetojnë në ato komuna.
- Të mos lejohen negociime mbi statutin e Asociacionit/Bashkësisë për të vonuar integrimin e serbëve të Kosovës nëpër të gjitha nivelet e qeverisë. Të publikohen oraret me afatet përfundimtare
- Keqinformimi dhe paqartësia e asaj që vendoset krijon apo zgjeron

6 9 Shtator 2015, "Azil-kërkuesit nga Ballkani përballen me momente akoma më të ashpra, meqë Gjermani shtërngon gjërat." Reuters. <http://uk.reuters.com/article/2015/09/09/uk-europe-migrants-balkans-idUKKCNOR91ZR20150909>

7 Intervistë me anëtarë të ekipit të Mogherinit në EUHRVP në tetor 2015.

boshllëqet mes komuniteteve dhe rrit mosbesimin mes njerëzve dhe institucioneve në të dyja anët. Është për t'u lëvdur fakti se BE ka qenë shumë aktive në shpaltosjen e informatave lidhur me marrëveshjet e aritura në muajin gusht, por i tërë informacioni do të duhej të ishte publik tek ndonjë seksion i veçantë i EEAS për dialogun.

- Të mbështeten dhe ndihmohen përpjekjet e shoqërisë civile dhe organizatave të rinjëve që promovojnë shkëmbime kulturore mes Kosovës dhe Serbisë.
- Mekanizmat që merren me kërkimin e të vërtetës dhe nxjerrjen në pah të të vërtetës rreth të kaluarës së dhunshme, duhet të jenë pjesë e dialogut. Duhet të sigurohet zotimi i të dy palëve lidhur me shpaltosjen e arkivave të tyre dhe mbështetjen e mandatit të REKOM. Të emërohet një grup neutral ekspertësh nga Kosova për të rishikuar tekstet shkollore të Kosovës në lëndën e historisë, dhe njëjtë në Serbi.

### **Për qeveritë e Kosovës dhe Serbisë:**

- Qeveritë e Kosovës dhe Serbisë duhet rregullisht të rritksojnë zotimin e tyre për procesin e dialogut në Bruksel. Liderët duhet të theksojnë hapazi se implementimi i marrëveshjeve është i mirë për të gjithë qytetarët, dhe jo t'i portretizojnë ato vetëm e vetëm si detyrim i domosdoshëm i imponuar nga BE.
- Të mbahen konferenca të përbashkëta shtypi kurdo që është e mundur me qëllim që të shmangen mesazhet kundërtënjëse pas arritjes së marrëveshjeve.
- Të përmirësohet komunikimi në nivelet më të larta në mënyrë që të diskutohen çështjet reciproke lidhur me procesin e dialogut. Të dy kryeministrat kanë njoftuar në fillim të vitit për linja të komunikimit telefonik direkt, por është e qartë se ajo nuk përdoret.
- Të mos përdoret gjuhë fyese dhe e ashpër, e cila e tendos procesin dhe nxit qytetarët.
- Ekipet negociatore duhet të caktojnë takime të rregullta (mujore) me media dhe shoqërinë civile për t'u komunikuar mbi progresin e implementimit të marrëveshjeve
- Agjencitë përkatëse të të dy qeverive duhet të zbatojnë auditim të plotë të punësimit në institucionet e udhëhequra nga Serbia nëpër të gjitha vendet e Kosovës. Kjo gjë duhet të ndodhë ndërkohë që po ndodh procesi i themelimit të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe.
- Serbia duhet t'i inkurajojë serbët e Kosovës që të kërkojnë punësim në institucionet e Kosovës, posaçërisht jashtë ministrive ku ata zakonisht punojnë (Ministri për Komunitete dhe Kthim, Ministri të Vetë-Qeverisjes Lokale) dhe që të marrin pjesë në tërë spektrin e agjencive.

### **Për Kosovën:**

- Opozita e Kosovës duhet ta përdorë parlamentin për të hyrë në diskutime të kuptimta lidhur me obligimet për të cilat Kosova është dakord-

ar në Bruksel, dhe jo për ta destabilizuar parlamentin deri në shkallë të atillë që pengon debatin e mirëfilltë.

- Qeveria duhet të shpjegojë pikat e marrëveshjes para qytetarëve të vet, në mënyrë që t'i zbusë frikat lidhur me Asociacionin/Bashkësinë.
- Qeveria duhet të bëjë ridrejtim politik dhe të fillojë e të shtrijë përfshirjen tek qytetarët e saj serbë. Shtrirja tek dhe përfshirja e serbëve të Kosovës duhet të jetë prioritet kryesor, në vend se me serbët vendorë të negocohet përmes Beogradit apo BE/SHBA.
- Për shkak se serbët në veri të Kosovës kanë bojkotuar regjistrimin e fundit të popullsisë, nuk ka informacion të saktë për atë se sa serbë jetojnë në Kosovë. Qeveria duhet të ndërmarrë përpjekjet e nevojshme për të përcaktuar se sa serbë jetojnë në Kosovë dhe ku, si dhe të përdorin këtë informacion si bazë për buxhetimet, projektet dhe aktivitetet e ardhme.
- Ka ligje substanciale që ekzistojnë me qëllim që të mbrohen komunitetet jo-shumicë të Kosovës, mirëpo ka mungesë koordinimi. Duhet të rigjallërohet Zyra për Çështje të Bashkësisë brenda kabinetit të Kryeministrit për të ndihmuar në koordinim. Zyra duhet të angazhohet në gjurmimin e detajshëm të niveleve të punësimit të serbëve dhe pakicave jo-serbe në institucionet e Kosovës.
- Të ofrohen orë mësimi të shqipes dhe serbishtes për të gjithë punonjësit qeveritarë dhe të krijohen mjete stimuluese për nxitjen e mësimit të cilësdo gjuhë joamtare.
- Kuvendi po ashtu duhet të miratojë ligjin për krijimin e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (KPCVA) sipas marrëveshjes së Brukselit, ashtuqë dokumentet kadastrale të mund të transferohen nga Serbia.
- Organet e zbatimit të ligjit në Kosovë duhet të synojnë të formojnë raporte formale me Interpolin dhe Europolin, të parashtrojnë aplikacion të kompletuar dhe detajuar për anëtarësim në Interpol, ndërkohë që i bëjnë kërkesë Këshillit të Ministrave të BE-së që të përfshijnë Kosovën në listën e shteteve të treta dhe organizatave të jashtme me të cilat Europoli duhet të synojë të ketë marrëveshje strategjike dhe operacionale, për hir të bashkëpunimit ndërkombëtar policor, për sigurinë e Evropës, dhe për ta vendosur Kosovën në hap të njëjtë me shtetet tjera kandiduese dhe me kandidatë potencialë.

### **Për Serbinë:**

- Raporti i parë për gjendjen e ecurisë së implementimit të dialogut, i publikuar në prill, paraqet hap të mbarë. Këso raporte mbi nivelin e implementimit të marrëveshjeve duhet të publikohen më shpesh.
- Kuvendi i Serbisë duhet të ratifikojë të ashtuquajturën marrëveshje të Brukselit.
- Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka përcaktuar se disa marrëveshje të bëra në Bruksel ishin jokushtetuese. Është mirë që Serbia ka rregul-

luar kornizën e saj kushtetuese lidhur me këto marrëveshje, por, siç i përkujton BE në progres-raport, Serbia akoma nuk ka vepruar po kështu lidhur me marrëveshjen mbi lirinë e lëvizjes. Vendimet mbi marrëveshjet për energji dhe telekom akoma janë në pritje. Serbia duhet të gjejë zgjidhje ligjore për implementimin e marrëveshjeve që janë të qëndrueshme dhe që mund t'u dalin ballë sfidave ligjore.

- Të inkurajojë kulturë të pjesëmarrjes lokale të serbëve të Kosovës në Qeverinë e Kosovës, me më shumë se një parti dominuese.
- Të bëjë përpjekje serioze për të mbyllur kalimet kufitare ilegale në veri të Kosovës.
- Parlamenti duhet të diskutojë hapur raportin e Komisionit Hulumtues të vet ("Anketni Odbor") për Kosovën dhe të publikojë rezultate konkrete të hulumtimeve të saja lidhur me burimet e financimit të dhëna nga Kosova që nga viti 2000 deri 2012.<sup>8</sup>
- Të inkurajojë liderët serbë të Kosovës drejt pjesëmarrjes në institucione të cilat janë jo vetëm të ndërlidhura me komunitete apo pakica, por që edhe janë me rëndësi për të gjithë qytetarët.  
Të inkurajojë liderët vendorë serbë të Kosovës që të flasin në emër të tyre pa nevojë për të verifikuar deklaratat me Beogradin.
- Të mbyllë me kujdes Privremeno Veće-n, apo këshillet e përkohshme, duke siguruar ndërkohë kushtet e jetesës për njerëzit e punësuar nga to. Të inkurajojë ata që vazhdojnë të jenë të punësuar në sistemin e Serbisë drejt transferimit në sistemin e Kosovës, duke i siguruar se do të vazhdojnë të kenë të drejtën e pranim të pensionit nga Serbia, duke u numëruar edhe vitet që e punës në sistemin e Kosovës.
- Bashkësisë Ndërkombëtare, veçanërisht Bashkimit Evropian:
- Të përmbushë zotimet financiare për ndarje të fondeve për projekte zhvillimore në Kosovën veriore.
- Të shqyrtojë krijimin e një portali informativ të vetin lidhur me dialogun, apo së paku t'ia kushtojë një faqe dialogut në uebfaqen e EEAS, ku do të mblidhen të gjitha materialet përkatëse.
- Të shqyrtojë publikimin e "progres-raporteve" të rregullta mbi gjendjen e implementimit të marrëveshjeve.
- Të mandatojë transparencë më të madhe sa i përket personave në negociim nga të dy ekipet, dhe të kërkojë nga palët gjithëpërfshirje më të madhe në përbërjet e atyre ekipeve.
- Të vazhdojë të mbështesë dhe të inkurajojë zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe të implementojë zotimet për financim.
- Marrë parasysh tërheqjen e misionit të EULEX-it, dhe statusit të Kosovës si shtet kandidat për pranim në BE, Këshilli i Bashkimit Evropian duhet ta propozojë Kosovën si kandidat për anëtarësim në Europol.

<sup>8</sup> Për më shumë rreth kësaj teme shih: <http://www.blic.rs/Vesti/Politika/457889/Anketni-odbor-Patriote-sa-Kosova-se-bogafile-potkradajuci-drzavni-budzet-Na-sta-je-otislo-3-milijarde-evra>

## Hyrje

Marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë kanë qenë të tendosura shumë para luftës së viteve 1998-1999 dhe shpalljes së pavarësisë më 2008. Në vitin 2011, Kosova dhe Serbia filluan diskutimin e çështjeve teknike bilaterale. Si rezultat, shkëmbimi i mallrave dhe lëvizja e njerëzve është bërë më e shpeshtë dhe relativisht me kosto të ulët.

Më 19 prill 2013, Kosova dhe Serbia vunë nënshkrim historik mbi “Marrëveshjen e Parë rreth parimeve që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve”, e cila përcaktoi kornizën për Kosovën që ajo përfundimisht të konsolidojë kontrollin mbi pjesën e paqetë të vendit, veriu e banuar kryesisht me popullsi serbe.

Dialogu i ndërmjetësuar nga Brukseli dukej se ngadalë por sigurt po fuste në kornizë funksionale, qoftë nëse jo harmonike, marrëdhëniet mes të dyjave. Në masë të madhe për shkak të progresit me dialogun, Kosova nënshkroi Marrëveshjen për Stabilizim Asocim me Bashkimin Evropian në Strasburg, më 27 tetor 2015. Serbia pritet të hapë kapitujt e parë për pranim në BE, para fundit të vitit.

Pastaj, dialogu filloi të duket në lëvizje në vitin 2015, pas gati një vit stagnimi komplet për shkak të zgjedhjeve në Serbi, në Kosovë dhe në Bashkimin Evropian, ku në të trija ndodhën ndryshime lidhshme. Pjesa e parë e vitit 2015 ishte premtuese për ecje përpara. Dy marrëveshje u nënshkruan mbi integrimin e gjyqësorit dhe shpërbërjen e Mbrojtjes Civile, në muajt shkurt, respektivisht mars, të cilat u përcollën deri diku me implementim. Pastaj, në fund të verës së nxehtë e të gjatë, katër marrëveshje, që nga Përfaqësuesja e Lartë e BE, Mogherini, u vlerësuan si “pikë kthese”, shpalesën plane për katër çështjet që ishin bllokuar paraprakisht: energjinë, telekomin, Asociacionin e komunave me shumicë serbe, si dhe çështjen grindëse të urës së çelikut që e ndan Mitrovicën në veriore dhe jugore.

Muajt pasues sollën ndasi dhe dhunë në rrugët e Prishtinës dhe në parlament, derisa tri grupet opozitare mundohen të detyrojnë lidhshimin e Kosovës që të tërhiqet nga marrëveshja mbi themelimin e Asociacionit, si dhe nga ajo e demarkacionit me Malin e Zi. Taktikat e deritashme kanë përfshirë goditje me vezë drejt ministrave, hedhje të gazit lotsjellës, dhe spërkatje me sprej sydjegës në parlament dhe në rrugë.

Kjo gjë ka bërë që serbët e Kosovës të ndjehen të pasigurtë, ka dëmtuar imazhin e Kosovës, dhe ka prodhuar ndjenja të këqija mes Beogradit e Prishtinës.

Konkurrimi i Kosovës për anëtarësim në UNESCO ishte gjithashtu burim zënkash mes dy shteteve. Prishtina udhëhoqi fushatë të qetë, dhe kryesisht pozitive për anëtarësi, dhe e motivuar që të zgjerojë legjitimitetin e saj ndërkombëtar dhe të vjelë benefitet nga anëtarësia në UNESCO. Beogradi ishte fillimisht i qetë por dikur zbarkoi me kundër-fushatë të bashkërenditur. Beogradi, dhe anëtarët e klerit ortodoks, si Ati Sava Janjiq, shprehën shqetësime lidhur me një draft ligj mbi trashëgiminë kulturore që kishte paraqitur Kuvendi

i Kosovës në muajin prill. Shqetësimi ishte se ligji synonte të nacionalizonte pronën e Kishës Ortodokse Serbe.<sup>9</sup> Beogradi që atëherë ka pohuar se dëshiron që çështja e trashëgimisë fetare të shtrohet në dialogun e Brukselit, ndërkohë që Prishtina ka thënë se veçse ekzistojnë mjaft mekanizma për të siguruar mbijetesën e pronës së Kishës Ortodokse Serbe. Ministri për Punë të Jashtme i Serbisë, Ivica Dačić, eskaloj tensionet kur tha se pranimi i Kosovës do të ishte i barasvlerëshëm me pranimin e ISIS-it.<sup>10</sup>

Kosova humbi për tri vota, dhe në ndërkohë u krijua armiqësi e madhe mes njerëzve nga të dy vendet. Dështimi i konkurrencimit pas përpjekjeve të bashkërenduara të Serbisë për ta penguar atë bënë që shumë kosovarë të besojnë se Kosova nuk duhet të vazhdojë aq kollaj dialogun me Serbinë pa u siguruar rreth disa çështjeve, gjë që e dobësoi idenë e vazhdimin të dialogut pa koncesione nga ana e Serbisë. Një grup aktivistësh të shoqërisë civile dërguan letër të hapur<sup>11</sup> me të cilën i bënin ftesë qeverisë së Kosovës që të caktojë kushte të reja për vazhdimin e dialogut, dhe i bënin ftesë BE-së që të sigurojë kushtet për dialog të barabartë. (Anëtarët e shoqërisë civile bënë thirrje edhe për llogaridhënie përbrenda Kosovës lidhur me konkurrencimin e dështuar, dhe bënë thirrje për mbrojtje të vazhduar të trashëgimisë kulturore në Kosovë). Lufta disa mujore mediale ishte aq helmuese për marrëdhëniet, në nivele të larta, dhe ripërtëriu armiqësinë edhe mes qytetarëve.

Gjithsesi që, marrëveshja e 19 prillit 2013 ndodhet në vetë thelbin e destabilizimit të vazhdueshëm të parlamentit nga ana e opozitës përmes gazit lotsjellës, sprejit të syve, dhe retorikës ndasore.

“Do të pengojmë çdo seancë parlamentare që do të organizohet nga Qeveria e Kosovës”, tha një përfaqësues i Vetëvendosjes më 9 nëntor, duke kërcënuar me eskalim të situatës derisa të tërhiqet marrëveshja. “Nuk do të lejojmë mbajtjen e asnjë seance të rregullt deri në tërheqjen e nënshkrimeve nga Marrëveshjet e arritura në Bruksel, për shkak se ato janë të dëmshme”.<sup>12</sup> Kjo gjë paraqiti ndryshime domethënëse të qëndrimeve të partive tjera opozitare. Deputeti i AAK, Ramush Haradinaj, mbështeste marrëveshjen në vitin 2013 dhe thoshte se Asociacioni në fjalë ishte në dakord me Kushtetutën e Kosovës.<sup>13</sup>

Kjo filloi pas datës 25 gusht, kur palët në Bruksel nënshkruan katër marrëveshje kyçe të cilat plotësuan më tej marrëveshjen e vitit 2013, që përqendrohej në elementet kryesore të Asociacionit në fjalë të komunave me shumicë serbe, marrëveshjet për krijimin e kodit shtetëror për Kosovën dhe distribuimin e energjisë, si dhe rezolutën për barrikadën në urën e Mitrovicës.

Negociatori i Serbisë, Marko Gjuriq, lëshoi njëftim shumë të shpejtë duke

9 Judah, Tim. “At Sava: Koha për të Ecur përpara dhe për të filluar dialogun”, Balkan Insight, 13 nëntor 2015. <http://www.balkaninsight.com/en/article/fr-sava-time-to-go-forward-and-start-dialogue-11-12-2015>

10 “Pranimi i Kosovës në UNESCO do të ishte njëjtë me pranimin e ISIS-it,” Tanjug, 4 tetor 2015. [http://www.tanjug.rs/full-vieë\\_en.aspx?izb=205909](http://www.tanjug.rs/full-vieë_en.aspx?izb=205909)

11 Për më shumë lidhur me letrën shih: <http://www.kosovotëopointzero.com/en/article/1950/there-is-life-after-unesco-and-much-ëork-to-do-too> dhe <http://koha.net/?id=27&l=83641>

12 Frasher Krasniqi, zëdhënës për Vetëvendosje, 9 nëntor 2015.

13 Shih: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=252302>



thënë se serbët “fituan katër me zero”.<sup>14</sup>

Ky veprim ishte për të përforcuar mbështetje të procesit të dialogut, sepse në bazë të anketave të fundit, vetëm 10 përqind e serbëve të Kosovës nga katër komunat veriore e mbështesin Marrëveshjen e Brukselit, edhe pse 56 përqind e të anketuarve besojnë se serbët e Kosovës duhet të marrin pjesë në institucionet e Kosovës.<sup>15</sup>

Në ndërkohë, Serbia është përballur për muaj të tërë me fluksin e mijëra emigrantësh dhe refugjatësh nga Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore nga kufiri i saj me Maqedoninë, të cilët synonin që të gjithë të kalonin sa më parë në Hungari, dhe kah fundi i shtatorit, në Kroaci. Serbia mori lëvdata nga Berlina dhe Brukseli për trajtimin tejet human të migruesve. Beogradi shpenzoi energji të shumtë në angazhimet me fqinjtë e saj të ashpër Hungarinë, të cilët ngritën gardh ndarës në kufirin me Serbinë për të penguar hyrjen e migruesve, si dhe në angazhimet me armikun e dikurshëm, Kroacinë, lidhur me tejkalimin e disa mosmarrëveshjeve rreth linjës shtegtuese të migruesve në mënyrë që të mund t'i lirojë të kalojnë.

Pritej që konkurrimi në UNESCO do t'i injektonte një momentum pozitiv kësaj vjeshte të Kosovës të dominuar me protesta brenda e jashtë parlamentit. Koalicioni opozitar nisi një peticion kundër marrëveshjes për Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe dhe marrëveshjes për demarkacionin kufitar me Malin e Zi, dhe siguroi mbi 200,000 nënshkrime. Të dy marrëveshjet ishin parakusht për Kosovën që ajo të pranojë MSA-në. Deputetët e koalicionit u zotuan se do të bllokojnë parlamentin deri sa qeveria t'i tërheqë nënshkrimet nga marrëveshjet.

Më 13 tetor, aktivistë të opozitës sulmuan një stacion policie në Prishtinë pasi që ish kryetari i Vetëvendosjes dhe deputeti aktual, Albin Kurti, u arrestua për hedhje të gazit lotsjellës në parlament. Kurti u lirua pas tri orësh,<sup>16</sup> por parlamenti vazhdoi të jetë i çrregulluar. Çdo seancë mbahet në një sallë të vogël përmbi sallën e seancave plenare.

Ndërkohë në Serbi, liderët filluan të ankohen se Gjermania po imponon kushte të reja për pranim në BE, gjë të cilën ambasadori gjerman e mohoi me shpejtësi. Presidenti Tomislav Nikoliq tha për një grup gazetarësh gjermanë në Beograd më datë 15 tetor se njohja e pavarësisë së Kosovës nga zyrtarët e Serbisë do të shkaktoje luftë civile brenda vendit.

Marko Gjuriq tha për televizionin B92 më 14 tetor, se edhe pse Gjermania nuk kishte nxitur Serbinë që ta njohë Kosovën si shtet i pavarur, kishte prezantuar disa kushte të cilat për Beogradin dukeshin të barazvlefshme me njohje joformale të pavarësisë së Prishtinës.

Të nesërmen, Tanjugi i Serbisë publikoi reagimin e kryeministrit Vuçiq ndaj një dokumenti të Shërbimit Evropian për Veprime të Jashtme lidhur me

<sup>14</sup>[http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=08&dd=25&nav\\_category=11&nav\\_id=1031255](http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=08&dd=25&nav_category=11&nav_id=1031255)

<sup>15</sup> Pikëpamjet e qytetarëve në veri të Kosovës, "AKTIV & Qendra për Paqe e Tolerancë, nëntor 2015.

<sup>16</sup> <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-police-arrests-opposition-mp-11-18-2015>

Kapitulullin 35 të pranimit në BE, i cili ka të bëjë me marrëdhëniet e Serbisë me Kosovë. Aty, kryeministri Vuçiq ngriti dhjetë kundërshtime,<sup>17</sup> duke përfshirë atë se “Kërkohet mosvazhdimi i mbështetjes financiare për strukturat e Serbisë, përfshirë edhe organet e përkohshme komunale, gjë që nënkupton përjashtimin nga puna për rreth 5,000 persona dhe që çon në erozion të autoritetit të Serbisë në Kosovë e Metohi.” Kundërshtim tjetër është ai se dokumenti fton Serbinë që të pranojë vulën e Kosovës dhe mbishkrimet në korrespondenca zyrtare, në të cilat shkruan “Republika e Kosovës”.

Kryeministri i Serbisë Vuçiq ishte shumë i zëshëm duke thënë se nuk do të “heqë dorë” nga diga e Gazivodës në Zubin Potok, në veri të Kosovës, edhe pse dokumenti kërkon gjetje të një zgjidhjeje reciprokisht të pranueshme, si parakusht për anëtarësim në BE.

Kryeministri po ashtu shprehu pakënaqësinë e tij me termin e përdorur “normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën,” dhe jo me Prishtinën, siç kishte qenë emërtimi zyrtar i procesit deri atëherë.

Më 31 tetor, Presidentja Atifete Jahjaga dërgoi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për interpretim të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve, me shpresën se kjo do t'i jepte fund bllokadës së parlamentit.

Ekzistojnë shqetësime me bazë sa i përket natyrës mono-etnike të Asociacionit, por këto duhet të debatohen brenda parlamentit dhe jo me dhunë.

Më 10 nëntor, Gjykata vendosi se kërkesa e Presidentes që të pezullohet përkohësisht i gjithë aktiviteti lidhur me implementimin e marrëveshjes ishte në interes të publikut, dhe deklaroi se do të merrë vendim mbi kushtetutshmërinë e parimeve para datës 12 janar 2015.

Vetëvendosje menjëherë pretendoi për fitore, duke e quajtur gjykatën të kapur nga shteti, dhe duke thënë se nuk do të ndalin aktivitetet derisa marrëveshja të anulohet.

Ministri i jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, tha se vonesa paraqet “kërcënim për sigurinë rajonale”. Anëtarët e Listës Serbe, partisë serbe në Kosovë që mbështetet nga Beogradi, kanë thënë se mund të largohen nga koalicioni qeverisës nëse nuk bëhen përpjekje për të formuar Asociacionin. Më 16 nëntor, ministri i Kosovës për Vetëqeverisje Lokale, Branimir Stojanović, tha se edhe ndërprerja e dialogut është opcion në tryezë.

“I vetmi opcion që s’vjen në shprehje është të hiqet dorë nga të jetuarit në këtë zonë. Gjithçka tjetër është opcion”, tha ai për media. “Kur të shterohen të gjitha mundësitë për dialog të arsyeshëm e të kuptimtë, atëherë besoj se, sikur që mund të vendoset për të biseduar, mund të merret vendim për të mos biseduar”.<sup>18</sup>

Më 18 nëntor, shpërthyen edhe më shumë trazira pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë lëshoi fletarrest për katër deputetë të Kuvendit të Kosovës, nga

<sup>17</sup> Shih tekstin e plotë këtu: <http://europeanwesternbalkans.com/2015/10/15/ten-contentious-points-of-eus-draft-resolution/>

<sup>18</sup> “Serbët “mund ta lënë” qeverinë pas mos-implementimit të marrëveshjes,” B92, 16 November 2015. [http://www.b92.net/eng/nees/politics.php?yyyy=2015&mm=11&dd=16&nav\\_id=96062](http://www.b92.net/eng/nees/politics.php?yyyy=2015&mm=11&dd=16&nav_id=96062)

Vetëvendosje Albin Kurti, Albulena Haxhiu dhe Faton Topalli, dhe Donika Kadaj-Bujupi, anëtare e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Numri i njerëzve që dalin në rrugë kurrë nuk është më shumë se një mijë, zakonisht sillet në disa qindra, gjë që nënkupton se nuk ekziston ndonjë kërcënim i vërtetë për protestë masive kundër marrëveshjeve, ndonëse pak ditë para publikimit të këtij raporti është e planifikuar një protestë. Megjithatë, kjo tregon se opozita ka bojkotuar votimin për ratifikim të MSA-së për Kosovën. Gjendja ka qenë e tillë që të gjitha partitë e vendit ishin të zotuar për një Kosovë me të ardhme evropiane, mirëpo, pa përkushtim të fortë nga BE, edhe kjo gjë mund të thahet.

# MARRËVESHJET

## RAUNDI 1: Dialogu Teknik

Kur negociatori i Beogradit, Borko Stefanoviq, që atëherë shërbente si drejtor politik pranë Ministrisë së Serbisë për Punë të Jashtme, dhe Zëvendës-Kryeminstrija e Kosovës, Edita Tahiri, filluar takimet në mars të vitit 2011, ishte hera e parë që Serbia dhe Kosova hynin në negociata që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës më 2008. Takimet rregullisht përbënin faqet e para të lajmeve, dhe ato ishin tepër jopopullore në sytë e publikut. Negociatorët nënshkruan marrëveshjet e para qysh në muajin korrik. Në po atë muaj, përgjatë kufirit shpërtheu dhunë, teksa Policia e Kosovës u përpoq të marrë kontrollin mbi pikat kufitare dhe të vendosë doganën e Kosovës mbi mallrat që kalojnë aty. U desh të intervenonin forcat e NATO-s për të stabilizuar situatën. Një oficer i Policisë së Kosovës, Enver Zymberi, u vra gjatë përpjekjeve për të marrë nën kontroll pikën kufitare veriore. Gjashtë të tjerë u plagosën.

Gajtë raundit teknik të të ashtuquajturit 'dialog', palët nga Kosova dhe Serbia u pajtuan mbi pikat në vijim, të përmbledhura dhe të prezantuara me radhitje kronologjike<sup>19</sup>:

### Liria e Lëvizjes<sup>20</sup>:

Më datë 2 korrik 2011, të dy palët u pajtuan që banorët e secilit vend të mund të qarkullojnë lirshëm "brenda apo tranzit nëpër territorin e tjetrit". Ky proces do të ndihmohej me anë të një sistemi për letërnjoftime për kalim të 'pikave kufitare' të banorëve nga pala tjetër, dhe përmes dokumenteve të hyrje/daljes. Të dy palët u pajtuan se do t'u mundësojnë banorëve të njëjës palë udhëtim të lirshëm qoftë brenda vendit qoftë tranzit nëpër shtetin e palës tjetër. Palët u pajtuan edhe për zgjidhje të përkohshme për pagesë të sigurimit të përkohshëm, gjersa do të punojnë drejt një aranzhmani të përbashkët për sigurim automjetesh.

### Sigurimi:

Më 23 qershor 2015, palët u pajtuan se nuk ka më nevojë që të paguhet sigurimi për automjet në kufi.

### Ura e Mitrovicës:

Më 25 gusht 2015, të dy palët u zotuan për mbyllje të bllokadës së urës më datë 15 tetor 2015, dhe të fillojnë ndërtimet. Ura është pajtuar të jetë e hapur

19 Gjuha zyrtare për secilën marrëveshje është Anglishtja. Teksti i plotë i marrëveshjeve mund të gjindet tek uebfaqja e Kosovës, këtu: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,191> dhe në uebfaqen qeveritare të Serbisë: <http://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/index.php?id=82315>.  
20 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_freedom.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_freedom.pdf)

pjesërisht e  
kompletuar

për çdo trafik jo më vonë se fundi i qershorit 2016. Në tandem, rruga qendrore e Mitrovicës veriore, Kralj Petar, duhet të rregullohet për këmbësorë deri në të njëjtin afat.

**Statusi: Pjesërisht e kompletuar**

kompletuar

### Regjistri Civil<sup>21</sup>:

Gjithashtu më datë 2 korrik 2011, të dy palët u pajtuan lidhur me komisionin trepalësh të ekspertëve të regjistrimit civil nga të dy anët dhe i kryesuar nga zyra e EULEX-it, i cili do të identifikonte hendeqet në librat e regjistrimit civil para viteve 1999. Serbia u pajtua se do të bënte kopje të regjistrave origjinalë, të cilat, pas certifikimit nga EULEX-i, do të ktheheshin në Kosovë.

**Statusi: Kompletuar**

pak  
progres

### Kadastr<sup>22</sup>:

Më 2 shtator 2011, palët u pajtuan se do të sigurojnë regjistrin e plotë kadastral për Kosovën përmes një procesi të ngjashëm me atë të nënvizuar në marrëveshjen për regjistrat civilë: Ekipte trepalëshe, të kryesuar nga BE, që do të skanojnë dhe verifikojnë dokumentet para viteve 1999. Secili dokument do të krahasohej përmes një agjencie teknike brenda Kosovës, dhe në rast të mos-përputhjes, do të trajtohej përmes një mekanizmi gjykues, me ç'rast Gjykata Supreme e Kosovës do të shqyrtonte ankesat.

**Statusi: Pak progres**

kompletuar

### Vulat Doganore<sup>23</sup>:

Më 2 shtator 2011, palët u pajtuan se do të pranojnë vulat e Doganës së Kosovës dhe premtuan se do të sigurojnë liri të lëvizjes për mallrat në pajtim me CEFTA. Marrëveshjen e Europës Qendrore për Tregti të Lirë.<sup>24</sup>

**Statusi: Kompletuar**

### Njohja Reciproke e Diplomave<sup>25</sup>:

Më 21 nëntor 2011, të dy palët u pajtuan që të kërkojnë nga Asociacioni Evropian i Universiteteve certifikimin e diplomave universitare për qëllim përdorimi nga pala tjetër, qoftë për arsimim të lartë apo për punësim në sektorin publik. BE deklaroi se do të bëjë çdo përpjekje për të filluar implementimin deri

21 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_civil\\_books.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_civil_books.pdf)

22 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_cadastral\\_records.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_cadastral_records.pdf)

23 Teksti i plotë: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_customs.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_customs.pdf)

24 Në 2006, Serbia, në kuadër të kornizës së CEFTA-s, pranoi Kosovën si zonë e pavarur doganore.

25 Teksti i plotë: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_university\\_diplomas.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_university_diplomas.pdf)

në janar të vitit 2012.

Më 29 shtator 2015, të dy palët u pajtuan se do të njohin diplomat e Kosovës brenda pesë muajsh dhe se të dyja do të krijojnë një listë të universiteteve të akredituara në shtetet respektive.

**Statusi: Nuk ka progres**

nuk ka  
progres

## IBM<sup>26</sup>:

Në kontekstin e BE-së, IBM nënkupton 'Menaxhimin e Integruar të Kufijve (Integrated Border Management)', dhe paraqet komponentë kyçe për anëtarësimin në BE. Për shkak se Serbia nuk e njeh Kosovën, ajo preferon termin 'Menaxhimi i Integruar i vijave-kufitare (Integrated Boundary Management)'.<sup>27</sup> Në negociim, është përdorur vetëm shkurtesa IBM, e cila është neutrale ndaj statusit. Më datë 2 dhjetor 2011, palët u pajtuan se do të zbatojnë konceptin e BE-së për IBM/MIK, duke rënë dakord se gradualisht do të ngrisin pika të përbashkëta kufitare "sa më shpejt që të jetë e mundur". Palët janë pajtuar se ato do të kenë përbërje të baraspeshuar me personel nga të dy palët, dhe se ato nuk do të shfaqin asnjë simbol shtetëror. Palët janë pajtuar gjithashtu se zyrtarët e EULEX-it do të jenë të pranishëm në gjashtë pikë-kalime kufitare.

pak  
progres

Më 4 shtator 2014, të dy palët arritën marrëveshje me BE për ngritje të objekteve permanente në pikat e kalimit kufitar, të cilat do të financoheshin përmes 21 milionë euro nga Instrumenti i BE për fonde Para-pranimit, për Kosovën dhe Serbinë (nga 3 Pika të kalimit kufitar secila).

Më 21 maj 2015, Kosova dhe Serbia u pajtuan se do të hapin dy pika kufitare IBM të reja, njëra afër zonës së luginës së Preshevës/Medvegjës, tek Kapia/Vrapçe dhe një tjetër në veri tek Rajetici/Izvor. E para është nën zotërim të Kosovës dhe e dyta të Serbisë, dhe sipas marrëveshjes, Pikat e kalimit kufitar duhet të jenë të hapura 24 orë në ditë çdo ditë, por dogana funksionon vetëm gjatë ditës.

**Statusi: Pak progres**

pak  
progres

Përfaqësimi dhe Bashkëpunimi Regjional<sup>28</sup>: Më 24 shkurt 2012, në baza të përkohshme, palët u pajtuan që emri i Kosovës të mund të shfaqet në organet e përkohshme me fusnotë, e cila i referohet Rezolutës së Këshillit të Sigurisë 1244 dhe vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, GjND, mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Palët u pajtuan më tej se çfarëdo marrëveshje e re do ta paraqiste Kosovën me fusnotë.

**Statusi: Pak progres**

<sup>26</sup> Teksti i plotë: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_ibm.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_ibm.pdf)

<sup>27</sup> Gjersa vijën mes saj dhe Serbisë Kosova e quan kufi, Serbia i referohet asaj si 'vijë administrative'.

<sup>28</sup> Teksti i plotë: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_representation.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_representation.pdf)

**pak  
progres**

## Telekomi<sup>29</sup>:

Më 8 shtator 2013, palët u pajtuan se BE dhe Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimit do t'i ndanin Kosovës kodin treshifror, dhe do të transferonin tre linjat që përdor Kosova (të Serbisë dhe Sllovenisë për linjat tokësore, dhe të Sllovenisë dhe Monakos për telefoni mobile) deri në janar 2015. Palët janë pajtuar gjithashtu se do të harmonizojnë spektrin për Sistemin Global për Komunikim Mobil (GSM) dhe të sinjalit televiziv, ku të dy palët janë pajtuar se nuk do të shkelin qëllimisht "kufirin/vijën ndarëse" të palës tjetër.

Më 25 gusht 2015, të dy palët u pajtuan rreth planit të implementimit për marrëveshjet paraprake të telekomit. Kosovës do t'i jepej kodi +383 nga UNT/ITU. Në ndërkohë, Kosova do t'i jep autorizim të përkohshëm për telefoni mobile dhe fikse një kompanie të re, filialë e kompanisë nga Serbia, të regjistruar në Kosovë nën ligjet e Kosovës.

**Statusi: Pak progres**

## Energjia<sup>30</sup>:

Palët janë pajtuar se organet e tyre të transmisionit të energjisë, KOSTT i Kosovës, dhe EMS i Serbisë, do të nënshkruanin marrëveshje bilaterale brenda tre muajsh, duke përcaktuar dhe rregulluar marrëdhëniet mes dy operatorëve të sistemeve të transmisionit. Të dy rregullatorët duhet të lëshojnë licenca tregtare (import, eksport, tranzit) dhe të furnizojnë kompanitë respektive të distribucionit. Palët janë pajtuar gjithashtu rreth themelimit të një kompanie të re nën ligjet e Kosovës e cila do të ofrojë shërbime të distribucionit për komunitetet veriore, me shumicë serbe. Kosova dhe Serbia gjithashtu janë pajtuar që, në një të ardhme, të gjejnë metodë të përbashkët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë me njëra tjetrën sa i përket shfrytëzimit të linjave të transmisionit, duke u pajtuar se do të kërkojnë arbitrazh ndërkombëtar nëse nuk ka asnjë zgjidhje brenda gjashtë muajsh.

Më 25 gusht, KOSTT i Kosovës nënshkroi marrëveshjen për konesionin me Rrjetin Europian të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E) dhe anëtarët e saj. Si pjesë e marrëveshjes, dy kompani të reja, nga kompani amë nga Serbia, një për tregti të energjisë dhe një për furnizim e distribuim të saj, do të regjistrohen nën ligjet e Kosovës dhe do t'i shërbejnë Kosovës veriore.

**Statusi: Pjesërisht e kompletuar**

Secila nga marrëveshjet bënte thirrje për plan implementimi<sup>31</sup> dhe për komision vlerësues që të mbikëqyrë progresin e saj.

29 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements\\_regarding\\_Telecommunications\\_September\\_8\\_2013.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements_regarding_Telecommunications_September_8_2013.pdf)

30 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements\\_regarding\\_Energy\\_September\\_8\\_2013.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements_regarding_Energy_September_8_2013.pdf)

31 Plani i implementimit për marrëveshjen e 19 Prill 2013 ndodhet këtu: <https://s3.eu-central-1.amazonaws.com/euobs-media/0807580ad8281aefa2a89e38c49689f9.pdf>

**pjesërisht e  
kompletuar**

## RAUNDI 2: Dialogu Politik

Baronesha Catherine Ashton, Përfaqësuesja e Lartë e mëparshme, bëri bashkë kryeministrat rreth dakordimit për “Marrëveshjen e Parë mbi Parimet Qeverisëse të Normalizimit të Marrëdhënieve”, të nënshkruar më 19 prill 2013.<sup>32</sup> Ajo përmbante marrëveshjet në vijim:

### Krijimi i katër komunave

Palët u pajtuan se në katër komunat veriore do të organizoheshin zgjedhjet komunale në vitin 2013, me ndërmjetësim të OSBE-së, në pajtim me ligjin e Kosovës dhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare.

**Statusi: Kompletuar**

kompletuar

### Asociacioni/Bashkësia e komunave serbe

Palët janë pajtuar që pas përfundimit të zgjedhjeve, do të themelohej një Asociacion/Bashkësi e 10 komunave të Kosovës me shumicë serbe, që do të ketë “mbikqyrje të plotë të sferave të zhvillimit ekonomik, të arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban e rural”, dhe kompetenca të tjera të deleguara nga autoritetet qendrore. Anëtarësia e saj është e hapur për të gjithë anëtarët përderisa të gjithë anëtarët pajtohen. Asociacioni/Bashkësia do të krijohet përmes një statute, mbi bazën e njëjtë si ajo e statutit ekzistues të Asociacionit të komunave të Kosovës. Komunat pjesëmarrëse “do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrim të autoritetit kolektiv përmes Bashkësisë/Asociacionit”, në pajtim me Kartën Europiane të Vetë Qeverisjes Lokale dhe ligjin e Kosovës. Ky organ do të ketë rol përfaqësues tek autoritetet qendrore dhe do të ketë ulëse në këshillet konsultative për komunitete për këtë qëllim.

Më 25 gusht 2015, palët u pajtuan rreth një varg “parimesh të përgjithshme/elementesh kryesore” mbi Asociacionin/Bashkësinë e ardhshme të komunave me shumicë serbe.<sup>33</sup> Dokumenti nënvizon kornizën ligjore, objektivat, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, kapacitetin ligjor, buxhetin dhe mbështetjen, si dhe dispozita të tjera. Palët janë pajtuar në parim se në bazë të kësaj do të hartohet statuti, paralel me procesin e shuarjes së strukturave të mbetura qeverisëse të Serbisë në Kosovë.

**Statusi: Pak progres**

pak  
progres

### Policia

Policia e Kosovës, PK, do të jetë e vetmja polici që operon në territorin e

<sup>32</sup> Verzioni zyrtar i secilës marrëveshje është në Anglisht. Ky dokument është në dispozicion në uebfaqen qeveritare të Kosovës, këtu: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/FIRST\\_AGREEMENT\\_OF\\_PRINCIPLES\\_GOVERNING\\_THE\\_NORMALIZATION\\_OF\\_RELATIONS,\\_APRIL\\_19,\\_2013\\_BRUSSELS\\_en.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/FIRST_AGREEMENT_OF_PRINCIPLES_GOVERNING_THE_NORMALIZATION_OF_RELATIONS,_APRIL_19,_2013_BRUSSELS_en.pdf)

<sup>33</sup> [http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/150825\\_02\\_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf)



pjesërisht e  
kompletuar

Kosovës. Të gjithë policët që punojnë në veriun e Kosovës do të integrohen në PK dhe të gjitha pagat do të paguhen nga ky organ. Anëtarëve të strukturave të sigurisë së Serbisë do t'u ofrohet një vend në struktura ekuivalente të Kosovës.

Një komandant rajonal do të mbikëqyrë katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovicë e veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq). Komandanti do të jetë serb, i emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës "nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave, në emër të Asociacionit/Bashkësisë". Përbërja e njësisë rajonale do të reflektojë përbërjen etnike të katër komunave. Do të emërohet një komandant i veçantë rajonal për Mitrovicën e Jugut, Skenderaj dhe Vushtrri, por komandanti rajonal i njësisë që mbulon katër komunat veriore do të bashkëpunojë me komandantët e tjerë rajonalë.

**Statusi: Pjesërisht e kompletuar**

## Siguria

Pika 8 e marrëveshjes së 19 prillit 2013 thotë se "anëtarëve të strukturave tjera të sigurisë do t'u ofrohet një vend në struktura ekuivalente të Kosovës". Më 26 mars 2015, palët u pajtuan rreth një mekanizmi për të integruar ish anëtarët e të ashtuquajturës Mbrojtje Civile, dhe t'i japin pronën e tyre në përdorim të qeverisë së Kosovës.

**Statusi: Pjesërisht e kompletuar**

pjesërisht e  
kompletuar

## Gjyqësori

Palët janë pajtuar që autoritetet ekzistuese gjyqësore do të integrohen në sistemin e Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themelojë një panel të përbërë nga shumicë gjyqtarësh serbë të Kosovës që do të trajtojnë të gjitha komunat me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të ketë ulëse të përhershme në Mitrovicë të veriut. Gjyqtarët serbë të Kosovës do të përbëjnë shumicën në secilin panel.

Më 10 shkurt 2015, të dy palët u takuan në Bruksel dhe u pajtuan saktësisht rreth asaj se si duhet të duket struktura e gjyqësorit. Palët u pajtuan që kryetari i gjykatës do të jetë serb i Kosovës nga veriu. Gjykata në Mitrovicë së veriut do të ketë një divizion për ankesa, me pesë gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 2 gjyqtarë shqiptarë të Kosovës, ndërkohë që një serb i Kosovës do të emërohet nën kryetar i gjykatës së apelit në Prishtinë. Gjykata do të ketë edhe divizion për krime të rënda për tërë rajonin, i cili do të përbëhet nga katër gjyqtarë serbë të Kosovës dhe katër gjyqtarë shqiptarë të Kosovës. Janë përshtuar edhe numrat specifikë të stafit serb dhe shqiptar për secilën gjykatë dhe degë të saj.<sup>34</sup>

**Statusi: Pak progres**

pak  
progres

<sup>34</sup> Kjo marrëveshje u publikua në formë të dokumentit të rrjedhur. Ministria e Drejtësisë e Kosovës e ka bërë të mundshme për BIG DEAL, por nuk e ka publikuar tekstin e plotë të marrëveshjes në internet.

## Tjera

Të dyja palët janë pajtuar po ashtu se diskutimet mbi energjinë dhe telekomet duhet të intensifikohen dhe të kompletohen deri më 15 qershor 2013.

**Statusi: Pjesërisht e kompletuar**

pjesërisht e kompletuar

Të dyja palët janë pajtuar se asnjëra nuk do ta bllokojë, apo të inkurajojë tjerët të bllokojnë progresin e palës tjetër në rrugët e tyre respektive drejt BE-së.

**Statusi: Pak progres**

pak progres

Përfundimisht, palët janë pajtuar që të themelojnë një komision implementues, me lehtësim nga BE. Krye-negociatori i secilit vend kryeson komisionin respektiv implementues. Ata mbikëqyrin punën e komisioneve implementuese duke u marrë me çdo çështje specifike.

**Statusi: Kompletuar**

kompletuar

Që nga marrëveshja e prillit 2013, ka pasur progres në implementim, por nuk është hapur asnjë temë e re. Në mënyrë që normalizimi të vazhdojë, palët do të duhet të fillojnë diskutimet lidhur me shpërbërjen e administratës tatimore të Serbisë në veri. Krahas kësaj, procesi i normalizimit do të vazhdojë të ndodhë në tandem me një varg privatizimesh të bizneseve, të kërkuara edhe nga Prishtina edhe nga Beogradi. Ndonëse nuk është i lidhur direkt me normalizimin, të dyja palët e shohin privatizimin e minierës së Trepçës, centralit të Gazivodës, dhe qendrës së skijimit të Brezovicës si ofrues kryesorë të punësimit në të ardhmen, dhe beteja për vende pune do të ketë efekt në procesin e normalizimit.

## Liria e Lëvizjes për Njerëz dhe Mallra

Liria e lëvizjes mes Kosovës dhe Serbisë ka qenë e kufizuar që nga lufta, dhe sidomos pas pavarësisë.<sup>35</sup> Megjithatë, falë dialogut, ajo është duke u përmirësuar, edhe pse nuk është plotësisht e lirë në aspekt të detyrimeve financiare dhe burokratike. Situata është përmirësuar dukshëm në maj të vitit 2013 pasi që marrëveshja për Liri të lëvizjes që ishte nënshkruar në vitin 2011 filloi të zbatohet. Kosovarët mund të udhëtojnë me letërnjoftimet e lëshuar nga qeveria e tyre, si dhe me kartë identiteti të UNMIK-ut dhe dokumente serbe e jugosllave. Një marrëveshje mbi njohjen reciproke të sigurimit të automjeteve, u nënshkrua në qershor të vitit 2015. Zbatimi i saj, i cili filloi më 12 gusht 2015 hoqi shumicën e kostos, por jo edhe të telasheve të udhëtimit me makinë personale nga Kosova në Serbi.

<sup>35</sup> Kosovarët të cilët nuk kanë dokumente të Serbisë nuk lejoheshin të hynin në Serbi deri sa marrëveshja filloi të implementohet, në dhjetor 2011.

Në vitin 1999, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mori mbi vete kontrollin ndaj lëshimit të kartave të identitetit personal, dokumenteve të udhëtimit, targave<sup>36</sup>, si dhe të përfaqësimit të Kosovës në tregtinë ndërkombëtare. Pasi që Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, UNMIK përfundoi këto praktika dhe Kosova e sapo-pavarësuar filloi të lëshojë vetë dokumentet. Vulat doganore, të cila dikur quheshin "UNMIK Customs", u bënë "Dogana e Kosovës". Kjo gjë rezultoi me një embargo të Serbisë ndaj të gjitha mallrave nga Kosova. Serbia refuzoi edhe pasaportat e Kosovës, simbolin e shtetësisë së porsalindur. Banorët e Kosovës duhej të hynin në Serbi me dokumente të lëshuara nga UNMIK, Serbia, apo Jugosllavia. Edhe udhëtimi me automjet personal ishte problematik: Serbia nuk njohu patentë-shoferet as nga UNMIK as nga Kosova. Në fund, në dhjetor të vitit 2011, një marrëveshje me rëndësi të madhe e nënshkruar nga Kosova dhe Serbia hyri në fuqi. Ajo mundësoi që kosovarët të hyjnë në Serbi, pa letërnjoftim të Serbisë, dhe me kartat e veta të identitetit. Megjithatë, deri vonë, ata duhej të paguanin sigurim të shtrenjtë, dhe nëse hyjnë me automjete të regjistruara në Kosovë, ata edhe tash duhet të blejnë targa të përkohshme.

Sot, situata është shumë më e mirë, sidomos pas heqjes së tarifave të tepruara të sigurimit, mirëpo akoma vazhdojnë telashet e ndërrimit të targave me ato të përkohshme të Serbisë, gjë që kushton kohë dhe para. Ekzistojnë rregullore se në cilat pika kufitare mund të kalojnë kosovarët, dhe ata që udhëtojnë me kartë identiteti të Kosovës gjatë hyrjes pranojnë një dokument të cilin ata duhet ta paraqesin gjatë largimit nga Serbia. Këto dokumente më parë ishin të vlefshme vetëm dy javë, tani ato lejojnë deri në 90 ditë qëndrim në Serbi. Vetëm kosovarët duhet të regjistrohen në këso mënyre, si dhe dalja nuk lejohet nëse nuk paraqitet letra.<sup>37</sup>

Nuk ka ndonjë zgjidhje për shtetasit të cilët vijnë nga shtete që nuk lëshojnë fare karta identiteti.<sup>38</sup> Nëse të huajt nuk kanë hyrë në Kosovë përmes Serbisë, nuk mund të hyjnë në Serbi përmes Kosovës. Këta të huaj duhet të hyjnë në Serbi përmes një shteti tjetër, sikurse Maqedonia apo Mali i Zi, apo me aeroplan nëpërmjet një shteti të tretë, gjë që e bën udhëtimin të gjatë dhe shpesh më të shtrenjtë. BIG DEAL ka pranuar informata lidhur me atë se shtetasve të huaj u është mohuar hyrja në Serbi (edhe pse ata kishin vulë valide të Serbisë), para intervenimit nga nivelet e larta.<sup>39</sup> Kjo është një nga kërkesat që BE i ka vënë Serbisë si pjesë e procesit shqyrtues të Kapitullit 35.<sup>40</sup>

Në progres-raportin e fundit, BE ka theksuar se sa i përket marrëveshjes për IBM (Menaxhim të Integruar të kufirit/vijës administrative), Serbia duhet të bëjë përpjekje më të fortë për të mbyllur kalimet ilegale në veri.<sup>41</sup>

36 Këto targa kanë shenjën "KS" përpara.

37 Në rast të humbjes, bartësi i dokumentit duhet ta raportojë atë tek policia e Serbisë.

38 Këto shtete nuk lëshojnë kartela identiteti: Australia, Kanada, Danimarka, Irlanda, India, Japonia, Zelanda e Re, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar, dhe Shtetet e Bashkuara.

39 Incident në mars të 2015 në pikë-kalimin kufitar në Merdare.

40 Shih pikën 9: <http://europeanwesternbalkans.com/2015/10/15/ten-contentious-points-of-eus-draft-resolution/>

41 Raporti 2015 për Kosovën\*, 10 nëntor 2015, faqe 29. Qasur përmes <http://>

## Sigurimi i automjeteve

Mosnjohja reciproke e sigurimit të automjeteve mes Kosovës dhe Serbisë ka qenë një nga pengesat kryesore për udhëtim me kosto-efikase nga të dy anët. Pas miratimit të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes në korrik të 2011, drejtuesit e automjeteve që me targa të Kosovës hynin në Serbi duhej të paguanin 105 euro në muaj – me normën minimale prej një muaji. Ata që hynin në Kosovë me targa të Serbisë paguanin pak më pak, 20 euro në javë, 40 euro për 15 ditë, 80 euro për një muaj dhe 600 euro për një vit.

Më 23 qershor, Shoqata e Sigurimeve të Serbisë, UOS, dhe Byro e Sigurimeve të Kosovës, BKS, arritën marrëveshje për njohje të sigurimeve të njëri-tjetrit. Kjo u ndërmjetësua nga Këshilli i Byrove, i cili rregullon kartonin e gjelbër ndërkombëtar, të vlefshëm në shumicën e Evropës.

"Kjo është një nga marrëveshjet më të mira që Kosova ka arritur me Serbinë", tha për Big Deal, Faton Abazi, drejtor i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), në kohën kur u arrit marrëveshja.

Kosova nuk është anëtare e sistemit të kartonit të gjelbër, i cili lejon pranimin reciprok të sigurimit të automjeteve në shumicën e Evropës, dhe kjo marrëveshje nuk e ndryshoi atë, kështu që makinat që vijnë në Kosovë edhe nga vendet e tjera përveç Serbisë megjithatë do të duhet të paguajnë.

Implementimi ishte planifikuar për datë 1 gusht, por pak ditë para se të fillohej, më 24 korrik, marrëveshja dukej se u shemb.

Zyrtarë të Prishtinës thanë se e vonuan zbatimin për shkak se marrëveshja nënkupton që Serbia do të detyrohet të lejojë hyrjen e automjeteve nga Kosova me targa dhe simbole 'RKS' (Republika e Kosovës). Zyrtarët e Beogradit këmbëngulën se targa RKS janë kundër politikës "neutrale ndaj statusit" dhe thanë se kurrë nuk kanë nënshkruar ndonjë marrëveshje e cila potencialisht mund të nënkuptojë njohje të pavarësisë së Kosovës. Me të vërtetë, marrëveshja nuk përmend targa.

Pas një takimi tjetër në Bruksel më 5 gusht, më në fund filloi implementimi më 12 gusht. Drejtuesit e automjeteve të regjistruara në Kosovë paguajnë sigurim nga palë të treta, ngjashëm me marrëveshjet me Malin e Zi. Kushton pak më shumë por nuk është aq i lartë sa ishte më herët. Megjithatë, ka lëvizje sa i përket regjimit të mëhershëm të sigurimeve, në kuptimin që siguri nuk ka nevojë të paguhet në kufi. Doli të ishte gjë ngatërruese për drejtuesit e automjeteve që arrinin në pikë kalimin kufitar në Merdare, kur gjatë kthimit në shtëpi iu duhej të paguanin sigurimin tek zyret e zakonshme të sigurimit. Kjo ka mundur t'u shpjegohet më mirë nga ana e qeverisë konsumatorëve, si dhe nga vetë kompanitë e sigurimit, meqë disa njerëz shkonin në kufi duke pritur se mund të bëjnë pagesën aty, por jo të gjitha kompanitë e Kosovës kanë pika të shitjes atje.

Krahas kësaj, ka pasur konfuzion në procesin e tranzicionit. Udhëheqësi i

Bordit të Sigurimeve të Kosovës, Rrahim Pacolli njoftoi për qëllimet e tij që të ngrijë marrëveshjen e sigurimit për shkak se Serbia ka refuzuar të njohë targat RKS. Megjithatë, Ministria Tahiri e kritikoi atë si dhe publikun lidhur me këtë nocion, duke thënë se Pacolli “e di shumë mirë se çështja e targave të përkohshme nuk është e lidhur me marrëveshjen mbi sigurimet” sepse ai ishte në ekipin negociator,<sup>42</sup> por u zotua se do ta shtrojë këtë çështje në Bruksel.

## Targat dhe Kërcënimi me Masa Reciproke

Çështja e targave vazhdon të jetë çështje e mprehtë. Në Kosovë aktualisht janë në përdorim tri grupe targash. Targat e lëshuara në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë, të cilat Serbia nuk i njeh, të cilat mbajnë simbolet ‘RKS’. Grupi i dytë janë targat ‘KS’, të cilat janë lëshuar pas përfundimit të konfliktit të vitit 1999 dhe para se Kosova të shpallë pavarësinë në vitin 2008. Grupi i tretë përfshin targat aktuale të vendit, që lëshohen nga Kosova e pavarur. Targat e kohës së Jugosllavisë nuk pranohen më, dhe Kosova nuk dëshiron të pranojë targat serbe të cilat kanë inicialet e qyteteve të Kosovës (‘KM’ për Mitrovicën, për shembull). Qeveria e Kosovës dëshiron që këto targa të ndalohen në territorin e saj, dhe ka njoftuar se do të konfiskojë çfarëdo automjeti që mban ato. Zyrtarët serbë thonë se kjo gjë është e papranueshme për serbët e Kosovës dhe se kjo asnjëherë nuk u dakordua si pjesë e ndonjë marrëveshjeje.

Qeveria e Kosovës dhe qytetarët e saj janë të shqetësuar për faktin se sistemi ekzistues, ku automjetet e regjistruara në Kosovë marrin targat “Proba” apo targa të përkohshme, nuk zbatohet në mënyrë të uniformuar në të gjitha pikat e kalimit. Në shumicën e pikave, nevojitet rreth gjysmë ore kohë dhe kushton rreth 5 euro për të blerë këto targa të përkohshme, ato duhen regjistruar, dhe pastaj duhet montuar në automjet.

Megjithatë, siç ka theksuar BIG DEAL në raportet e mëparshme, këto targa të përkohshme nuk mund të blihen në pikën e kontrollit në Jarinjë (në veri të Leposaviqit). Siç shkroi qeveria e Kosovës në një raport të tetorit 2015, në “pikën e shitjes për sigurime dhe për pagesën e targave “Proba” është më shumë se 2 km larg pikës së kontrollit IBM. Drejtuesve të automjeteve u kërkohet të parkojnë automjetet e tyre në pikën-kontrollin IBM dhe të ecin për rreth 2 km dhe të paguajnë sigurimin e kërkuar dhe të kthehen përsëri në pikën IBM dhe të paraqesin letrën e nevojshme para autoriteteve të Serbisë”.<sup>43</sup> Kjo lloj procedure e rëndë, nuk përbën “lëvizje të lirë”.

Qeveria e Kosovës ka vënë në dukje se plani i implementimit për marrëveshjen e lirisë së lëvizjes përfshin një klauzolë mbi reciprocitetin: “Pala kosovare rezervon të drejtën që, pas konsultimeve me BE-në, të zbatojë regjim të targave të përkohshme”. BIG DEAL ka mësuar se Kosova është duke ndërmarrë përgatitjet teknike për të vendosur masa reciproke. Ministria e Brendshme ka blerë 50,000 targa të përkohshme, në rast se qeveria vendos të imponojë

42 [http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2015&mm=09&dd=09&nav\\_id=95371](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2015&mm=09&dd=09&nav_id=95371)

43 Raporti i gjendjes, tetor 2015.

masa reciproke.<sup>44</sup>

Ministrja Tahiri ka thënë se qeveria e Kosovës do të fillojë me tranzicionimin e targave të paligjshme që janë akoma në përdorim nga sistemi i Serbisë (KM për Mitrovicën, GL për Gjilan, PR për Prishtinën, etj). Këto targa nuk janë në qarkullim të gjerë përveç në katër komunat veriore. Data e skadimit për periudhën e tranzicionit është viti i ardhshëm.

Ministrja Tahiri gjithashtu ka thënë se Kosova do të ndërmarrë masa për të trajtuar çështjen e automjeteve të paregjistruara, dhe së shpejti do të implementojë një tabelë kohore për këtë çështje.<sup>45</sup>

Kosova ka ngritur kundërshtime edhe lidhur me radhët e gjata në pikë kalimin kufitar në Multivodë nga Kosova drejt Medvegjës në Serbi, e cila ka popullatë të madhe shqiptare, në ditën e zgjedhjeve komunale, më 13 shtator 2015. Ka pasur raporte se autobusë të panumërt dhe rreth 200-300 automjete që tentonin të hynin në Serbi nga Kosova, prisnin në radhë për orë të tëra.<sup>46</sup>

Ministrja Tahiri tha se kjo ishte shkelje nga ana e Serbisë mbi marrëveshjen për Liri të Lëvizjes, dhe tha se ajo dhe Oficeri Ndërlidhës Valdet Sadiku u kanë bërë ftesë partnerëve në Serbi dhe lehtësuesit të BE-së, Alexis Hupin, që të intervenojnë.<sup>47</sup>

## Udhëtimi Tranzit dhe ai Ajror

Më 16 shtator 2014, të dy palët u pajtuan që të lejojnë kosovarët të udhëtojnë përmes Serbisë për në pika tjera tranziti drejt Bullgarisë dhe Maqedonisë, përveç pikave ekzistuese në Kroaci dhe Hungari. Kjo hyri në fuqi më 16 nëntor 2014. Më 22 shtator, në bazë të së njëjtës marrëveshje, mbajtësit e letërnjoftimit të Kosovës ligjërisht mund të fluturojnë përmes aeroportit ndërkombëtar të Beogradit. Kosovarët kanë raportuar për BIG DEAL se kanë arritur të fluturojnë me vajtje/ardhje nga aeroporti i Beogradit, edhe pse procesi zgjat nja gjysmë ore shtesë për shkak të burokracisë.

Fatkeqësisht, sistemi nuk është i padështueshëm. Një person nga Kosova, analisti i politikave, Shpend Kursani, kishte fluturuar me sukses në shtator të vitit 2015 nga Firenca në Beograd. Mirëpo, gjatë përpjekjeve për të marrë të njëjtin fluturim dhe nga e njëjta kompani fluturimesh ajrore, vetëm një muaj më vonë, për qëllim të mbajtjes së një trajnimi jashtë vendit, ai u bllokua nga personeli i fluturimit.

“Bëra kontrollin e pasaportës dhe bagazhit, dhe s’pati asnjë problem”, thotë Kursani. “Derisa po prisja për të kaluar portën dalëse e për të hyrë në aeroplan, mua më thirrën emrin, dhe shkova tek operatori i fluturimit i cili të pret biletën para hyrjes në aeroplan. Më kërkuan pasaportën dhe letrën kaluese të hyrjes, dhe më thanë se nuk mund të hyja në aeroplan. Arsyeja më thanë ishte se unë

<sup>44</sup> Intervistë me zyrtar ndërkombëtar në nëntor, 2015.

<sup>45</sup> Deklarata nga Ministrja Tahiri për BIG DEAL në nëntor 2015.

<sup>46</sup> Shih artikullin në Koha Ditore: “Bajram Mustafa fton qytetarët e bllokuar në Mutivodë për qetësi,” 13 shtator 2015. <http://koha.net/?id=27&l=74802>

<sup>47</sup> Shih “Gjendja e Implementimit të Marrëveshjeve të Brukselit, mars-shtator 2015,” faqe 43. [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo\\_Report\\_on\\_state\\_of\\_play\\_in\\_Brussels\\_Dialogue\\_061015-signed.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_state_of_play_in_Brussels_Dialogue_061015-signed.pdf)

nuk kisha drejtë të hyja në Serbi me pasaportë të Kosovës. U thashë se kjo është e vërtetë, por se ne nuk përdorim pasaportë për të hyrë në Serbi, dhe u shpjegova se ne përdorim letërnjoftimet, dhe se kjo ishte marrëveshja. Mirëpo, ata vetëm se kërkonin falje që kompjuterët e tyre tregonin se pasaportave të Kosovës u mohohet hyrja; andaj edhe më kthyen. U mundova t'ia shpjegoj se ekziston marrëveshja mes palëve që qytetarët e Kosovës të mund të hyjnë në Serbi me letërnjoftim, por kot. Ma kërkoi letërnjoftimin, dhe kur e pa se ishte letërnjoftim i Kosovës, tha "Më fal, por nuk mund të kalosh me këtë".

Me sa duket, liria e lëvizjes është çështje në duar të fatit. Kosovës dhe Serbisë do t'u shkonte më shumë për shtati sikur të dërgonin njoftime të përbashkëta të gjitha kompanive ajrore që fluturojnë drejt Beogradit dhe të inkurajohen ato që të përditësojnë sistemet kompjuterike.<sup>48</sup>

## Udhëtimi Hekurudhor

Tema e udhëtimit hekurudhor akoma pritet të shtrohet në Bruksel. Pasi që UNMIK ndaloi menaxhimin e sistemit hekurudhor në vitin 2008, Serbia mori nën kontroll 50 kilometra hekurudhe në veri të Kosovës, nga Zveçani në Leshak. Që nga tetori 2013, hekurudhat e Serbisë operojnë me një tren nga Mitrovica e veriut për në Kralëvë, me lidhje me Beograd e më tej. Ky tren nuk kontrollohet nga Prishtina dhe zyrtarët e qeverisë së Kosovës kanë shprehur frustrimin e tyre se Serbia nuk ka ofruar pagesën për përdorim të binarëve hekurudhorë të cilat konsiderohen pronë e Kosovës.

## Ura e Mitrovicës

Ura e çelikut e cila ndan veriun nga jugu në Mitrovicë, është më shumë simbol i ndarjes se sa që është diçka që aktivisht ndan njerëzit. Janë edhe dy ura tjera në të dy anët të cilat lidhin pjesën veriore të qytetit me pjesën jugore të komunës.

Më 18 qershor 2014, një grup serbësh larguan një barrikadë prej dheu e shkëmbinjsh e cila bllokonte anën veriore të urës për tri vite. Kjo u bë pa ndonjë njoftim paraprak të qytetarëve të të dyja anëve të urës. Brenda pak orësh që ajo ishte e hapur, disa banorë shprehën tronditje dhe indinjatë, ndërsa një grup i vogël shqiptarësh vozitën automjete në mënyrë të harlisur. Disa orë më vonë, u vendosën disa enë të mëdha me fidanë të mbjella dhe u ngritën si një lloj barrikade e improvizuar dhe kryetari i komunës së Mitrovicës veriore njoftoi se ura do të jetë një i ashtu-quajtur "Park i Paqes". Rruga ku dikur qëndronte barrikada ishte ngrehur më lart, që do të thotë se kjo gjë nuk mund të kthehej në normale brenda natës, në bazë të mënyrës se si kishte mbetur vendi pas tërheqjes së barrikadës së mëhershme.

Që nga ajo kohë, Zyra e Përfaqësuesit të BE-së në Kosovë u zotua se do të bëjë një raport mbi realizueshmërinë e çmontimit të barrikadës dhe zbukurimit

---

48 Z. Kursani kishte udhëtuar me sukses nga Beogradi për në Firencë përmes Alitalia më 27 shtator 2015. U ndalua nga po i njëjti fluturim më datë 19 nëntor 2015.

të zonës. U krijua një grup punues i udhëhequr nga BE-ja, për të përgatitur një plan për urën i cili do të ishte i pranueshëm për të gjitha palët. Më 29 qershor 2015, të dyja palët u pajtuan rreth një plani të përbashkët arkitekturor.

Më 25 gusht 2015, nga lista e gjitha marrëveshjeve të bëra në Bruksel ishte edhe një marrëveshje për të ardhmen e urës. Të dyja palët u zotuan për mbyllje të urës më 15 tetor dhe për fillim të ndërtimit. Ura do të jetë e hapur për të gjithë trafikun jo më vonë se fundi i muajit qershor 2016. Në tandem, rruga qendrore e veriore e Mitrovicës, Krala Petra (Mbreti Petar), duhet të rregullohet për këmbësorë deri në po atë afat kohor.

Më 15 tetor, kur ishte planifikuar fillimi i ndërtimit, ai u shty për 48 orë për shkak se çështja e ndërtimit ndërlidhej me Memorandumin e Mirëkuptimit rreth pritjes së përcaktimit të dy lagjeve në veri të Mitrovicës. Disa mosmarrëveshje vazhdojnë lidhur me atë se a do të rregullohet për këmbësorë apo jo rruga Kolashinska, por ka të ngjarë që ajo do të mbetet rrugë për makina.

Zona tani është e pa-qasshme, e mbyllur nga një gardh prej fijesh metalike, dhe i ashtu-quajtur "Parku i Paqes" është komplet i bllokuar nga pamja dhe qasja. Trafiku i këmbësorëve është i mundur nëpërmjet trotuarit në anën perëndimore të urës por ajo është nën ruajtje të rreptë.

"Bllokimi i plotë dërgon mesazh të rrezikshëm", thotë një udhëheqës i qeverisë lokale në Mitrovicë të veriut. "Parku i Paqes ishte progres, ndërsa tani kjo barrikadë dërgon mesazh të rrezikshëm. Është mirë që ajo ka fletë-ngjitëse të BE-së gjithandej nëpër të, kështu që nuk duket si iniciativë lokale. Vendimet e imponuara nuk janë të qëndrueshme".

Më 13 nëntor zyra e BE-së në Kosovë hapi tender për kontratën, i cili do të mbyllet më 18 janar 2016.

## Suhadolli dhe Kroit i Vitakut

Një çështje e vazhdueshme ka qenë demarkacioni i dy lagjeve në veri të Mitrovicës, Suhadollit dhe Kroit të Vitakut, të cilat sipas politikanëve vendorë lidhen me çështjen e urës. Suhadolli është rreth 1 kilometër nga ura kryesore e lumit Ibër, e cila ndahet në lagjen e poshtme dhe të epërme me rreth një kilometër distancë në mes. Rreth 2000 shqiptarë jetojnë në pjesën e poshtme dhe rreth 200-230 serbë në pjesën e epërme, bashkë me 15 shtëpi shqiptare. Sipas Planit të Ahtisaarit, Suhadolli i takon Mitrovicës jugore, por sipas dokumenteve kadastrale të Kosovës, ajo i takon Mitrovicës veriore, dhe kjo mospërputhje ka çuar në mosmarrëveshje të vazhdueshme midis zyrtarëve komunalë nga të dyja anët e qytetit.

Sipas marrëveshjes së arritur në Bruksel më 25 gusht, "Deri më 10 tetor 2015 hartat e kufijve administrativë të zonave kadastrale në Suhadoll dhe Kroi i Vitakut do të zgjidhen përmes Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Planet Zhvillimore Komunale, Hartës së Zonimit Komunal dhe Planit të detajuar Rregullator mes ministrive përkatëse dhe dy komunave".<sup>49</sup>



"Bllokimi i plotë dërgon mesazh të rrezikshëm, Parku i Paqes ishte progres, ndërsa tani kjo barrikadë dërgon mesazh të rrezikshëm. Është mirë që ajo ka fletë-ngjitëse të BE-së gjithandej nëpër të, kështu që nuk duket si iniciativë lokale. Vendimet e imponuara nuk janë të qëndrueshme."

**-UDHËHEQËS I QEVERISË LOKALE NË MITROVICË TË VERIUT**

<sup>49</sup> Teksti i plotë i marrëveshjes ndodhet këtu: <http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/faciliti->





“Madje edhe me planin e Ahtisaarit, ne ndodhemi në Mitrovicë veriore, por asnjë njeri s’ka folur me neve, as nga komuna veriore as nga ajo jugore.”

**-GORAN RAKIQ,  
KRYETARI I  
KOMUNËS SË  
MITROVICËS SË  
VERIUT**

Ajo që nisi si diskutim rreth 7 shtëpive dhe disa apartamenteve lulëzoi në një mosmarrëveshje lidhur me demarkacion kadastral të 52 shtëpive dhe 36 apartamenteve. Kjo çështje nuk është pjesë e negociatave kadastrale, por është e lidhur me planet që kanë të bëjnë me rehabilitimin e Urës së Mitrovicës, ku politikanët nga oborret kundërshtarë nuk dëshirojnë ta nënshkruajnë planin për urën derisa të zgjidhet kjo çështje. Për shkak se Agjencia Kadastrale e Kosovës ka përfshirë Suhodollin si pjesë të veriut, kjo do të thotë se veriu i Mitrovicës është disi multi-etnik, dhe ka më shumë shqiptarë në këshillin komunal se sa në cilëndo komunë tjetër veriore.

Në një takim të kuvendit komunal më 23 tetor, kryetari i komunës së Mitrovicës së veriut, Goran Rakiq, tha se ai nuk do të nënshkruajë asgjë që dëmton komunitetin serb, duke argumentuar se “plani i Ahtisaarit nuk është libër i shenjtë që të mos mund të ndryshohet”.<sup>50</sup>

Qytetarët janë konfuzë rreth asaj se a duhet t’i takojë territori i tyre komunës së Mitrovicës së veriut apo Mitrovicës së jugut.

“Sipas planit të Ahtisaarit, kjo zonë duhet t’i takojë Mitrovicës së jugut”, tha për BIG DEAL një shqiptar 40 vjeçar nga Suhadolli i epërm. “Ura duhet të jetë e hapur, por sidoqoftë për mua është e tillë, meqë unë kaloj këtu e atje disa herë në ditë. Unë shkoj në Zveçan, shkoj në Leposaviq”.

Vetëm pak metra më andej, Jovica Deniq, një serb nga Suhadolli i epërm tha se është i sigurt që ai i takon Mitrovicës së veriut.

“Madje edhe me planin e Ahtisaarit, ne ndodhemi në Mitrovicë veriore, por asnjë njeri s’ka folur me neve, as nga komuna veriore as nga ajo jugore”.

Këto diskutime vazhdojnë, por qytetarët vazhdojnë të ndjehen të lënë anash pa të ardhme të qartë.

## Dogana dhe Tregtia e lirë

Dogana dhe tregtia e lirë mes Kosovës dhe Serbisë funksionon mirë për momentin, ndonëse ka pa-baraspeshë të madhe tregtare.

Marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë për vulat doganore dhe tregtinë e lirë është nënshkruar më 2 shtator 2011 dhe implementimi ka filluar në fund të po atij muaji, ndonëse deri më dhjetor 2013 ajo nuk u zbatua në pikat e kalimit në pjesën veriore në Jarinjë dhe Bërnjak. Marrëveshja është e bazuar në Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë, CEFTA, në të cilën janë anëtare edhe vendet e Europës Juglindore që janë jashtë BE-së. Marrëveshja bëri që të hiqet embargoja tregtare trevjeçare për mallra dhe me këtë u rrit tregtia e Kosovës, edhe pse ajo mbetet shumë e njëanshme.

Në bazë të marrëveshjes mbi doganën, paratë e mbledhura në pikë-kontrollet kufitare shkojnë në “fondin e veriut”, i cili deri më sot ka grumbulluar 7.6 milionë euro dhe me to janë nisur tri projekte në Mitrovicë të veriut: stimulimi i

[tated-dialogue/150825\\_02-bridge\\_en.pdf](#)

50 Shih: “Rakić na opštinskoj sednici: Nije Ahtisarijev plan Sveto pismo pa da ne može da se menja, 23 October 2015, KosSev. [http://kossev.info/strana/arhiva/bozovic\\_\\_potpisivanje\\_memoranduma\\_o\\_razgranicenju\\_bi\\_dovelo\\_do\\_novih\\_lokalnih\\_izborova/6565](http://kossev.info/strana/arhiva/bozovic__potpisivanje_memoranduma_o_razgranicenju_bi_dovelo_do_novih_lokalnih_izborova/6565)

ndërmarrjeve të vogla e të mesme, shpronësimi i tokës për komunën e re, dhe krijimi i një stacioni për zjarrfikës.

Pas konfrontimit me çështje të shumta lidhur me substanca të kontrolluara si medikamentet, u nënshkrua një marrëveshje tjetër më datë 7 prill 2015, e cila mundëson licencimin e mallrave të kontrolluara të destinuara për veriuin e Kosovës. Ky proces më parë kërkonte ndërhyrje të vazhdueshme dhe të përditshme dhe tani është përmirësuar në masë të madhe. Megjithatë, ende ka ngërçe në proces, dhe nevojë për ndërhyrje të rregullt nga Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut.<sup>51</sup>

Dogana e Kosovës ka regjistruar 439 kompani importuese/eksportuese në Kosovën e veriut, dhe 98% e tyre kanë numra fiskalë të Kosovës.

Një tjetër marrëveshje mbi produktet farmaceutike hyri në fuqi më datë 27 qershor 2015 e cila parasheh njohje reciproke të certifikatave farmaceutike, gjë e cila do të jetë shumë me rëndësi për praninë e vazhdueshme të sistemit shëndetësor të Serbisë në veri të Kosovës. Kjo gjithashtu nënkupton se Kosova mund të shesë produktet farmaceutike të saj në Serbi. Marrëveshja përfshin institucionet si barnatoret dhe kompanitë tregtare me shumicë, licencat për vetë produktet, dhe importimin e barnave dhe donacioneve mjekësore në Kosovë.

Fakti që ekziston një marrëveshje paraqet përmirësim drastik nga periudha e raportimit të fundit nga BIG DEAL, kur spitalet dhe kompanitë tregtare me shumicë në veri të Kosovës kishin shqetësimin se nuk do të ketë zgjidhje për importim të ligjshëm të furnizimeve mjekësore nga Serbia.

Kjo procedurë nuk është implementuar plotësisht, meqë pak barnatore dhe tregtarë me shumicë kanë aplikuar për licenca, dhe Serbia nuk ka ofruar licenca për produktet farmaceutike. Derisa nuk ofrohen licencat, këto produkte nuk mund të importohen në Kosovë, kështu që kjo do të mbetet problem deri sa këto licenca të sigurohen nga Serbia dhe t'i jepen qeverisë së Kosovës.

Odat Tregtare të Kosovës dhe Serbisë kanë qenë akterët kryesorë të këtij segmenti të dialogut, me takime të rregullta për të përpunuar detajet e marrëveshjeve teknike në mënyrë që të mundësojnë qarkullim të lirë të mallrave, dhe duke trajtuar në veçanti tema të vështira si psh. çështjet fitosanitare.

## **Ndryshimet që ndikojnë tek Serbët e Kosovës**

Shumica e marrëveshjeve trajtojnë çështjen e asaj se si të integrohet më së miri komuniteti serb i Kosovës në Kosovë, posaçërisht në katër komunat veriore, të cilat nuk ishin ligjërisht nën juridiksionin e Prishtinës kur u nënshkrua marrëveshja e 19 prillit 2013. Ajo marrëveshje shtroi terrenin për zgjedhjet e reja në nëntor 2013 dhe për shtimin e katër komunave të reja nën administratën e Kosovës. Mjedisi aktual nënkupton që katër komunat e krijuara përmes marrëveshjes së 19 prillit funksionojnë, por jo edhe mirë.

Të katër komunat instaluan kuvendet deri më janar 2014 dhe përgatitën statutet komunale deri në muajin maj të atij viti, mirëpo mosmarrëveshjet lidhur

---

<sup>51</sup> Intervistë, Mitrovicë e veriut, nëntor 2015.



“Ndonjëherë kam frikë mos po gaboj e po bëj lapsuse kur flas për zyrtarët komunalë. Nuk e di se cilës komunë i takojnë, të Kosovës a të Serbisë.”

— QYTETAR NGA LEPOSAVIQI

me buxhetimin nga ana e Prishtinës bënë që funksionaliteti i tyre të çalojë këtë vit. Katër komuna e veriut të Kosovës planifikohej të praninin buxhetet komunale nga qeveria për vitin 2015 në vlerë prej disa milionash për secilën.

Sipas zyrtarëve në Prishtinë, këto komuna do të kenë qasje edhe në 17 deri 20 milionë euro fonde të nivelit shtetëror për projekte të infrastrukturës. Por, sipas ministrive të financave dhe të qeverisjes lokale të Kosovës, u kërkuan fonde për katër komuna në vlerë prej 59 milionë euro më shumë se sa që pritej, dhe buxhetet e tyre u bllokuan nga shkurti 2015 deri në maj 2015.<sup>52</sup>

Si rezultat, komunat janë munduar të kryejnë të gjitha shpenzimet deri në fund të vitit fiskal.<sup>53</sup> Në Leposaviq, sipas një pjesëtari të kuvendit komunal, vetëm 7.3 për qind e buxhetit është shpenzuar.<sup>54</sup> Marrë parasysh se ka vonesë të ngjashme në buxhetim dhe konteste të ngjashme si ato që ishin të pranishme gjatë periudhës së buxhetimit të fundit, ekziston frika se ky i njëjti problem mund të ndodhë në vitin e ardhshëm fiskal.

Edhe strukturat e mëparshme komunale mbesin funksionale, dhe shpesh me të njëjtin personel: Nënkryetari i Mitrovicës së Veriut nën sistemin e Kosovës është kryetar i komunës në sistemin paralel të Serbisë. Kryetarët e Leposaviqit dhe Zubin Potokut janë po ashtu kryetarë komunash në të dyja sistemet, dhe marrin dy paga.

## Strukturat Paralele

“Ndonjëherë kam frikë mos po gaboj e po bëj lapsuse kur flas për zyrtarët komunalë. Nuk e di se cilës komunë i takojnë, të Kosovës a të Serbisë”. – Qytetar nga Leposaviqi

Këta zyrtarë komunalë në veri përbëjnë një pjesë të asaj që Prishtina i quan “struktura paralele”. Deri në nëntor 2013, qeverisja, shëndetësia, arsimit, kultura dhe jeta në përgjithësi mbikëqyreshin nga institucionet e Serbisë. Tash, këto institucione vazhdojnë të pranojnë para nga Serbia, mirëpo, derisa Prishtina të marrë një nga një timonin në dorë, për shembull, përmes integritit të ish policëve serbë në Policinë e Kosovës, disa nga këto organe do të shuhen.

Serbia ende ka organe të qeverisjes lokale të quajtura “privremeno vece”, apo ‘këshillet e përkohshme’, dhe institucionet e saja (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, etj) vazhdojnë të funksionojnë. Sipas hulumtimeve nga gazetarë nga Serbia, në listën e pagave të Serbisë janë mbi 5,100 persona të punësuar apo të emëruar të cilët punojnë në qeveri apo në ndërmarrje publike vendore, përfshirë edhe në shkolla dhe spitale në territorin e Kosovës. Sipas sistemit të Serbisë, komuna e Prishtinës (administrata e së cilës e ka selinë në Graçanicë), ka numrin më të madh, 840, ndërsa Mitrovica veriore ka 614, Leposaviqi 510, Zubin Potoku 399, dhe Zveçani 242.<sup>55</sup> Disa nga këta njerëz

52 Shih ECMI Kosovo, “Buxhetet Komunale në Kosovën Veriore: Marrëveshje, më në fund,” 7 maj 2015. [http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2015/05/Political-Update-on-Municipal-Budgets-in-the-North\\_English.pdf](http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2015/05/Political-Update-on-Municipal-Budgets-in-the-North_English.pdf)

53 Intervistë në Mitrovicë veriore me zyrtarë komunalë, nëntor 2015.

54 Raporti i monitorimit për Kuvendin Komunal i përgatitur nga Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike në Mitrovicë për seancë parlamentare në 12 nëntor 2015.

55 Të dhënat janë ofruar nga Ivan Angelovski, nga transmetuesi i Serbisë B92, emisioni Insajder.

zyrtarisht punojnë në institucionet e Kosovës dhe marrin dy paga.

Sipas anketave të fundit, rreth 52 për qind të banorëve të veriut të Kosovës mbështeten në buxhetin e Serbisë sa i përket të ardhurave, kështu që në mënyra të ndryshme këto 'strukturat paralele' janë një lloj litari shpëtimi për serbët e Kosovës.<sup>56</sup>

Një nga këta zyrtarë që mban dy karrige është Zoran Todiq, kryetar i kuvendit komunal të Leposaviqit nën sistemin e Kosovës, dhe kryesues i këshillit të përkohshëm të Leposaviqit nën strukturën komunale të Serbisë.

"Ne ndërmorëm hapin e parë të marrëveshjes së Brukselit, që ishte të shkonim në zgjedhje sipas ligjit të Kosovës", thotë ai. "Sa i përket funksionimit të qeverive të reja lokale, ata funksionojnë vetëm aq sa është e mjaftueshme që të përmbushen disa detyrime ligjore".

Todiq tha për BIG DEAL se procesi i mbylljes së institucioneve paralele do të marrë kohë.

"Nëse dikush ka menduar se brenda natës, thjesht me një dalje në zgjedhje, ne do të zhytemi plotësisht në sistemin e ri, ka gënjyer. Ekzistojnë shumë detaje teknike të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që kjo të jetësohet".

Todiq e sheh Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe si zgjidhje të sistemit:

"Nëse institucionet e përkohshme shfuqizohen, do të ketë kaos në sistemin e pagesave. Ka institucione që financohen direkt nga buxheti i Republikës së Serbisë. Plani thelbësor i Asociacionit të komunave serbe është zgjidhja e çështjes së financimit nga Beogradi".

Megjithatë, mund të jetë konfuze të kesh të bësh me dy sisteme, apo të mos jesh i sigurt ku të drejtohesh. "Ndonjëherë frikësohem mos bëj gabime dhe mos bëj lapsuse, kur flas për vendimmarrësit në komuna", tha një qytetar nga Leposaviqi për BIG DEAL. "Nuk e di se cilës komunë i përkasim, të Kosovës a të Serbisë". Kjo shpesh ndodh për shkak se të njëjtët punonjës komunalë punojnë për të dy strukturat.

"Të gjitha ato institucione që i quanim 'tonat', dhe që njëkohësisht quheshin institucione 'paralele', të cilat po kërkohet të mbyllën, të gjitha duhet të mbyllën", thotë anëtar i kuvendit komunal të Leposaviqit, Nenad Radosavleviq.

"Natyrishisht që gjërat që lidhen me dokumente, pasaporta, letërnjoftime, shtetësi, etj duhet të lejohen të vazhdojnë të ekzistojnë në dualizëm, në kuptimin që, serbët duan që atdheu i tyre të jetë megjithatë Serbia, dhe ata duhen lejuar të kenë shtetësi të dyfishtë. Por s'ka asnjë dilemë se institucionet paralele do të mbyllën dhe duhet të mbyllën, në mënyrë që çdo gjë të funksionojë si duhet. Unë pres që ato të mbyllën paralelisht me formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe", thotë Radosavleviq.

Me të vërtetë, në bazë të marrëveshjes, procesi i krijimit të statutit për të ardhmen e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe duhet



"Nëse dikush ka menduar se brenda natës, thjesht me një dalje në zgjedhje, ne do të zhytemi plotësisht në sistemin e ri, ka gënjyer. Ekzistojnë shumë detaje teknike të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që kjo të jetësohet."

— ZORAN  
TODIQ, KRYETAR  
I KUVENDIT  
KOMUNAL TË  
LEPOSAVIQIT

Pagat për këta 5,106 persona i kushtojnë qeverisë së Serbisë afro 2.18 milionë euro në muaj.  
56 "Qëndrimet e qytetarëve në veriun e Kosovës," AKTIV dhe Qendra për Paqe e Tolerancë (Center for Peace and Tolerance), nëntor 2015.

të shkojë në tandem me çmontimin e strukturave shtetërore të Serbisë, dhe financimi i ardhshëm për veriun e Kosovës do të kanalizohet përfundimisht përmes Asociacionit. Duhet të themelohet një grup trepalësh për të monitoruar procesin e shpërbërjes ndërkohë që procedon me statutin.

## Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe

Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe (ASM) paraqet gur themelin e marrëveshjes 19 Prill 2013, ku gjashtë nga 15 pikat e marrëveshjes janë të fokusuar në krijimin e tij. Shumica e serbëve të Kosovës e presin pozitivisht themelimin dhe funksionimin e tij, me gjasë për shkak se një numër i tyre kanë pritje të mëdha nga kjo. Një në pesë serbë të veriut të Kosovës besojnë se Asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive,<sup>57</sup> gjë që është relativisht e ulët në krahasim me premtimet e bëra tash e dy vite nga politikanët nga Serbia.

Asociacioni do të përfshijë katër komunat e veriut, si dhe Graçanicën, Shtërpcen, Novobërdën, Kllokotin, Ranillugun dhe Parteshin, me Gaçanicën si qendër rajonale për komunat jugore.

Marrëveshja fillestare e vitit 2013 parashihte se Asociacioni do të themelohet dhe do të ishte funksional deri në fund të atij viti. Mirëpo, implementimi pati një lloj ngecje deri në verën e këtij viti. Më 25 gusht 2015, Kosova dhe Serbia u pajtuan në Bruksel lidhur me një varg parimesh dhe elementesh kryesore të Asociacionit, të cilat herë do kur duhen përkthyer në tekst statuti. Megjithatë, gati menjëherë pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, blloku opozitar i Kosovës, i përbërë nga Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma për Kosovën (NISMA) filluan të protestojnë kundër vendimit.

Marrëveshja jep hollësi të kompetencave që i jepen asociacionit të 10 komunave me shumicë serbe; të ketë “mbikëqyrje” të plotë në sferat e planifikimit rural dhe urban, zhvillimin ekonomik, arsim dhe shëndetësi, ndonëse kuptimi i saktë i fjalës “mbikëqyrje” nuk është i definuar mirë dhe duket të ketë interpretime të ndryshme potenciale. Ai do t’i lejojë Serbisë t’i kontribuojë me të holla – në mënyrë transparente – këtij organi. Kjo paraqet rëndësi jetike për serbët e Kosovës, meqë më shumë se gjysma e serbëve në veri kanë raportuar se ata mbështeten nga paratë nga qeveria e Serbisë për bukën e gojës.<sup>58</sup> Megjithatë, kjo gjë paraqet edhe shqetësim për ata të cilët e shohin atë si mënyrë e Serbisë për të vazhduar të ushtrojë ndikimin mbi Kosovën, dhe në rastin e gjashtë komunave me shumicë serbe në anën jugore të lumit Ibër, ta zgjerojë ndikimin e saj.

Marrëveshja jep hollësi të Asociacionit të cilat nuk renditen në marrëveshjen e Brukselit, por parimi i asaj që Asociacioni të jetë konform me ligjet e Kosovës dhe me Kartën Europiane për Vetë-qeverisje Lokale qëndron. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Asociacioni do të ketë këto struktura:

- Kuvend;

<sup>57</sup> Po aty.

<sup>58</sup> Po aty.

- President dhe Zëvendës-President që zgjidhet nga Kuvendi;
- Këshill prej maksimum 30 anëtarësh, banorë të komunave, gjë që përfshin dhjetë krye komunarë. Ai do të shërbejë si organ këshillëdhënës.
- Bord 7-anëtarësh përgjegjës për menaxhimin ditor të Asociacionit, detajet lidhur me kolegët do të definohen në statut;
- Administratë, shefi i së cilës emërohet nga bordi. Stafit do të jetë personel civil.
- Zyre për Ankesa.

Marrëveshja lë shumë gjëra të pa definuara, përfshirë edhe selinë e Asociacionit.

Kompetencat/drejtat/përgjegjësitë ligjore përfshijnë:

- Propozimin e amendamenteve ndaj legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse “për përmbushjen e objektivave të veta”.
- Të drejtën për të iniciuar apo marrë pjesë në procedime gjyqësore, përfshirë edhe në Gjykatën Kushtetuese, “kundrejt çfarëdo akti apo vendimi nga çfarëdo institucioni që prek/afekton ushtrimin e kompetencave të Asociacionit/Bashkësisë, në pajtim me Statutin e vet”.
- Emërimin e përfaqësuesve për organe të qeverisë qendrore.
- Të drejtën për qasje në informacion nga autoritetet qendrore lidhur me kompetencat e Asociacionit (shëndetësi, arsim, etj)
- Katër kryetarët e komunave veriore do të emërojnë komandantin e policisë rajonale për veriun.
- Zotësi mbi pronën
- Punonjësit do të kenë statusin e shërbyesit civil.

Edhe financimi i Asociacionit/Bashkësisë është kontrovers. Ky organ i nënshtrohet auditimit nga Auditori i Përgjithshëm. Ai mund të ketë këto burime fondesh:

- Kontributet e anëtarëve (psh., buxhete nga komunat)
- Të ardhura nga shërbimet e ofruara
- Të hyra që vijnë nga patundshmëritë/pasuritë e luajtshme e tij
- Transfere nga autoritetet qendrore në Prishtinë
- “Kontribute, grante, donacione si dhe mbështetje financiare nga asociacione dhe organizata tjera, vendore e ndërkombëtare, si dhe nga Republika e Serbisë”.
- Sikurse komunat tjera, Asociacioni dhe komunat pjesëmarrëse lirohen nga tatimet.

Shërbimet e ofruara për qytetarët për përfitim financiar nuk janë përcaktuar, e as nuk është definuar identiteti i saj vizuel. Simbolet janë me rëndësi si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë. Asociacioni do të ketë embleme e flamur të vetin, në pajtim me ligjin e Kosovës. Nuk dihet akoma se si do të duken ato.

Siç qëndron për momentin, parimet duket të jetë në përputhje me planin e Ahtisaarit, por kompetencat e akorduara janë me të vërtetë të konsiderueshme. Në njëfarë mënyre, pranimi i parave nga Serbia – në mënyrë transparente – si shtesë ndaj buxheteve komunale për shëndetësi dhe arsim, i lehtëson barrën

buxhetit të Kosovës.

Disa e shohin këtë si mënyrë e legjitimitit të sistemit aktual në mënyrë të atillë që i lejon Prishtinës të dijë se sa para investohen në Kosovë. Sipas fjalëve të politikantit Oliver Ivanoviq: "Duhet t'i shpjegohet të dyja anëve se marrëveshja e Brukselit do të çojë në legalizim të status quo-së. Asgjë e madhe nuk do të ndryshojë, përveç se situatës aktuale do t'i inkuadrohen disa kufizime ligjore e normale".<sup>59</sup>

Megjithatë, njerëz të tjerë kanë frikë nga rëniet e mundshme, për shembull, nëse Beogradi kërcënon duke kushtëzuar financimin e duke kërkuar sjellje të caktuar apo vota. Në periudhën kohore pas zgjedhjeve të nëntorit 2013, Beogradi ka ushtruar kontroll mbi funksionarë etnikë serbë në qeverinë e Kosovës. Një shembull i tillë është vendimi i fundit për të zëvendësuar Aleksandar Jabllanoviç-in, kryesuesin e Listës Serbe, me Slavko Simiçin. Kjo u bë në Beograd, dhe njoftimi u dha nga kryeministri serb Vuçiç para një mori deputetësh dhe ministrash të Kosovës. Edhe ministri i Punës i Serbisë, Aleksandar Vulin, si dhe Marko Gjuriq, kryesues i zyrës së Serbisë për Kosovën ishin të pranishëm.<sup>60</sup>

Sidoqoftë, siç ka përmendur studiuesi Daniel Serwer, pas nënshkrimit rishtazi të marrëveshjes, Prishtina nuk pati rrugëdalje tjetër gjatë këtyre negociimeve, sepse ajo veçse është e zotuar për implementimin e Planit të Ahtisaarit.<sup>61</sup>

Plani Ahtisaari, që formalisht njihet me emërtimin Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, paraqet një plan të propozuar para se Kosova ta shpallte pavarësinë, që do të shërbente si udhëzues për Kosovën për tranzicion nga kontrolli i UNMIK-ut. Plani u hartua nga ish Presidenti finlandez, Martti Ahtisaari, dhe është pjesë e sistemit kushtetues të Kosovës.

Ky plan krijoi Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO), e cila mbikëqyrte të ashtuquajturën "pavarësi të mbikëqyrur" të Kosovës, nga shkurti 2008 e deri në mbylljen e ICO-së në shtator të vitit 2012. Serbia mohoi këtë plan, dhe meqë veriu i Kosovës mbeti jashtë kontrollit të Prishtinës, plani atje nuk u implementua.

Plani i Ahtisaarit u fokusua në model të decentralizuar të Kosovës, duke i dhënë përgjegjësi të madhe komunave drejt menaxhimit të punëve të tyre. Aneksi III i planit tërhoqi vija administrative të reja për komunat, disa prej të cilave u krijuan në baza etnike, si psh. Mitrovica veriore, me popullsi kryesisht serbe.

59 Oliver Ivanovic, nga Mitrovica veriore është lideri i iniciativës së pavarur qytetare "Liri, Demokraci, Drejtësi." Në nëntor 2014, ai u akuzua për krime lufte kundrejt civilëve në vitet 1999 dhe 2000. Gjykimi ende vazhdon. Para arrestimit të tij, ai shikohej si njëri ndër figurat më të moderuara të veriut, pro-bashkëpunimit, dhe si "bashkëbisedues i NATO-s dhe BE-së". <http://uk.reuters.com/article/2014/01/27/uk-kosovo-warcrimes-idUKBREA0Q1FS20140127>

60 Ky vendim është marrë më 23 tetor 2015 në Beograd. <http://www.blic.rs/Vesti/Politika/600742/Slavko-Simic-novi-sef-Srpske-liste-umesto-Jablanovica>

61 Shih "Varet prej gjithçkaje," 26 gusht 2015. <http://www.peacefare.net/2015/08/26/it-all-depends/>

Plani Ahtisaari i dha këtyre komunave elemente të rëndësishme të vetë-rregullimit në sferën e shëndetësisë, arsimit dhe çështjeve sociale, si dhe pjesëmarrje sa i përket përzgjedhjes së shefit të policisë.

Neni gjashtë i dha komunave të drejtën e formimit të asociacioneve dhe partneriteteve me komuna tjera në Kosovë: “Komunat do të kenë të drejtën e bashkëpunimit ndër-komunal dhe tej-kufitar lidhur me çështje me interes të përbashkët sa i përket ushtrimit të përgjegjësive të tyre”.

Komunat gjithashtu kanë të drejtë bashkëpunimi me komunat dhe institucionet në Serbi, “përfshirë edhe të drejtën e pranimit të asistencës financiare dhe teknike nga Serbia, brenda parametrave të qartë e të definuar përmes planit të Zgjidhjes”. Krahas kësaj, komunat lejohen të shfrytëzojnë materiale shkollore nga Serbia në shkollat lokale.

Aneksi III përcakton se komunat mund të bashkëpunojnë me Beogradin dhe të pranojnë financim nga ai, dhe të përdorin materiale shkollore nga Serbia në shkollat lokale. Mitrovicës së veriut i jepet kompetencë speciale për arsim të lartë, duke përfshirë edhe licencimin dhe regjistrimin e institucioneve arsimore, ndërkohë që Mitrovicës veriore, Shtërpces dhe Graçanicës i jepen kompetenca speciale lidhur me shëndetësinë. Aneksi IV përcakton se komunat do të kenë gjykatat e veta dhe mandaton se “Institucionet gjyqësore të Kosovës do të ... pasqyrojnë përbërjen etnike të zonës së juridiksionit të tyre”.

Në këtë mënyrë, klauzolat e marrëveshjes 19 Prill 2013 dhe “elementet kryesore” të renditura në muajin gusht 2015 duket të jenë në harmoni me Planin e Ahtisaarit. Qëllimi i planit, të lejojë serbët e Kosovës të jenë pjesë e një Kosove shumë-etnike, në të njëjtën kohë duke mbajtur lidhjet me Serbinë – duket i qartë.

Plani, megjithatë, nuk ka detajizuar se si këto asociacione do të ndërlihen me qeverinë qendrore në Prishtinë, apo si do të organizojnë lidhjet me Beogradin.

Qeveria qendrore ka kompetencën të shqyrtojë administrativisht veprimet komunale, me kusht që nëse nuk ka dakordim mes komunës dhe qeverisë qendrore, çështja duhet të zgjidhet në gjykatat e Kosovës (Aneksi III Neni 6). Ai nuk përmend mosmarrëveshjet e mundshme mes të ndonjë asociacioni të komunave dhe qeverisë së Kosovës. As “elementet kryesore” të dokumentit të 25 gushtit 2015 nuk adresojnë mosmarrëveshjet mes autoriteteve qendrore dhe asociacionit. Kjo gjë duhet të trajtohet.

Megjithatë, plani i ka vendosur këto në kontekst të marrëdhënies funksionale me qeverinë në Prishtinë, e cila do të ketë mbikëqyrje administrative të kompetencave lokale, ashtu siç vepron tani. Kjo mbikëqyrje është ngadalë duke u shtrirë në veri, përmes krijimit të katër komunave veriore nën sistemin e Kosovës, pas zgjedhjeve të nëntorit 2013.

Çështja është se derisa marrëveshja më e fundit duket të jetë pak a shumë në dakord me planin e Ahtisaarit, ajo, marrëveshja 2013 dhe dokumenti i fundit i “elementeve kryesore/parimeve kyçe” janë të dykuptimta për sa i përket çështjes së partneriteteve komunale, dhe kjo mos-saktësi kuptimi mund të çojë



në probleme.

Për shembull, ekzistojnë dy nene të cilat kanë të bëjnë me partneritetet komunale:

9.1.1 Përgjegjësitë komunale në fushat e tyre vetanake dhe kompetencat e tyre të zgjeruara vetanake mund të ushtrohen përmes partneriteteve komunale në përjashtim të ushtrimit të kompetencave themelore komunale,<sup>62</sup> siç janë zgjedhja e organeve komunale dhe emërimi i zyrtarëve komunalë, përcaktimi i buxhetit komunal dhe miratimi i akteve rregullative të zbatueshme ndaj qytetarëve në përgjithësi.

9.1.2 Partneritetet komunale mund t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për implementimin dhe ushtrimin e bashkëpunimit funksional përmes, mes tjerash, themelimin e një organi vendimmarrës të përbërë nga përfaqësuesit e emëruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse, punësimit dhe shkarkimit të personelit administrativ dhe këshillëdhënës dhe vendimeve mbi nevojat për financim dhe nevojave tjera operationale të partneritetit;

“Këto dispozita lejojnë ushtrimin kolektiv të autoritetit, por, ç’është me rëndësi, jo atëherë kur është fjala për pushtet dhe autoritet themelor komunal”, kujton studiuesi Gëzim Krasniqi, student i Studimeve Shqiptare në Universitetin Kolegjial të Londrës.

Neni 9.1 trajton “partneritetet”, ndërsa që neni 9.2 trajton formimin e një asociacioni, i cili mund t'i japë anëtarëve të vet shërbime të cilat përfshijnë “trajtime, ngritje kapacitetesh, asistencë teknike, hulumtime lidhur me kompetencat komunale dhe rekomandime rreth politikave”.

Është e paqartë nëse këto konsiderohen i njëjti lloj organi apo mundësi të ndryshme, thotë Krasniqi.

Marrëveshja e vitit 2013 e formulon atë ndryshe:

“Në pajtim me kompetencat e dhëna përmes Kartës Europiane të Vetë Qeverisjes Lokale dhe përmes ligjeve të Kosovës, komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin kolektiv të kompetencave të tyre përmes Bashkësisë/Asociacionit.<sup>63</sup> Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë të sferave të zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban e rural.

Plani Ahtisaari paraqet mundësinë e ushtrimit të “përbashkët të të drejtave jo-themelore komunale”, mirëpo marrëveshja e vitit 2013 nuk e bën një dallim të tillë.

Marrëveshja më e fundit, ajo e 25 gushtit, i jep Asociacionit të ardhshëm të drejta të cilat nuk përmenden në planin Ahtisaari apo në marrëveshjen e 19 prillit 2013:

9) Asociacioni/Bashkësia do të promovojë interesat e komunitetit serb të Kosovës lidhur me marrëdhëniet e tij me autoritetet qendrore.

11) e drejta për të nisur procedime gjyqësore apo për të marrë pjesë në pro-

<sup>62</sup> Theksimi i fjalëve është shtuar nga autori.

<sup>63</sup> Theksimi i fjalëve është nga autori.

cedime në Gjykata kompetente, përfshirë edhe në Gjykatë Kushtetuese

13) e drejta e katër kryetarëve të komunave të veriut për të propozuar, në emër të asociacionit, listën e kandidatëve për emërim të komandantit të policisë

14) e drejta e posedimit të pronës mbi kompani të cilat ofrojnë shërbime lokale brenda fushëveprimit të Asociacionit

Pika 9, siç përmend Krasniqi, i jep serbëve një tjetër nivel përfaqësimi krahas me ulëset e rezervuara në parlament për ta.

Pika 14 aludon se Asociacioni nuk do të jetë thjesht mekanizëm koordinimi por edhe ofruar shërbimesh.

Krasniqi konstaton se ekziston potenciali që Asociacioni ta dobësojë shtetin e Kosovës, dhe gjasat për këtë do të jenë edhe më të larta nëse statuti i tij është i dykuptimtë.

“Konsideroj se një statut potencialisht i dykuptimtë do të ishte dëmtesues për procesin e integritetit të serbëve brenda sistemit të Kosovës dhe herë do kur i marrëdhënies serbo-shqiptare”, thotë ai.

“Ndonëse objektivi i parë i asociacionit, sipas marrëveshjes së vitit 2015, është që të ‘forcojë demokracinë lokale’, kam frikë se asociacioni do ta bëjë të kundërtën. Parimet në fjalë lënë të hapur derën për daljen e një mekanizmi të centralizuar që kontrollohet direkt nga Beogradi, i cili dobëson si vetë komunat me shumicë serbe – duke ushtruar shumë kompetenca në emër të tyre – ashtu edhe përfaqësimin e tyre në nivel qendror”.

Shumëçka nga implementimi i marrëveshjeve varet nga kuptimi i “mbikëqyrjes”: marrëveshja e 19 prillit 2013 i jep Asociacionit “mbikëqyrje” mbi sferat e shëndetësisë, arsimit, planifikimit urban/rural dhe zhvillimit ekonomik, të cilat, sipas planit Ahtisaari, janë kapacitete komunale. Plani Ahtisaari asnjëherë nuk përmend fjalën “mbikëqyrje”, dhe nuk i jep asaj definicion funksional. Kjo fjalë [overview] e cila në serbisht dhe në shqip u përkthye si ‘supervizion’, ‘mbikëqyrje’, e që u interpretua nga Serbia diçka si “autoritet ekzekutiv”, dhe e cila nga Prishtina u interpretua si supervizion por jo si autoritet ekzekutiv, do të duhet të detajizohet. Me të vërtetë, një gjë e tillë do të zbuste disa nga shqetësimet e shqiptarëve të Kosovës, dhe do të krijonte pritje më reale tek serbët e Kosovës sikur ky term të definohej më mirë dhe t’i prezantohej publikut. Draft statuti për Asociacionin, për dallim prej marrëveshjes së 25 gushtit, do të jetë dokument ligjor. Ai ose duhet të precizojë definicionin e këtij termi “mbikëqyrje” ose ta zëvendësojë atë me një term tjetër, më preciz, marrë parasysh që preciziteti i rregulloreve ligjore është njëra ndër tri parimet themelore të sundimit të ligjit.

“Problemi më i madh është dykuptimësia ligjore dhe fakti se serbët e Kosovës dhe Serbia nuk e njohin Kosovën”, thotë Krasniqi. “Mund të jetë gjë e zgjuar të bëhen disa marrëveshje të përkohshme teknike në Bruksel, të cilat janë të dykuptimta por që funksionojnë në praktikë, por dykuptimësitë nëpër dokumente e legjislacion me kaq rëndësi kritike siç është funksionimi i Aso-



“Problemi më i madh është dykuptimësia ligjore dhe fakti se serbët e Kosovës dhe Serbia nuk e njohin Kosovën.”

**-GËZIM KRASNIQI,  
STUDENT I  
STUDIMEVE  
SHQIPTARE NË  
UNIVERSITETIN  
KOLEGJIAL TË  
LONDRËS**

ciacionit dhe marrëdhëniet e tij me autoritetet qendrore, rrezik që mund të paraqesin burim afat-gjatë për mosmarrëveshje dhe en-pasan politik”.

Studiuesit kanë shprehur edhe shqetësime lidhur me pjesë të marrëveshjeve të cilat përcaktojnë se komandanti policor do të jetë serb, që përzgjidhet nga kryetarët e katër komunave veriore të Kosovës. Një lloj marrëveshjeje e ngjashme në Bosnjë, e cila përcakton se tre presidentët e shtetit duhet të vetë-identifikohen si serbë të Bosnjës, kroatë të Bosnjës, apo boshnjakë të Bosnjës, doli të ketë qenë në kundërshtim me standardet Evropiane të të drejtave të njeriut, sipas Gjykatës Evropiane për Drejta të Njeriut në vitin 2009.

“Kosova ka dy brenga legjitime”, thotë analisti Leon Malazogu. “E para, se [Asociacioni] do të mund të haste në situatë ngërçi, ngjashëm me rastin Sejdiq-Finci në Bosnjë, sikur ndonjë jo-serb ta padiste Kosovën në gjykatën e Strasburgut për ndonjë pamundësi të tij/saj për t’u bërë drejtor policie në veri”.

Malazogu, sikurse edhe shumë kosovarë tjerë, ndan të njëjtin shqetësim me Krasniqin: “Serbia akoma mund të mbajë orientim armiqësor ndaj Kosovës, gjë që shkakton që koncesionet e bëra për serbët e Kosovës të konsiderohen kërcënim potencial për shtetin. Ndërkohë që në përgjithësi brenda kornizës së Ahtisaarit, [në këtë marrëveshje] ka formulime të cilat lënë të hapur një derë për shpresa divergjente, të ndryshme sa i përket këtij rrugëtimi, gjë që garanton se kjo do të helmojë marrëdhëniet në të ardhmen”.

Branislav Nesović, i cili kreu hulumtime të gjera lidhur me Asociacionin e komunave me shumicë serbe dhe lidhur me pritjet e frikat që komunitetet ia mveshin atij, thotë se shumica e këtyre kompetencave “të reja” nuk janë në të vërtetë të reja.

“Vetë fakti që Kosova nuk duhet të ndryshojë kurrfarë ligji në mënyrë që të formohet Asociacioni i thotë të gjitha”, thotë ai.

Për më tepër, Nesović shprehet se, Asociacioni do të shërbejë në fakt për t’i integruar serbët e veriut në shtetin e Kosovës “së paku institucionalisht”, gjë e cila si rezultat do të largojë frikat nga “tjetri”, dhe do të paraqesë mënyrë për të ndërtuar besimin në institucionet e Kosovës.

“Bashkësia e komunave me shumicë serbe, së bashku me proceset politike në nivele qendrore dhe lokale mund të paraqesin kornizë të dobishme institucionale e cila mund t’i ofrojë akomodim komunitetit serb në Kosovë, dhe si masë e fundit, të zbusë frikat dhe ndjenjën e mosbesimit drejt procesit dhe drejt vetë Prishtinës”.

Nenad Gjurgjeviq, nga Forumi Beogradas për Marrëdhënie Etnike, thotë se Asociacionit nuk i janë dhënë kompetenca ekzekutive, dhe thotë se “Sistemi i zgjedhjes së deputetëve në kuvend është indirekt, që thjeshtë do të thotë se të gjitha institucionet do të krijohen nga deputetët që veçse janë të zgjedhur në komuna, duke i dhënë atij kështu ndikim më të vogël politik e ligjor”.

Asociacioni vërtetë do të marrë kompetenca të reja, si të drejta pronësore dhe mundësi të ankimimit direkt në Gjykatën Kushtetuese, por nuk ka drejtë votoje, dhe nuk ka klauzolë që obligon qeverinë qendrore në Prishtinë të konsultohet me Asociacionin mbi çështje me rëndësi për komunitetin serb.

“Vetë fakti që Kosova nuk duhet të ndryshojë kurrfarë ligji në mënyrë që të formohet Asociacioni i thotë të gjitha”

**-BRANISLAV NESOVIQ,**

Për më tepër, thotë Gjurgjeviq, përveç ulëseve në Kuvend, nuk ka institucion që mund të kujdeset për komunitetin serb në mënyrë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, në planin e Ahtisaarit është paraparë e drejta për të nominuar komandantin e policisë rajonale, e Policia e Kosovës është pak a shumë institucion i centralizuar dhe hierarkik.

Gjurgjeviq, i cili ka punuar ekstensivisht me këshillat nacionalë shqiptare në Serbi, thotë se një model i ngjashëm do të ishte më i mirë për serbët e Kosovës, se sa një model që bazohet në territor.

“Unë do të avokoja më shumë për drejta personale dhe krijim të institucioneve minoritare të cilat rrjedhojnë nga kjo, si Këshillat e Pakicave Nacionale, se sa territorializimi i të drejtave”, tha Gjurgjeviq për BIG DEAL. “Por, nëse shqiptarët e Kosovës kanë menduar ta kenë shtetin pa dhënë garanci shtesë për serbët, e kanë pasur gabim”.

Fakti se gjashtë komuna me shumicë serbe në pjesën jugore të lbrit do t'i bashkohen Asociacionit paraqet diçka që mund të shërbejë drejt afrimit të komunave veriore më tej në sistemin e Kosovës. Derisa një asociacion i vetëm i katër komunave veriore do të linte shpresa për copëtim të zonës, inkuadrimi i katër komunave të jugut, të cilat veçse kanë qenë pjesë e sistemit të Kosovës për shumë vite, mund ta lehtësojë integrimin. Megjithatë, ai edhe do të mund t'i afronte ato gjashtë komuna më afër Beogradit dhe më larg Prishtinës.

“Komunitetet veçse janë të ndara dhe s'ka mrekulli që do të mund të bënte që multi-etniciteti të funksionojë në afatin e shkurtër, por në aspekt afatgjatë paraqet një shansë për t'i mundësuar atyre të mësojnë të jetojnë së bashku dhe të funksionojnë nëpërmjet socializimit”.

Statuti i Asociacionit mendohej se do të draftohej nga një ekip menaxhues brenda katër muajsh pas marrëveshjes, deri më 25 dhjetor. Megjithatë, veprimet e tyre u shtynë për shkak të suspendimit të përkohshëm të marrëveshjes nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Më 31 tetor, pas javësh destabilizimi në Kuvend, Presidentja Jahjaga i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse marrëveshje është apo jo në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

Në raportin e gjendjes së implementimit të marrëveshjeve, të publikuara më 25 tetor 2015, Ministrija Edita Tahiri u shpreh shumë qartë: “Marrëveshja [e kohës së fundit] është në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e saj. Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të paraqesë shtresë të tretë qeverisëse në Republikën e Kosovës”.

Marrëveshja parasheh rolin e Gjykatës Kushtetuese, por jo deri në shpalljen e statutit konkret në formë të rregullores, nga ana e qeverisë së Kosovës.<sup>64</sup> Kjo është arsyeja pse ky vendim shihet nga të shumtë si taktikë zvarritjeje, dhe si e tillë që ka potencial të thyejë të mirën e akumuluar në gusht në Bruksel.

Beogradi tha se vendimi i gjykatës do të kishte efekt negativ në vazhden e

---

<sup>64</sup> Teksti i marrëveshjes i referohet kësaj si “dekret”, por meqë qeveria nuk mund të lëshojë dekrete, ajo do të merr formën e rregullores, sipas Ministres Tahiri.

procesit të dialogut. “Kjo vërtetë po prishë atmosferën e dialogut dhe po redukton akoma më tej komunikimin”, Marko Gjuric, kryetar i zyrës së Serbisë për Kosovën, tha për BIG DEAL.

“Ne nuk ishim të informuar lidhur me iniciativën për ta dërguar këtë në gjykatë, gjë që nuk është e drejtë. Ne jemi palë e marrëveshjes”, tha ai.

Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, e quajti këtë veprim “kërcënim për stabilitetin rajonal”, duke akuzuar Kosovën për “fajle edhe me bashkësinë ndërkombëtare edhe me Bashkimin Evropian”.<sup>65</sup>

Disa analistë e shohin këtë si vendim politik dhe e mëdyshin atë se a kishte Presidentja të drejtë kushtetuese që të kërkojë nga gjykatë opinionin e saj mbi legalitetin, në këtë stad, kur dokumenti akoma nuk është final, dhe kur Kushtetuta i jep Presidentes të drejtën vetëm të kërkojë opinion mbi ligje apo dekrete.<sup>66</sup>

Një gjë është e qartë: marrëveshja e 25 gushtit ka parashikuar se Asociacioni do të themelohej deri në fund të vitit, ndërsa tani gjendja e çështjeve siguron se kurrfarë progresi nuk mund të bëhet para fillim-vitit 2016. Kjo nuk i frymëzon për besim drejt qeverisë së Kosovës serbët e Kosovës. Mbi 80 për qind e serbëve të veriut të Kosovës thonë se marrëveshja e Brukselit nuk ka bërë asgjë për të përmirësuar jetërat e tyre,<sup>67</sup> dhe kjo e thellon indinjatën akoma më tej.

Është me rëndësi të theksohet se natyra mono-etnike e asociacionit në fjalë është shqetësuese. Teksti i marrëveshjes së bërë në Bruksel thotë se “Asociacioni/Bashkësia do të promovojë interesat e komunitetit serb të Kosovës në marrëdhëniet e tij me autoritetet qendrore”. Natyrisht, mjedisi kushtetues nuk parasheh mekanizma të mbrojtjes kolektive si e drejtë e komunitetit serb. Megjithatë, secila nga këto komuna ka banorë jo-serbë, dhe deklarata si këto nuk përkohjnë me frymën e kushtetutës multi-etnike të Kosovës.<sup>68</sup> Tekst më i mirë do të ishte ndonjë që do të thoshte se promovon interesat e të gjithë qytetarëve të komunave në fjalë.

Ministrja Tahiri pa luhatje shprehet se Asociacioni nuk do të themelohet përdërisa të gjitha institucionet paralele të Serbisë të jenë mbyllur. Ndërkohë që statuti është duke u shkruar dhe finalizuar, duhet formuar një komision trepalësh për të bërë një vlerësim të strukturave qeverisëse dhe të gjejë zgjidhje për ato që mbesin të angazhuara nga institucionet e Serbisë në mënyrë që ato të mund të mbyllet me efekte minimale për jetesën e njerëzve.

## SIGURIA

Siguria paraqet komponentë me rëndësi të shoqërisë, dhe është jashtëzakonisht me rëndësi në Kosovë, ku çfarëdo incidenti i vogël që mund të mos jetë etnikisht i motivuar të marrë karakter të fillë.

65 <http://www.balkaninsight.com/en/article/belgrade-pristina-roë-over-brussels-agreement-suspension-11-11-2015>

66 <http://www.balkanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Kosovo/Kosovo-a-very-political-Court-165756>

67 Anketa nga AKTIV

68 Shih Nenet 1 dhe 3 të Kushtetutës së Kosovës.

“Ne nuk ishim të informuar lidhur me iniciativën për ta dërguar këtë në gjykatë, gjë që nuk është e drejtë. Ne jemi palë e marrëveshjes.”  
-MARKO DJURIC,  
KRYETAR I ZYRES  
SË SERBISË PËR  
KOSOVËN

## Policia

Viti 2015 ka qenë viti i parë kur në Kosovë u pa duke shërbyer vetëm një forcë policore: Policia e Kosovës. Implementimi i marrëveshjeve mbi policinë është pranë përfundimit. Kjo paraqet sukses të madh për dialogun. Deri në muajin maj 2014, është kompletuar integrimi i 285 ish-punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP) në Policinë e Kosovës.<sup>69</sup> Kjo më shumë se dyfishoi numrin e oficerëve të PK në katër komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe, në gjithsej 530.<sup>70</sup>

Pas marrëveshjes së 19 prillit, diku rreth 1,200 ish-policë të punësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë (MUP) u detyruan të shkojnë në pension të hershëm. Stafi administrativ nuk u inkorporua fare, dhe as rreth 800 punonjës tjerë të cilët nuk ishin nga veriu i Kosovës, dhe që nuk kualifikoheshin për të pranuar pensionet.<sup>71</sup> Ky staf administrativ bëri protesta, duke besuar se shpirti i marrëveshjes ishte që njerëzit të mos humbin punën, të mos dëmtohen financiarisht si rezultat i marrëveshjes.<sup>72</sup>

160 prej tyre që janë nga Mitrovica e veriut vazhdojnë të protestojnë kundër vendimit.

## Trupa e mbrojtjes civile

Trupa e Mbrojtjes Civile ishte një institucion i Serbisë që rregullohej sipas ligjit për Gjendje Emergjente, dhe anëtarët e saj mendohej të ishin ndërhyrësit e parë në rast vërshimi, tërmeti, apo katastrofe tjetër natyrore. Njësitë e saj ishin nën juridiksionin e qeverive lokale.

Ekzistenca e këtij organi ka qenë çështje shumë delikate për Prishtinën gjatë dialogut, sepse ajo e konsideron atë njësi si milici të uniformuar dhe të armatosur. Serbia, dhe në të vërtetë, vetë anëtarët e Mbrojtjes Civile, e konsiderojnë veten si ofrues të shërbimeve emergjente me rëndësi për qytetarët, shërbime që qeveria e Kosovës nuk siguronte. Megjithatë, njëjtë me këtë, nëse jo më me rëndësi se kjo, është fakti se Trupa e Mbrojtjes Civile ishte burim i të ardhurave për 751 punonjësit e saj.

Megjithatë, shpërbërja e Mbrojtjes civile ishte paraparë me marrëveshjen e 19 prillit 2013 që të përfundojë deri në fund të vitit 2013. Ky proces nuk filloi deri sa në një marrëveshje e dytë, e arritur më 26 mars 2015 ofroi parametrat më specifikë për dalje në pension të anëtarëve të Mbrojtjes Civile apo absorbimin e tyre në institucionet përkatëse të Kosovës. Marrëveshja parashikoi edhe dorëzimin e të gjitha materialeve të Mbrojtjes Civile: pikat e vëzhgimit, zyrat, magazinat, uniformat, etj, dhe rregullimet ligjore në kuadër të ligjit të Serbisë

69 Kjo temë mbutohet më gjerësisht në raportin e parë BIG DEAL nga nëntori 2014. Për më shumë informata të detajshme, shih [http://pasos.org/wp-content/uploads/2014/04/police\\_integration\\_nk\\_web.pdf](http://pasos.org/wp-content/uploads/2014/04/police_integration_nk_web.pdf)

70 <http://www.balkaninsight.com/en/article/serb-police-adapt-to-new-bosses-in-kosovo>

71 Policia e Kosovës kishte funksionuar në veriun e Kosovës për disa vite më herët, dhe veçse kishte të vendosur staf administrativ.

72 Intervistë me analistin, Mitrovicë e veriut, mars 2015.

për ta pushuar se ekzistuari Mbrojtjes Civile si entitet juridik.

Tash, gjithsej 483 anëtarë të Mbrojtjes Civile janë duke u integruar në sistemin e Kosovës. Tashmë, 433 kanë marrë vende pune nëpër institucione dhe 50 tjerë po marrin pagat dhe u është premtuar plasman në punë brenda tre vjetësh. Kualifikueshmëria dhe përputhja institucionale është përcaktuar nga një panel prej katër personash, i përbërë nga dy përfaqësues të institucioneve të Kosovës, një ish-anëtar i Mbrojtjes Civile, dhe një përfaqësues i BE-së.

Në mënyrë që të merret në konsideratë për integrim, çdo aplikant duhet të paraqesë prova të vlefshme të shtetësisë së Kosovës, bashkë me aplikacionin për punë. Policia e Kosovës dhe EULEX kryen kontrollet e sigurisë. Tek 50 aplikantë u gjetën vepra gjyqësore dhe nevojitej fletë-lëshimi nga institucionet gjyqësore të Kosovës në mënyrë që të vazhdohej tutje.

105 kontratat e para u nënshkruan më 1 korrik të këtij viti, për 80 persona që tani janë të punësuar në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave dhe 25 tjerë në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Marrëveshja ka specifikuar se i tërë procesi i rekrutimit do të përfundojë më 1 shtator 2015, por nuk ndodhi kështu. Procesi i gjetjes së posteve për ish-punonjësit po zgjat më shumë se sa pritej.

Marrëveshja ka specifikuar gjithashtu se të gjitha objektet që ishin në pronësi dhe që operoheshin nga Mbrojtja Civile do t'i dorëzohen qeverisë së Kosovës. Kjo përfshin magazinat, zyrat, pikat e vëzhgimit, si dhe pajisjet dhe uniformat. Problemi qëndron në atë se disa prej pronave të premtuara në Bruksel nuk i përkasin fare Mbrojtjes Civile, diçka që ekipi negociator serb në Bruksel me gjasë e dinte.

Një grup i përbashkët u pajtua rreth listës së 15 njësive (zyrave, magazinave, etj) të përdorura nga Mbrojtja Civile në të katër komunat. BE-ja i tha qeverisë së Kosovës se këto mjedise duhet të konsiderohen si pronësi e komunave, jo e Mbrojtjes Civile, dhe se ata nuk kanë të drejtë t'i dorëzojnë ato në anën e Kosovës. Pala e Kosovës thotë se në atë rast nuk është dashur fare të kishte negociatë rreth objekteve.

Pajisjet u dorëzuan më 25 gusht 2015 në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë.

Janë tri pika të vëzhgimit që ndodhen përgjatë rrugës kryesore nga Mitrovica për në Jarinjë. Sipas marrëveshjes, ato është dashur të largohen më 20 prill. Kjo nuk ndodhi, por ato u larguan më 11 qershor. Një tjetër pikë vëzhgimi në Mitrovicë veriore që shikonte mbi urën kryesore iu dorëzua Policisë së Kosovës më datë 13 gusht, dhe ajo u largua plotësisht me asistencë të EULEX-it më 14 shtator. Kjo edhe me marrëveshje u parapa për 20 prill, kështu që pati vonesë pesë mujore.

Sipas qeverisë së Kosovës, më 29 prill 2015, Serbia informoi BE-në me shkrim se Mbrojtja Civile në Kosovë më nuk do të ekzistojë brenda sistemit të Serbisë nga data 1 shtator 2015. Anëtarët e Mbrojtjes civile më nuk marrin paga nga Serbia.

## Gjyqësori

Oasja në drejtësi është pikë thelbësore referimi për demokracinë dhe paraqet komponentë të rëndësishme të themelimit të çdo shteti. Kosova ka synuar prej kohësh një gjyqësor unitar, të përbërë nga i tërë territori i saj. Marrëveshja e 19 prillit 2013 dhe plani i 22 majit 2013 për implementimin e tij parashikoi se autoritetet gjyqësore do të integrohen plotësisht deri në fund të atij viti. Implementimi kishte ngecur plotësisht dhe në orët e hershme të mëngjesit mes datës 9 dhe 10 shkurt 2015 u arrit marrëveshje e re për integrimin e katër komunave veriore në sistemin gjyqësor me bazë në Prishtinë. Kjo marrëveshje ishte e para e bërë mes kryeministrave Mustafa dhe Vuçiq, dhe kjo erdhi pas muajsh stagnimi. Edhe pse kjo sinjalizoi një lloj injeksioni momentumi për procesin, afatet ishin tepër shumë ambicioze: marrëveshja parashikonte që gjyqësori unitar të jetë plotësisht funksional deri më 1 shtator 2015.

"Kemi nevojë për gjykatë, në mënyrë që veriu i Kosovës më në fund të mos jetë më vakuum i sundimit të ligjit", thotë Dushan Radaković, OJQ e të cilit, me seli në Mitrovicë, punon me sistemin e drejtësisë. "Gjyqësori është themeli i çdo shoqërie, dhe kjo marrëveshje është çelësi për zhbllokimin e tjerave. Pasi që kjo marrëveshje të jetë implementuar plotësisht, do ta bëjë më të lehtë të implementohen tjerat".

Palët janë pajtuar që autoritetet ekzistuese gjyqësore do të integrohen në sistemin e Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të krijojë një panel të përbërë nga një shumicë gjyqtarësh serbë të Kosovës për të trajtuar të gjitha komonat me shumicë serbe.

Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të ketë ulëse të përhershme në veri të Mitrovicës. Gjyqtarët serbë të Kosovës do të përbëjnë shumicën e secilit panel.

Më 10 shkurt 2015 të dy palët u takuan në Bruksel dhe u pajtuan saktësisht se si do të duket struktura e gjyqësorit. Palët u pajtuan që kryetari i gjykatës të jetë serb i Kosovës nga veriu i Kosovës. Gjykata në Mitrovicën e Veriut do të ketë një divizion për Ankesa, me pesë gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 2 gjyqtarë shqiptarë të Kosovës, ndërsa një serb i Kosovës do të emërohet nënkryetari i Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ajo gjithashtu do të përmbajë divizionin për krimeve të rënda për të gjithë rajonin, i cili do të përbëhet nga katër gjyqtarë serbë të Kosovës dhe katër gjyqtarë shqiptarë të Kosovës. Janë edhe shifrat specifike për punonjësit si për ata me kombësi serbe ashtu edhe shqiptare, të parashkruar për secilën gjykatë dhe degë të saj.<sup>73</sup>

Pikat kryesore të marrëveshjes janë si më poshtë:

- Do të ketë një gjykatë themelore dhe një zyre të prokurorisë themelore për rajonin e Mitrovicës, e cila përfshin katër komonat veriore dhe Skenderajn dhe Vushtrinë kryesisht-shqiptare dhe më të populluar.



"Gjyqësori është themeli i çdo shoqërie, dhe kjo marrëveshje është çelësi për zhbllokimin e tjerave. Pasi që kjo marrëveshje të jetë implementuar plotësisht, do ta bëjë më të lehtë të implementohen tjerat."

**-DUSHAN  
RADAKOVIQ,  
THEMELUES I  
OJQ ME BAZË NË  
MITROVICË**

<sup>73</sup> Kjo marrëveshje është publikuar në formë dokumenti të rrjedhur. Ministria e Drejtësisë e Kosovës ia ka bërë të mundshme atë BIG DEAL-it, por nuk e ka publikuar tekstin e plotë të marrëveshjes në internet.



Njëra gjykatë themelore do të ketë dy objekte (Mitrovicë Veriore dhe Jugore) dhe katër degë të gjykatës: Zubin Potok, Leposaviq, Skenderaj dhe Vushtrri.

- Objektet e gjykatës në Mitrovicën jugore do të kenë Departament për të Mitur për tërë rajonin. Ajo do të gjykojë çështje civile, pretendime të pakontestueshme, dhe kundërvajtjet për Mitrovicën veriore dhe jugore si dhe Zveçanin.
- Kryetari i gjykatës do të jetë serb i Kosovës nga veriu i Kosovës. Kryeprokurori do të jetë shqiptar i Kosovës, me zyre në Zyrën Administrative të Mitrovicës së Veriut në Lagjen e Boshnjakëve.
- Ndarja e rasteve të prokurorëve bazohet në ekspertizën, specializimin, dhe njohuritë personale. (Kjo duket se do të sigurojë të dyja palët se rastet e tyre me gjasë të madhe do të përndiqen nga anëtarët e të njëjtit grup etno-nacional).
- Gjykata Themelore do të ketë 14 gjyqtarë shqiptarë dhe 10 gjyqtarë serbë në ndërtesën që ndodhet në Mitrovicën jugore, dhe 14 gjyqtarë serbë e 10 shqiptarë në objektet e Mitrovicës Veriore.
- Zyra e Prokurorit do të ketë 9 serbë dhe 9 shqiptarë me staf mbështetës prej 24 personash.
- Do të ketë staf mbështetës prej 79 serbësh dhe 79 shqiptarësh, megjithëse degët në Zubin Potok dhe Leposaviq do të kenë secili personel prej shtatë personash serbë.
- Gjykata në Mitrovicën veriore do të ketë një Divizion për Ankesa me pesë gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 2 gjyqtarë shqiptarë të Kosovës. Ai gjithashtu do të jetë nikoqir i Divizionit për Krime të Rënda për tërë rajonin, i cili do të përbëhet nga katër gjyqtarë serbë të Kosovës dhe katër gjyqtarë shqiptarë të Kosovës. Ai gjithashtu do të gjykojë veprat penale për Mitrovicën e veriut dhe të jugut, dhe Zveçanit. Një serb i Kosovës do të emërohet nënkryetar i Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Gjatë kohës së përgatitjes së këtij publikimi, ekzistojnë edhe disa pika tjera të dukshme të cilat nuk u negociuan në Bruksel në shkurt 2015 e të cilat kanë dalë se janë të vështira për t'u zgjidhur: lokacioni i Zyrës së Kryeprokurorit, etniciteti i nëpunësit gjyqësor, dhe numri i etniciteteve të stafit mbështetës dhe administrativ.<sup>74</sup> Madje, databaza ekzistuese e të gjitha rasteve gjyqësore në Kosovë është në dispozicion vetëm në shqip.

Për momentin ka një akumulim prej rreth gjysmë milioni rastesh gjyqësore në tërë Kosovën, 8,000 prej të cilave përfshijnë veriun e Kosovës. Institucionet gjyqësore të Serbisë thuajse janë mbyllur në vitin 2013, në pajtim me marrëveshjen. Ato trajtojnë vetëm lëndë civile, si shkurorëzime dhe martesat. Vetëm EULEX mund të trajtojë aktivitete kriminale, ndonëse mandati i tij parashihet të përfundojë në fund të qershorit 2016, dhe ai merret vetëm me krime të luftës të profilit të lartë, krime të luftës, dhe raste të korrupsionit. Nuk

<sup>74</sup> Vetëm disa prej etniciteteve dhe shifrave janë definuar në marrëveshjen/planin e fundit.

është publikuar ndonjëherë ndonjë strategji për tejkalimin e morisë së rasteve të akumuluar.

Kur policia kryen hetim penal, dëshmitë merren dhe dërgohen në Vushtrri dhe atje ruhen, derisa gjykata të bëhet plotësisht funksionale. Vlerësohet se rreth 500 të dyshuar nga veriu i Kosovës do të merren në pyetje sa më parë që prokuroria të bëhet operacionale.<sup>75</sup>

Mbetet e paqartë nëse do të miratohet ndonjë rregullore apo ligj për të siguruar se krimet me statut kufizimi të cilat kanë skaduar për shkak të mungesës së një vendi për t'i gjykuar ato.

"Gjykatat serbe ndaluan punën e tyre pak a shumë më 1 shtator 2013, kur supozohej që do të përfundonte ky proces i integritetit të gjyqësorit, por asgjë nuk ndodhi deri kur u afrua shtatori i vitit 2013, dhe vazhduan negociatat", tha një ish-punonjës i gjyqësorit serb i cili dëshiroi të mbetet anonim për shkak të ndjeshmërisë së temës.<sup>76</sup> "Ky proces i negociatave vazhdon, por jeta nuk mund të qëndrojë në pritje të marrëveshjeve politike, ligjet nuk shkruhen për t'u shtuar atyre marrëveshje politike, por për t'i implementuar ato. Qytetarët kanë të drejtë për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, të gjithë kanë interesin e vet ligjore dhe duan që ajo t'u mbrohet nga gjykatat".

Siç kemi theksuar në raportin tonë të fundit, marrëveshja për gjyqësorin, sikurse marrëveshja për policinë (e cila përcakton se komandanti rajonal i policisë duhet të jetë serb), ka ngjallur zemërim tek komunitetet pakicë jo-serbe në Kosovë, sepse ajo nuk parasheh në mënyrë eksplicite pjesëmarrjen e tyre në gjyqësi. Përfaqësuesit e komuniteteve boshnjake, gorane, turke, ashkali, rome kanë njoftuar zëshëm për frustrimin e tyre dhe synimin për ta kundërshtuar vendimin para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Për më tepër, neni 53 i Kushtetutës së Kosovës thotë: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)". Në vitin 2009, në vendimin e saj mbi rastin "Sejdiq-Finci", GJEDNJ vendosi se dispozita e Kushtetutës së Bosnje e Herzegovinës – e cila parashton presidencë tre-anëtarëshe të përbërë nga një serb, një kroat dhe një boshnjak – përbën shkelje të standardeve evropiane të të drejtave të njeriut. Kjo krijon një precedent në jurisprudencën e Konventës Evropiane, e cila mund t'i ndjekë si hije marrëveshjet e arritura mes Beogradit dhe Prishtinës. Marrëveshja u bë në Bruksel shumë kohë pas vendimit mbi rastin Sejdiq-Finci, mirëpo edhe BE edhe palët lejuan përbërje etnike të gjykatës, e cila mund të jetë në kundërshtim me të drejtat e njeriut.

Në Bosnjë, ku reforma gjyqësore është në vazhdim e sipër, entiteti më i vogël, Republika Srpska, ka kërkuar zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj, sepse ajo dëshiron që gjykatat në të gjithë Bosnjën të kenë numër të barabartë gjyqtarësh nga të tre "popujt përbërës", (tri grupet kryesore etnike: boshnjakët,

<sup>75</sup> Intervistë me aktivistë të shoqërisë civile që monitorojnë sistemin gjyqësor në Mitrovicën veriore, nëntor 2015.

<sup>76</sup> Intervistë me punonjës nga sistemi i gjykatave të Serbisë në Mitrovicën Veriore, tetor 2015.



“Gjatë një apo dy viteve të fundit, Gjykata Themelore në Mitrovicë, e rilokuar në Vushtrri, nuk menaxhon vetëm disa krime urgjente por shumë më shumë raste, mua më duket se ajo mbulon edhe nevojat themelore të popullatës së veriut, jo vetëm ato penale por edhe civile.”

**-RUZHICA SIMIQ,  
MENAXHERE E NJË  
OJQ NË MITROVICËN  
E VERIUT KUNDËR  
DHUNËS SHTËPIAKE**

kroatët dhe serbët). Megjithatë, ky parim është cilësuar diskriminues dhe është refuzuar, dhe ekspertët e Bashkimit Evropian po ashtu kanë thënë se zgjedhja e gjyqtarëve duhet të bazohet në arsye profesionale dhe jo etnike.<sup>77</sup> Duket e çuditshme se si në dy vende kandidatë për zgjerim në Ballkanin Perëndimor, BE-ja ka dy standarde të ndryshme.

Shumë banorë të Mitrovicës së veriut veçse i shfrytëzojnë shërbimet e gjykatës në Vushtrrim thotë Ruzhica Simiq, e cila menaxhon një OJQ në Mitrovicën e veriut kundër dhunës familjare.<sup>78</sup>

“Gjatë një apo dy viteve të fundit, Gjykata Themelore në Mitrovicë, e rilokuar në Vushtrri, nuk menaxhon vetëm disa krime urgjente por shumë më shumë raste”, tha Simiq për BIG DEAL. “Mua më duket se ajo mbulon edhe nevojat themelore të popullatës së veriut, jo vetëm ato penale por edhe civile”.

Simiq thotë se sa i përket trajtimit të atyre që përdorin shërbimet e gjykatës, nuk ka dallime mbi bazë kombësie.

“I vetmi dallim është ai mes niveleve të edukimit të gjyqtarëve e prokurorëve të ndryshëm, ajo se sa me të vërtetë dinë ata [lidhur me dhunën familjare], meqë tani ekziston kodi i ri penal, andaj e vetmja çështje është ajo se cilat elemente ata i vendosin në aktakuzë dhe i lidhin me atë që është e shkruar në ligj. Kjo është problematike, por ne do të duhet të punojmë me policinë, gjykatën dhe prokurorët”.

Është e qartë që Kosova ka nevojë për gjyqtarë kompetentë pa marrë parasysh etno-nacionalitetin, dhe ka nevojë për shumë të tillë. Sistemi gjyqësor është qysh tani me staf të pamjaftueshëm, me mesatarisht 18.3 gjyqtarë aktivë për çdo 100,000 njerëz, kjo sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës.<sup>79</sup> Kjo paraqet shifër më të lartë se në vitet e kaluara por shumë më të ulët sesa shtetet tjera në rajon.<sup>80</sup>

## Shkresat: Diplomat, Regjistri Civil, Kadastri Diplomat

Edhe pse është një nga marrëveshjet e para teknike të arritura, njohja reciproke e diplomave nuk ka shkuar shumë rrjedhshëm.

Sa i përket njohjes së diplomave nga Kosova dhe nga Serbia, situata nuk është përmirësuar për asnjërin prej studentëve të përmendur në raportin e kaluar. Ministria e Arsimit e Kosovës miratoi një rregullore në muajin gusht e cila do të duhej të shtronte terrenin për njohje të diplomave. Fatkeqësisht në praktikë, kjo gjë nuk ka mundur asgjë dhe asgjë nuk ka ndryshuar që nga raporti i fundit BIG DEAL, i cili ka mbuluar këtë temë gjerësisht.

77 Më shumë këtu: <http://www.balkaninsight.com/en/article/bosnian-court-fears-abolition-at-tempt-by-serbs-11-10-2015>

78 Qendra për Veprim Parandalues dhe Mbrojtje të Femrave ndaj Dhunës u themelua në prill 2015.  
79 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Statistikat e mesit të vitit 2014 për gjykatat”, gusht 2014. [http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/STATISTICS\\_REPORT\\_ON\\_THE\\_EORK\\_OF\\_THE\\_COURTS\\_Mid-year-2011\\_638768.pdf](http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/STATISTICS_REPORT_ON_THE_EORK_OF_THE_COURTS_Mid-year-2011_638768.pdf)

80 Shih Grupin NDërkombëtar të Krizës, “Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur,” 19 maj 2010. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, Bosnjë e Hercegovina kishte 22.1 gjyqtarë për çdo 100,000 banorë, ndërsa Kroacia 40.1 dhe Mali i Zi 51. <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo.pdf>

Njohja reciproke e diplomave paraqet një çështje që prek jetërat e shumë të rinjve nga Kosova dhe nga Serbia. Shqiptarët e Serbisë ndonjëherë vendosin të studiojnë në Kosovë në mënyrë që të mësojnë në gjuhë amtare. Serbët e Kosovës kanë nevojë për diploma universitare në mënyrë që të punësohen në nivele të larta, posaçërisht në qeveri, ku në shumë institucione serbët janë të nën-përfaqësuar.<sup>81</sup> Ndërkohë që mosnjohja e diplomave mund të mos jetë e vetmja arsye për këtë, por është gjithsesi komponentë kyçe.

Shqiptarët që jetojnë në Serbi e që duan të hyjnë në punë në sektorin publik gjithashtu përballen me balancimin mes të dëshirës për të studiuar në gjuhë amtare dhe potencialit për t'u punësuar në të ardhmen.

Më 21 nëntor 2011, të dy palët u pajtuan që të "kërkojnë nga Asociacioni i Bashkimit Evropian (EUA) të certifikojë diplomat universitare të lëshuara nga universitetet e njëres për përdorim nga tjetra, sa i përket arsimimit të lartë dhe/ apo punësimit publik". EUA është pikërisht ajo që ia thotë emri, organ i cili përfaqëson më shumë se 800 universitete nga 47 vende të Evropës, i angazhuar për të shkëmbyer dhe bashkëpunuar.<sup>82</sup>

Një OJQ nga Holanda, SPARK, u ngarkua si palë e tretë me mbikëqyrje të procesit, duke marrë aplikacione nga Kosova dhe Serbia dhe duke i përcjellë ato tek EUA. Megjithatë, kontrata dy-vjeçare me SPARK përfundoi në korrik 2014 dhe ajo nuk u rinovua. Sipas përfaqësuesve të SPARK, kjo ishte për shkak se të dyja palët duhet të ri-zotohen që në fakt të pranojnë diplomat.

Implementimi filloi në shkurt të vitit 2012 dhe deri në fund të gushtit të vitit 2014, 362 aplikacione nga Kosova dhe 13 aplikacione nga Serbia u miratuan dhe u lëshuan certifikata të njohjes së diplomave. Kjo nga gjithsej 408 aplikues nga Kosova dhe 25 nga Serbia.

Sipas zyrës së Serbisë për Kosovën, Beogradi ka marrë vetëm 38 aplikacione, nga të cilat 28 u miratuan, pesë refuzuan, dhe pesë janë ende duke u proceduar. Kjo erdhi pas një procesi shtesë nostrifikimi. Për dallim prej sistemit të centralizuar në Prishtinë, Serbia kërkon nga studentët që të aplikojnë direkt në universitete për akreditim.

Procesi i nostrifikimit në Serbi është nga më të komplikuarit në Evropë, dhe Serbia po planifikon të formojë një qendër kombëtare për njohje të diplomave. Shpresat janë që edhe Kosova të përfshihet në këtë proces..

Kjo çështje ka qenë shkas për të drejtuar gishtin fajësues për shumë vite. Diskutimet në shtator rezultuan me një plan sipas të cilit të dy kryeqytetet duhet të krijojnë lista të universiteteve të akredituara për ta qarkulluar tek tjetri, dhe të njohin aplikacionet e jashtëzakonshme për diploma brenda pesë javësh.

---

81 Sipas një studimi në vitin 2013 të komisionuar nga Qeveria e Kosovës, pak ministri apo institucione kishin përfaqësimin prej 10% minoritar siç kërkohet me ligj. Ministrinë e Financave, Drejtësisë, dhe Integriteteve Europiane secila kishin më pak se 2% përfaqësim minoritar. Situata është e ngjashme edhe Administratën Tatimore (3%), Thesar (1.5%) dhe Dogana (1.4%). Policia e Kosovës ka më shumë se 10% i kërkuar me ligj. Për më shumë informata, shih "Vlerësimi i Punësimit të Pjesëtarëve të Komuniteteve Jo-shumicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike", Korrik 2013, nga Novartis Consulting. [http://www.novusconsult.net/pdf/FINAL\\_PRESENTATION\\_07\\_2013.pdf](http://www.novusconsult.net/pdf/FINAL_PRESENTATION_07_2013.pdf)

82 <http://www.eua.be/Home.aspx>

Megjithatë, kjo sërish u shty. Të dy anët thonë se diskutimet vazhdojnë, dhe se ana tjetër është duke obstruksionuar implementimin.

## Universiteti i Prishtinës i Rilokuar në Mitrovicë

Çështje në vete është njohja e diplomave nga "Universiteti i Prishtinës i rilokuar në Mitrovicë". Kjo çështje nuk është diskutuar në dialogun e Brukselit, sepse ndërkohë që Serbia e sheh këtë si institucion të Serbisë, Kosova konsideron se ai është në territor të vet.

Zgjidhja e kësaj çështje është kyçe për të rinjtë serbë që jetojnë në Kosovë që ata të gjejnë punësim të dobishëm në institucionet publike, të marrin licenca profesionale të lëshuara nga institucionet publike, ose të marrin pjesë në provime profesionale të organizuara nga institucionet publike.

Në qershor të vitit 2015, një grup punues parashtrroi kriteret për të përcaktuar se si mund të vlerësohen kualifikimet e të diplomuarve në mënyrë që një certifikatë të mund të përdoret si zëvendësim diplome, pa e njohur medoemos diplomën e universitetit. Sipas strategjisë, e cila do të bëhet funksionale deri në fund të vitit 2015, një komision prej 7 anëtarësh do të lëshojë certifikata për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë diplomë të lëshuar nga Universiteti i Mitrovicës Veriore. Dy anëtarë të panelit do të propozohen nga Kryeministri, dhe tre do të propozohen nga Ministri i Arsimit. Strategjia është e bazuar në vetëdijesimin rreth të drejtës për punë dhe arsim, si dhe e bazuar në Ligjin e Kosovës për Arsim të Lartë dhe Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës. Procesi pritet të bëhet i vlefshëm deri në fund të vitit 2015.


Rregullorja do duhej të vlente për tri vjet, për të gjitha diplomat e lëshuara që nga viti 2001, kur universiteti u rilokua në Mitrovicë Veriore.

Fatkeqësisht, personat e afërt me këtë proces kanë shqetësime se për shkak të pezullimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese, edhe kjo procedurë do të vonohet.

## Kadastr

Më 2 shtator 2011, palët u pajtuan që të sigurojnë regjistrin e plotë kadastral për Kosovën përmes një procesi të ngjashëm me atë të marrëveshjes për regjistrat civilë: Ekipe trepalëshe, të kryesuar nga BE, të cilët do të skanojnë dhe verifikojnë dokumentet para vitit 1999.<sup>83</sup> Secili do të krahasohej përmes një agjencie teknike brenda Kosovës, dhe në rast të mospërputhjeve, ato do të shqyrtohen nga një mekanizëm gjykoës, Agjencioni për Certifikim dhe Verifikim të Pronës në Kosovë (KPCVA), dhe Gjykata Supreme e Kosovës si shqyrtues i ankesave.

Në raportin e fundit mbi gjendjen e implementimit, Ministrja e Kosovës për Dialog e përshkroi situatën thjeshtë: "Implementimi i kësaj Marrëveshjeje nuk



"Implementimi i kësaj Marrëveshjeje nuk ka filluar akoma"

<sup>83</sup> Marrëveshja e plotë këtu: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_cadastral\\_records.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_cadastral_records.pdf)

ka filluar akoma”.<sup>84</sup>

Serbia u zotua se do të skanojë dhe kthejë dokumentet, dhe Kosova u zotua se do të krijojë Agjencinë për Certifikim dhe Verifikim të Pronës (KPCVA), për të menaxhuar mosmarrëveshjet lidhur me ato dokumente. Kalimi i ligjit për KPCVA-në u bllokua për një kohë të gjatë, edhe pse u miratua pas leximit të parë, për herë të dytë më 27 prill 2015. Më shumë se katër vjet pasi që marrëveshja u nënshkrua, ligji mbetet në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës. Gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti, është planifikuar një lexim i dytë, por obstrukcioni i vazhduar i punës së Kuvendit mund ta ngadalësojë atë edhe më shumë.

Vetëvendosje ka kundërshtuar këtë ligj për shkak se ai parasheh që KPCVA do të mbikëqyret nga një përfaqësues i BE-së, dhe kjo parti pohon se periudha e pavarësisë së mbikëqyrtur ka përfunduar qe shumë vjet në Kosovë. Qeveria e Kosovës beson se shkëmbimi i letrave mes Presidentes Jahjaga dhe Catherine Ashton në 2014, e ratifikuar në Kuvend, mund të ofrojë bazë për këtë emërim.

Ligji aktual është gjithsesi një kompromis, sepse teksti origjinal i marrëveshjes përmend themelimin e një agjencie të re. “Kjo nuk pasqyrohet me të vërtetë në draft ligjin”, thotë një burim i përfshirë në proces, “Por nëse ligji interpretohet drejt, ai mund të paraqesë bazë të punueshme”.<sup>85</sup>

BIG DEAL iu afrua një deputeteje serbe të Kuvendit të Kosovës e cila është pjesë e komisionit legjislativ të Kuvendit, me qëllim që të marrë opinionin e Listës Serbe mbi draft ligjin. Deputetja, fatkeqësisht, kërkesën që ia parashtroi BIG DEAL e dërgoi drejt në Zyrën e Serbisë për Kosovë dhe nuk u përgjigj në kërkesat për ta kontaktuar atë.

Beogradi nuk është i kënaqur me draft-ligjin aktual mbi Komisionin Certifikues dhe Verifikues të Pronës në Kosovë, por dëshiron të shohë zgjidhje të çështjes së pronës. Sipas tekstit të marrëveshjes, një zyrtar qeveritar nga Beogradi duhet të jetë i pranishëm në çështjet e gjykimit të pronës, gjë që nuk parashihet në draft-ligjin në fjalë.

Draft-ligji aktual ngrit edhe disa çështje logjistike si dhe shqetësime rreth të drejtave të njeriut, thotë eksperti i pavarur i të drejtës së pronës, Massimo Moratti, i cili ka përvojë mbi pesëmbëdhjetë vjeçare në çështjet e pronës në Ballkan. Pikë së pari, nuk ka hierarki të qartë të dokumenteve të parapara në ligj, gjë e cila do të ndihmonte në vlerësim të pretendimeve të pronës.

Shqetësimet kryesore janë shkelja e Nenit 6, paragrafi 1, dhe Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Europiane për Drejta të Njeriut.

Procedimet e parapara në draft-ligjin nuk përmbushin kërkesat për “dëgjim publik”, thotë Moratti. Drafti po ashtu nuk ofron garanci të nevojshme se personat që kanë interes ligjor do të informohen me kohë lidhur me procedimet dhe nuk merr parasysh pozitën specifike të personave të shpërngulur-zhvendosur brenda vendit.

Për më tepër, Moratti thotë se pushteti i gjerë diskrecional i Sekretaria-

<sup>84</sup> “Gjendja e implementimit të Marrëveshjes së Brukselit mars-shtator 2015,” faqe 45.

<sup>85</sup> Intervistë në Prishtinë në tetor 2015.

tit Ekzekutiv me rastin e mbledhjes së dëshmime dhe përdorimi jo-selektiv i arkivave publike gjatë procesit të krahasimit, verifikimit dhe gjykimit mund të çojë në situata ku vendimet finale bazohen në dëshmi të dyshimta, ndërkohë që procedimet e Gjykatës së Apelit para Gjykatës Supreme të Kosovës janë me fushëveprim tepër të kufizuar.

“Besoj që brenda BE-së ekzistojnë verifikime të ndryshme të pajtueshmërisë ligjore të këtyre marrëveshjeve me standardet e drejtave të njeriut, andaj jam mjaft i befashuar që kjo çështje nuk është vërejtur nga BE-ja, përveç nëse faktori kryesor për të mbikëqyrë këto çështje ishte presioni për të arritur marrëveshje”.

Gjithashtu, draft-ligji fton për mjete juridike për ekzekutimin e vendimeve finale, të cilat janë dëshmuar si të paefektshme në dhjetë vitet e fundit në Agjencinë Kosovare të Pronës, mirëpo, nuk ekziston ndonjë siguri se do të largohen pengesat e identifikuara lidhur me zbatimin efektiv të tyre.

Skanimi ndërkohë vazhdon në Beograd. Marrëveshja fillestare ishte që vetëm të skanoheshin dokumentet, por një test i procesit zbuloi se pa realizuar një databazë që mundëson kërkimin e dokumenteve, gjetja e regjistrave kadas-tralë do të ishte tepër e vështirë. Në qershor 2014, Serbia u pajtua që ta bëjë databazën e ardhshme me mundësi kërkimi, dhe tani dokumentet janë duke u indeksuar. Që nga data 6 nëntor, janë skanuar 3,198,257 imazhe dhe 329,309 imazhe janë indeksuar nga gjithsej rreth 4,037,264 nga gjithsej 300 libra.

Mbështetja e BE-së për projektin vazhdon deri në mars 2016. Gjatë kohës së përgatitjes së këtij raporti, përfundimi i skanimit dhe dorëzimi është i mundshëm deri në atë datë. Megjithatë, menjëherë pas marrëveshjes mbi gjykatën kushtetuese, puna e komisionit legjislativ mbi KPCVA-në është vënë në pritje, dhe njëjtë qëndron çështja e leximit të dytë të ligjit në parlament.

## Regjistrat Civilë

Para dhe gjatë luftës, regjistrat civilë të Kosovës, të cilat përmbanin informacion mbi lindjet, vdekjet e martesat e qytetarëve të Kosovës të lindur mes viteve 1850 dhe 1999 u shkatërruan, dogjën apo zhvendosën në Serbi. Një marrëveshje u arrit më 2 korrik 2011. Kthimi i 12,391 regjistrave të certifikuar civilë u kompletua në mars 2014. Kosova është duke ndërmarrë një projekt të BE-së për të digjitalizuar këto kopje.

## Kosova dhe Bota

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova është njohur nga 111 shtete, vetëm dy në vitin e kaluar. Si pjesë e marrëveshjes mbi përfaqësimin regjional dhe bashkëpunimin, më 24 shkurt 2012, palët u pajtuan, në baza të përkohshme, se emri i Kosovës mund të shfaqej në organet regjionale me fusnotë e cila i referohet Rezolutës së Këshillit të Sigurisë 1244 dhe opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, GjND, mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Ato më tej u pajtuan se çfarëdo marrëveshje e re do ta paraqesë

Kosovën me fusnotë.<sup>86</sup> Ndonëse kjo fusnotë do të thotë se Kosova mbetet e pabarabartë në skenën ndërkombëtare, ishte fitore e madhe për Kosovën të jetë në gjendje të nënshkruajë marrëveshje në emër të vetin, pa pasur nevojë të përfaqësohet nga UNMIK.

Megjithatë, vjeshta e vitit 2015 ka qenë veçanërisht periudhë e arritjeve për anëtarësimin ndërkombëtar dhe njohjen e Kosovës.

Kosova nënshkroi më 27 tetor Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA), e cila shtron terrenin për integrim në Bashkimin Evropian. Kjo është fitore e papritur për Kosovën: pesë shtetet anëtare të BE-së të cilat nuk e njohin Kosovën megjithatë u pajtuan të nënshkruajnë marrëveshjen, por kjo është arsyeja pse marrëveshja është nënshkruar si traktat bilateral mes BE-së dhe Kosovës. MSA do t'i lejojë kompanive të Kosovës eksport të mallrave drejt shteteve të BE-së pa nevojë për të paguar tarifën.

Nënshkrimi i MSA-së vjen në një kohë kur koalicioni qeveritar në fuqi në Kosovë mendohej të mirëmbajë kontrollin mbi parlamentin, i cili për disa javë të tetorit ishte i bllokuar nga koalicioni opozitar i udhëhequr nga Vetëvendosje. Ekziston besimi i gjerë se Bashkimi Evropian vendosi ta ofrojë marrëveshjen në mënyrë që të ofrojë një shtytje të shumë-nevojshme për qeverinë e Kosovës në një periudhë të vështirë kohore. Marrëveshja gjithsesi që paraqet edhe shpërblim për vazhdimin e dialogut me Serbinë.

Kosova ishte shteti i fundit i rajonit që nënshkroi MSA. Zyrtarët e Kosovës kanë shprehur gatishmërinë të aplikojnë për anëtarësim në Këshillin e Evropës pasi që të nënshkruhet MSA, por duket që kjo është shtyrë.

Një tjetër zhvillim madhor për Kosovën ishte fushata për anëtarësim në UNESCO, e lansuar zyrtarisht më 16 korrik 2015 dhe e intensifikuar në shtator dhe tetor e deri në votimin e fundit në nëntor. Ministri i Jashtëm, Hashim Thaçi, dhe zëvendës-Ministri i Jashtëm, Petrit Selimi, lobuan ekstenzivisht në Paris, ku ka selinë UNESCO, si dhe në kryeqytete të ndryshme të botës për njohje të Kosovës. Konkurrimi për anëtarësim, të cilit i duheshin 2/3 e votave shumicë të Asamblesë së Përgjithshme të UNESCO-s, dështoi më 9 nëntor për tri vota, me 92 vota për, 50 kundër, dhe 29 abstenime. Kjo ishte një goditje e fortë për momentumin e Kosovës, ndonëse goditja u zbut falë nënshkrimit të MSA-së një javë më herët.

Serbia kundërshton anëtarësimin e Kosovës në UNESCO sepse në përgjithësi ajo kundërshton çfarëdo njohje ndërkombëtare për Kosovën, por edhe për shkak se katër pikat e UNESCO-s në territorin e Kosovës janë kisha dhe manastire ortodokse serbe. Këto katër pika zyrtarisht njihen si "Monumentet Mesjetare në Kosovë" dhe UNESCO i ka të regjistruara ato në Serbi, nën "Provincën Autonome të Kosovës". Ato pika janë: Manastiri i Deçanit, Patriarkana e Pejës, Kisha e Apostujve në Graçanicë, dhe Kisha e Shën Premtës/Bogorodica Ljeviska në Prizren. Ato janë regjistruar në vitin 2004 dhe i janë shtuar listës së UNESCO-s

---

<sup>86</sup> Teksti i plotë i marrëveshjes mund të gjendet këtu: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_representation.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_representation.pdf)



“Trashëgimia e Rrezikuar Botërore” në 2006 pas trazirave të marsit të vitit 2004, në të cilat 800 ndërtesa u shkatërruan apo dëmtuan (29 prej tyre kisha e manastire).<sup>87</sup>

Beogradi dhe Kisha Ortodokse Serbe fillimisht qenë të qetë por pasi që bordi ekzekutiv vendosi të caktojë votimin në rend të ditës, diskursi u bë shumë i nxehtë, posaçërisht nga përfaqësues të Kishës Ortodokse Serbe. Serbia dhe anëtarë të Kishës Ortodokse Serbe kanë kërkuar që trashëgimia kulturore të shtrohet në dialog. Kosova këmbëngul se i ka mekanizmat, si Këshillin Implementues dhe Monitorues (IMC) si dhe grupe tjera punuese, për të trajtuar këto çështje, dhe kështu edhe ka vepruar.<sup>88</sup> Megjithatë, Beogradi dhe përfaqësues të komunitetit Ortodoks Serb kanë bërë me dije se një draft ligji mbi trashëgiminë kulturore, që ishte prezantuar në Kuvendin e Kosovës në muajin prill, ishte arsyeja për kundërshtimin plotësisht ndaj anëtarësimit të Kosovës.

“Qëllimi im ishte të tërhiqja vëmendjen tek problemet të cilat i kemi pasur me autoritetet e Kosovës, posaçërisht që nga prilli, kur ata u munduan ta miratojnë një ligj tejet diskriminues mbi trashëgiminë kulturore”, tha pak kohë më parë at Sava Janjiq, kryemurg i Manastirit të Deçanit. “Në kontekst të atij ligji, i cili kërkon që e tërë trashëgimia kulturore në Kosovë të bëhet pronë e Republikës së Kosovës, për Kishën tonë anëtarësimi në UNESCO u duk si mjet që ka gjasë të jetë me represion kulturor”.<sup>89</sup>

Madje, kryesuesi aktual i Këshillit Implementues Monitorues, zëvendës-kryeministri Kujtim Shala, i cili është aktualisht përgjegjës për kryesimin e këtyre grupeve punuese të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk ka mbajtur takime të rregullta. Disa vëzhgues ndërkombëtarë të ndryshëm kanë shprehur frustrim lidhur me deklaratat e tij se trashëgimia i takon Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, dhe lidhur me hezitimin e tij për të mbajtur takime. Kjo duhet të ndryshojë, dhe Kosova duhet të ri-zotohet për të implementuar atë që është dakorduar deri tani në Planin e Ahtisaarit.<sup>90</sup>

Humbja ka qenë goditje për legjitimitetin e Kosovës, por ajo duhet të fokusohet në pranimin e saj në organet e definuara në listën e marrëveshjeve të ndërmjetësuara nga facilitatori i BE-së Robert Cooper.

“Kosova tash duhet të dizajnojë strategji më të zgjuar për pranim në organizata tjera ndërkombëtare”, thotë Fisnik Korenica, nga Grupi për Studime

“Kosova tash duhet të dizajnojë strategji më të zgjuar për pranim në organizata tjera ndërkombëtare.”

**-FISNIK KORENICA,  
GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE/POLITIKE**

87 Sipas një raporti të OSBE-së lidhur me ngjarjet: “Më 17 dhe 18 mars 2004, një valë trazirash të dhunshme kaploi Kosovën, e shkaktoar nga dy incidente që u perceptuan si akte të motivuara etnikisht. Demonstratat, ndonëse në dukje ishin spontane kur filluan, shpejt u fokusuan drejt serbëve të Kosovës anëmbanë Kosovës. 19 persona u vranë (11 shqiptarë të Kosovës, tetë serbë të Kosovës), më shumë se 900 persona u lënduan (përfshirë edhe 65 policë ndërkombëtarë dhe 58 policë të Shërbimit Policor të Kosovës), dhe mbi 800 ndërtesa u shkatërruan apo dëmtuan (përfshirë 29 kisha apo manastire). Sipas një vlerësimi, më shumë se 50,000 njerëz morën pjesë në trazirat”. Për raportin e plotë, shih: “Katër vjet më vonë: Pas rastit të trazirave të marsit 2004 para Sistemit të Drejtësisë Penale në Kosovë.” <http://www.osce.org/kosovo/32700>

88 Moschopoulos, Dimitri. Trashëgimia Kulturore Ortodokse Serbe në Kosovë (Status raport i shkurtër), 6 tetor 2015. <http://www.peacefare.net/wp-content/uploads/2015/10/Status-Report-on-Heritage-Sites-in-Kosovo.pdf>

89 Judah, Tim. “At Sava: Koha për të ecur përpara dhe për të filluar dialogun”, Balkan Insight, 13 nëntor 2015. <http://www.balkaninsight.com/en/article/fr-sava-time-to-go-forëard-and-start-dialogue-11-12-2015>

90 Diskutime me zyrtarë ndërkombëtarë të përfshirë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Prishtinë në tetor 2015.

Juridike/Politike (GLPS). “Ajo duhet të ndjekë një qasje prioritizuese me së pari organizatat më pak të ndjeshme. Organizatat rajonale në të cilat Kosova nuk ka mundur të pranohet për shkak të obstrukcionit nga Serbia duhet të denoncohen në Bruksel. Duhet kujtuar se Kosova nuk ka fituar anëtarësim në shumicën dërmuese të organizatave të përshkruara në listën e Cooper-it (e cila ishte aneksi i marrëveshjes për fusnotën). Kjo paraqet një rezultat alarmues dhe diplomacia e Kosovës duhet ta marrë atë seriozisht”.

Korenica gjithashtu sugjeron që çfarëdo konkurrimi i ardhshëm të bëhet strategjikisht.

“Një tjetër dështim i madh pas UNESCO-s do të ishte seriozisht i dëmshëm për shtetësinë e Kosovës”, tha Korenica për BIG DEAL. “Andaj, nevojitet përgatitje më strategjike, konsensus i plotë politik mes të gjitha palëve, dhe më pak marketing për gjërat diplomatike që duhet të menaxhohen butësisht dhe konfidencialisht”.

Kosova vazhdon të jetë e ndaluar nga një numër organesh rajonale, mirëpo ka shënuar progres që nga fillimi i dialogut, kur të dyja palët u zotuan se “asnjëra palë nuk do të bllokohet, apo të inkurajohet të tjerë që të bllokohen përparimin e palës tjetër në shtegtimin e tyre respektiv drejt BE-së”.

Më 10 qershor 2015, Kosova iu bashkua zyrtarisht Iniciativës Rajonale për Migracion, Azil dhe Refugjatë (MARRI).<sup>91</sup> Paraprakisht, Kosova kishte marrë pjesë në takimet e MARRI, por pati vënë në dukje se “obstrukcioni nga Serbia ishte i dukshëm”.<sup>92</sup> Kjo duket se është rregulluar, edhe pse në progres-raportin e fundit për Kosovën, Komisioni Evropian përmendet se, “Serbia duhet të mbetet e angazhuar në implementimin e vazhdueshëm të marrëveshjes për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në forume rajonale”.<sup>93</sup>

Qeveria e Kosovës është ankuar gjithashtu se marrëveshja për bashkëpunim rajonal është shkelur për shkak të pengesave të vëna nga Serbia dhe entiteti Republika Srpska i Bosnjë e Hercegovinës, për shkak se Kosova ka vetëm statusin e ‘vëzhguesit’ në Rrjetin Parlamentar të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kosova synon të ketë status anëtar me të drejtë të barabartë vote.<sup>94</sup>

Megjithatë, sipas fjalëve të një zyrtari ndërkombëtar që e njeht mirë synimin e Kosovës për pranim rajonal, “Nëse Kosova do të shpenzonte vetëm dhjetë për qind të energjisë dhe përpjekjeve lobuese për anëtarësim në organizata regjionale sikurse që ka bërë për konkurrimin në UNESCO, do të ishim shumë më përpara”.<sup>95</sup>

Kosova do të duhet të ri-aplikojë, me gjallëri të ripërtërirë, për anëtarësim në Interpol. Edhe pse Kosova para disa muajsh bëri kërkesë për t’iu bashkuar organeve të bashkëpunimit policor ndërkombëtar, nuk ka kurrfarë indikacioni se Interpoli është duke u marrë me këtë kërkesë seriozisht. Interpoli nuk e ka

91 <http://www.marri-rc.org/upload/novi/201506./Skopje%20Declaration.pdf>

92 Tahiri, Edita. “Gjendja e Implementimit të Marrëveshjeve të Brukselit”, 16 janar 2014.

93 Kosovo\* 2015 Report, 10 nëntor 2015, faqe 30. Qasur përmes [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

94 Tahiri, Edita, “Gjendja e Implementimit të Marrëveshjeve të Brukselit” 10 qershor 2015.

95 Intervistë në Prishtinë në tetor 2015



“Siç qëndron për momentin, EULEX parashihet të reduktojë drastikisht mandatin në vitin 2016, andaj pyetja vjen: si mund të llogarisim akoma në shkëmbim të informacionit lidhur me rastet policore në nivel ndërkombëtar pas largimit të EULEX-it? – natyrisht, ne preferojmë që këtë shkëmbim ta bëjmë direkt me shtetet, meqë ashtu do të jetë me dobi të përbashkët”.

**-DRITON GASHI,  
SEKRETAR I  
MINISTRISË  
SË PUNËVE TË  
BRENDSHME E**

përfshirë në rend të ditës kërkesën e Kosovës për anëtarësi, për takimin që do të mbahet në dhjetor.

Driton Gashi, sekretar i Ministrisë së Punëve të Brendshme e përshkroi këtë gjë si diçka shqetësuese, sepse “me gjithë terrorizmin që po ndodh në Europë, është në interes të përbashkët të shteteve të Perëndimit që ta kenë Kosovën në Interpol në mënyrë që të shkëmbehet informacioni me ne, dhe është po aq në interesin tonë që të kemi një forum sikurse Interpoli për të shkëmbyer informacion policor”.

Për momentin, bashkëpunimi ndërkombëtar i rasteve policore, si p.sh. me krimet ndërkombëtare bankare dhe tema të ngjashme, është trajtuar në masë të madhe përmes EULEX-it, misionit të BE-së për Sundim të Ligjit, të cilit i është dhënë ky mandat nga ana e Misionit të OKB në Kosovë. Mirëpo, Gashi me të drejtë përmend se kjo situatë nuk do të jetë e fillë përgjithmonë.

“Siç qëndron për momentin, EULEX parashihet të reduktojë drastikisht mandatin në vitin 2016, andaj pyetja vjen: si mund të llogarisim akoma në shkëmbim të informacionit lidhur me rastet policore në nivel ndërkombëtar pas largimit të EULEX-it? – natyrisht, ne preferojmë që këtë shkëmbim ta bëjmë direkt me shtetet, meqë ashtu do të jetë me dobi të përbashkët”.

## Oficerët për Ndërlidhje

Dy persona të cilët e mbajnë funksionimin e dialogut në rrjedhë të mirë janë zyrtarët-oficerët për ndërlidhje të qeverive respektive. Valdet Sadiku, oficer ndërlidhës i Kosovës, është zyrtar me karrierë në shërbime të jashtme, i cili paraprakisht kishte shërbyer si ambasador i Kosovës në Kroaci. Zyrtari ndërlidhës i Serbisë, Dejan Paviçević, ka qenë pjesë e ekipit të parë negociator, në kohën kur administrata e Boris Tadiq filloi dialogun teknik në vitin 2011.

Palët janë pajtuar në Bruksel në shtator 2014 se të dy do të jenë ekskluzivisht përgjegjës për vizitat zyrtare, dhe secili i ka menaxhuar ato mirë. U miratua edhe një marrëveshje tjetër rishtazi, e cila i lejon secilës zyre që të ketë anëtar shtesë të stafit, por nuk është implementuar plotësisht për shkak të kufizimeve hapësinore.

Qeveria e Kosovës është ankuar se pas dy vitesh, z. Sadiku është takuar vetëm me një ministër. Beogradi debaton duke thënë se Prishtina nuk kishte kërkuar takime, pretendim ky të cilin Prishtina e përgënjeshton.

## Telekomi

Në Kosovë janë një numër operatorësh mobilë, me tri kode shtetërore të ndryshme, ku asnjëra prej tyre nuk i takon vendit, meqë Kosova nuk është akoma anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU). Kosova aktualisht përdor kodin shtetëror të Serbisë +381 për linjat fikse, e cila funksionon pa u vërejtur mes Kosovës e Serbisë. Telefonat mobilë të Serbisë me prefiksin +381 nuk funksionojnë në Kosovë, poshtë urës së Ibrit, përveç në disa pika të caktuara afër maleve dhe në zonat ku jetojnë serbët, jashtë roamingut. Në veri të urës së Ibrit, telefonat +381 funksionojnë sikur të ishin në Serbi. Kjo rezulton

në atë që njerëzit të bartin dy, ndonjëherë edhe tre telefona mobilë.

“Të gjitha i kam duplikat”, thotë Zoran Ristiç nga Graçanica. “Ndonjëherë më duket vetja si dy persona krejt ndryshe njëri nga tjetri. Telefonja mobile është kaos”.

Në Kosovë, dy operatorë mobilë përdorin kodet e Sllovenisë dhe Monakos, +386 dhe +377 respektivisht. +386, kodi i Sllovenisë, konsiderohet roaming edhe në Slloveni, dhe nuk konsiderohet pjesë e roamingut me kosto të ulët të BE-së. Shfrytëzuesit e telefonave mobilë në Kosovë paguajnë afërsisht tetë herë më shumë sesa fqinjët e tyre në shtetet e BE-së për thirrje në roaming dhe rreth 100 herë më shtrenjtë për internet gjatë roamingut, sipas një hulumtimi të kryer nga OJQ LENS.

Për shumë konsumatorë kosovarë, roamingu në Serbi nuk vjen në shprehje, gjë që paraqet problem themelor dhe i cili është pengesë për biznesmenët, gazetarët, ata që shkojnë në Serbi për trajtim mjekësor apo arsye familjare, turizëm, apo çfarëdo arsye tjetër.

Një marrëveshje lidhur me telekomet u arrit më 8 shtator 2013 pas afro tri vitesh negocieme.

Pika 13 e marrëveshjes së 19 prillit 2013 përcakton se “Diskutimet mbi energjinë dhe telekomin do të intensifikohen nga të dy anët dhe do të përfundohen deri më 15 qershor” dhe se kodi shtetëror do të jetë plotësisht operacional deri më 1 janar 2015. Kjo nuk ndodhi, por si pjesë e pakos së marrëveshjes së 25 gushtit, u arrit marrëveshje mbi telekomin.<sup>96</sup>

Marrëveshja përcakton se Austria, në emër të Kosovës, do të aplikojë tek ITU për kodin shtetëror +383. Kjo do të rregullohet nga ARKEP, agjencioni rregullator.

Menjëherë pas marrëveshjes, Ministria Tahiri tha se thirrjet mes Kosovës dhe Serbisë do të jenë thirrje ndërkombëtare, ndërsa që Kryeministri i Serbisë, Vuçiq, tha se “asgjë s’ndryshon”, dhe se “serbët nga Kosova, kur të thërrasin serbët në Serbi, prapë duhet të shtypin vetëm 011, dhe anasjelltas, kur ne thërrasim Mitrovicën, shtypim vetëm 028, pa kurrfarë kodesh tjera”.<sup>97</sup>

Sipas planit, rregullatorët e të dy shteteve do të inkurajojnë dhe lehtësojnë procesin e interkoneksionit dhe marrëveshjen e roamingut mes operatorëve mobilë të të dy anëve, me synim kah reduktimi i kostos për qytetarët.

Rregullatori i Kosovës do t’i japë licencë të përkohshme një kompanie telefonie të re, të regjistruar nën ligjet e Kosovës, deri në shpalljen e një tenderi të ri për kompani telefonike.

Sipas planit të veprimit të dakorduar më 25 gusht 2015, Kosovës zyrtarisht do t’i ndahet kodi shtetëror nga ITU. Me kodin shtetëror të instaluar, Kosova nuk do të duhet të paguajë tarifa të shtrenjta licencuese të cilat ia ka paguar Sllovenisë dhe Monakos, të cilat qeveria e Kosovës vlerëson se i kanë kushtuar rreth 200 milionë euro.

<sup>96</sup> Teksti i plotë këtu: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/150825-Joint-Action-Plan\\_Telecoms\\_en.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/150825-Joint-Action-Plan_Telecoms_en.pdf)

<sup>97</sup> [http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2015&mm=08&dd=25&nav\\_id=95216](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2015&mm=08&dd=25&nav_id=95216)

Prej muajit prill deri në korrik 2016 parashihet një “periudhë migrimi/kalimi”, dhe sipas planit të veprimit: “Pas kësaj date, ky kod i thirrjes nga ITU do të përdoret nga të gjithë operatorët në Kosovë. Operatorët nga të dy palët do të reduktojnë kostot për tarifat lokale për qytetarët”.

Sa i përket telefonisë fikse, një licencë e plotë për shërbime të telefonisë fikse do t'i lëshohet një kompanie të re, filialë kompanie nga Serbia e cila regjistrohet në Kosovë.

Marrëveshja gjithashtu “hap shtegun drejt arritjes së marrëveshjes teknike në shërbime postare”, mirëpo edhe kjo kishte qenë e definuar në marrëveshje të mëhershme, dhe vazhdon të mbetet e bllokuar nga mosmarrëveshjet rreth pronësisë mbi pronat e shërbimeve postare.

## Energjia

Që nga lufta, Serbia ka mbajtur në dorë frenat e infrastrukturës energjetike të Kosovës. Në shtator të vitit 2013, palët u pajtuan që organet e tyre të transmisionit të energjisë, KOSTT i Kosovës, dhe EMS i Serbisë, do të nënshkruajnë një marrëveshje bilaterale brenda tre muajve, duke vendosur dhe rregulluar me këtë marrëdhënie mes dy operatorëve të sistemit të transmisionit. Të dy rregullatorët do të lëshojnë licenca tregtare (import, eksport, tranzit) dhe do të furnizojnë kompanitë e tyre respektive të distribucionit. Palët janë pajtuar gjithashtu për të krijuar një kompani të re nën ligjet e Kosovës që do të ofronte shërbime të distribucionit për komunat veriore me shumicë serbe. Kosova dhe Serbia u pajtuan gjithashtu që, në një kohë të ardhme, të gjejnë një metodë të përbashkët për zgjidhjen e parashtrësive që kanë të dyja kundër njëra-tjetrës lidhur me përdorimin e linjave të transmetimit, duke u pajtuar edhe se do të kërkojnë arbitrim ndërkombëtar nëse nuk ka zgjidhje brenda gjashtë muajve.

Më 14 shtator 2014, KOSTT dhe EMS nënshkruan marrëveshje për menaxhimin e rrjetit dhe operimet e sistemit, duke i dhënë të dyjave bazë ligjore për operimin e pavarur të sistemit të energjisë elektrike. Kjo pati mbetur e bllokuar deri kur marrëveshja e fundit u nënshkrua më 25 gusht 2015.

KOSTT ishte përballur me pengesa sa i përket themelimit të marrëdhënies me rrjetin Europian të distributorëve të energjisë, ENTSO-E, për shkak të ndërhyrjes direkte të Serbisë. Në bazë të marrëveshjes, Serbia është pajtuar se do të ndalojnë bllokimin e anëtarësisë të Kosovës.

Janë dërguar disa aplikacione të ndryshme për të dy kompanitë e Serbisë, megjithatë, ato si duket nuk ishin sipas standardeve të dakorduara në Bruksel. Pasi që aplikacioni të ri-dërgohet, procesi i regjistrimit të dy kompanive duhet të procedojë normalisht.

Kosova akoma dëshiron të arrijë marrëveshje për kompensim të humbjeve nga profitet e Serbisë nga kontrolli i transmisionit të energjisë. EMS ka dhënë me ankand shfrytëzimin e linjave të transmisionit të Kosovës që nga viti 2004. Qeveria e Prishtinës vlerëson se mes vitit 2004 dhe 2014 i ka humbur deri në 150 milionë euro.

Një pjesë e infrastrukturës vitale për të gjithë infrastrukturën e interkonek-

sionit të energjisë ndodhet në veri. Liqeni i Gazivodës, shtëpia e digës më të madhe të Kosovës, ndodhet në Zubin Potok. Ajo furnizon 60 për qind të ujit të pijshëm dhe është burimi kryesor për ftohjen e termocentralit në Obiliq, 10 kilometra nga Prishtina. Kjo mbetet një nga pronat më të kundërshtuara mes Kosovës dhe Serbisë, dhe akoma nuk ka zgjidhje për të.

## PËRFUNDIM

Që nga viti 2011, dialogu është dukur si rruga e përparimit për Kosovën dhe për Serbinë drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjes rreth statusit dhe lidhur me progresin drejt anëtarësimit në BE. Bashkësia ndërkombëtare e ka bërë dialogun prioritet të parë, përmbi prioritetet për përmirësim të demokracisë lokale në të dyja vendet. Kjo lloj politike mund të dalë se ka ndikim negativ në vetë progresin e bërë deri tani me dialogun. Zyrtarët e BE-së dhe zyrtarë tjerë perëndimorë nuk duhet ta sakrifikojnë demokracinë lokale në shërbim të arritjes së marrëveshjeve për procesin e negociimit mes Kosovës dhe Serbisë.

Në fazën aktuale të dialogut, duket se ka fare pak detaje të vogla për të cilat s'ka plan, gjë që do të thotë se përveç vullnetit politik nuk ka diçka tjetër që mund ta pengojë implementimin e plotë. Kjo është periudhë kritike sepse progresi që është bërë – dhe progresi potencial pas implementimit të marrëveshjeve – akoma nuk është i pakthyeshëm.

Në mënyrë që ai të bëhet i pakthyeshëm, nevojitet mbështetje më popullore. Të dy qeveritë duhet të punojnë më shumë në dhënie të shpjegimeve tek qytetarët e tyre se implementimi i marrëveshjeve i afron ata më afër rrugës drejt BE-së, por shumëçka do të mbetet ashtu si është. Sipas fjalëve të politikanit nga Mitrovica, Oliver Ivanović:

“Pengesha më e madhe në implementim është se si shqiptarët ashtu edhe serbët nuk kanë besim, kanë frikë, dhe i frikësohen ndryshimit. Kjo do të ndikojë te populli serb, mirëpo ata, sipas mendimit tim, kanë informacion të pamjaftueshëm dhe ai informacion duhet t'u jepet atyre përgjatë tërë piramidës, nga zyrtarët e lartë deri tek ata komunalë”.

Duhet të ketë fushatë publike nga politikanët lidhur me atë se pse i kanë bërë këto marrëveshje, progresi duhet të raportohet rregullisht në parlamentet e Kosovës dhe Serbisë, dhe transparenca duhet të jetë prioritet kryesor.

“Të gjitha pikat negociuese të Kosovës do duhej të ishin debatuar në parlament”, thotë Hana Marku. “Negociatat në Bruksel kanë efekt në jetët e të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë, dhe qasja e mbyllur e qeverisë në këtë proces ka qenë thellësisht dëshpëruese.”

Përfundimisht, Kosova, Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të mbajnë në mend se sistemet e kuotave etnike nuk janë mënyra e vetme për të arritur barazi.

“Pse s'flasim për mbrojtjen e drejtave të njeriut?” pyet Milorad Radivojeviq nga Zveçani. “Nëse gjithmonë flasim për komunitetet shumicë e pakicë, atëherë shqiptarët e serbët gjithmonë do të kenë probleme”.



“Të gjitha pikat negociuese të Kosovës do duhej të ishin debatuar në parlament, negociatat në Bruksel kanë efekt në jetërat e të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë, dhe qasja e mbyllur e qeverisë në këtë proces ka qenë thellësisht dëshpëruese.”

—HANA MARKU







Published by:

---



